Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 2 (106). SHKURT 2015. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.


Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

ZGJEDHJET LOKALE
Do të botojmë pa dallim programet elektorale të kandidatëve FAQE 5


AKTUALITET
Radika, lajme kontradiktore mbi vazhdimin e projekteve FAQE 5,7

INTERVISTË
Orana, aroma e gatimeve dibrane në Master Chef FAQE 10

KULTURË & SPORT
Korabi shënon dy fitoret e radhës: në tavolinë dhe në fushë FAQE 18

Miniera, një **histori** suksesi, **abuzimi** dhe **varfërie**

67 vjet miniera e Bulqizës - askush nuk kujtohet për "arin e murrmë". Si ka qenë jeta e minierës nga guri i parë i zbuluar deri në ditën e sotme? Nga italianët në periudhën e diktaturës, deri te koncensionet abuzive Darfo e ACR. Nga sukseset e shfrytëzimit të mineralit, deri të rreziku i shkatërrimit. Balfin Group rrit investimet, sjell kinezët për t'i zgjatur jetëgjatësinë. Qyteza e Bulqizës, edhe pse me nëntokë të pasur, ishte dhe ka mbetur nga më të varfërat në vend. Kromi i Bulqizës është dhe mbetet një pasuri e madhe jo vetëm për të, por për gjithë vendin ku aktualisht mbulon pjesën më të madhe të eksporteve. Por qyteza nuk ka pësuar zhvillimin ekonomik. Banorët nuk kanë mundësi të tjera punësimi. Jo vetëm burra me krahë të fuqishëm, por fëmijë, gra, pleq e plaka, sa zbardh dita, i qepen malit për t'u përpirë për orë të tëra nga ato zgavra të llahtarshme që fshehin krom. Minerali për banorët e Bulqizës është kthyer në sigurimin e bukës së përditshme, duke i lënë në zgrip të jetës, ndërsa "padronët" i ka kthyer në zengjin të së sotmes. Punëtorët nxjerrin nga nëntoka krom për një pagesë qesharake...



Raport special nga **HYSEN LIKDISHA** - FAQE 2-3

Reportazh / Histori jetësore

Ambra, vajza që mundi sëmundjen me dashuri

Historia e Ambra Medës, dibranes që përballoi me shumë dinjitet një nga sëmundjet më të vështira në botë. Një histori njerëzore për tu marrë shembull: për kurajon, dinjitetin, humorin dhe guximin për t'ia dalë mbanë! Si një histori përralle në realitetin e ashpër shqiptar.



"Faleminderit të gjithëve për komentet dhe mesazhet e përzemërta gjatë gjithë kësaj periudhe. Me besoni, i kam lexuar të gjitha dhe jam përlotur. Duke ju falënderuar publikisht të gjithëve, ju njoftoj se më 9 shkurt do të zbres në aeroportin "Nënë Tereza". Do të vij në atdheun tim që më ka munguar aq shumë! Falënderoj Zotin, mjekësinë gjermane, dajat e mi Keta, njerëzit e gjakut, mediat shqiptare dhe gjermane si dhe te gjithë ata që kanë zgjatur dorën për të më ndihmuar, qoftë me një lutje shpirtërore apo fjalë zemre. Falë jush ia dola!" - shkruante Ambra Meda në profilin e saj në FB në fillim të shkurtit.

LEXONI NË FAQE 12-13

Falënderim!

Falënderojmë z. **LEFTER DAKU** për kontributin e dhënë në botimin e këtij numri të gazetës. Ai është profesor në Universitetin e Virginia Tech. Daku është një mik i vazhdueshëm i gazetës sonë dhë vazhdimisht na shkruan emaile mbështetëse për gazetën dhe çështjen e Rrugës së Arbërit. Një portret të hollësishëm për djalin nga Kalaja e Dodës, tani profesor në Virginia Tech, do ta ndiqni në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Kërkohen korrespondentë

Gazeta "Rruga e Arbërit" kërkon korrespondentë zyrtarë për rajonin e **PESHKOPISË** dhe **DIBRËS SË MADHE**. Të interesuarit të shkruajnë email në adresën **<rrugaearberit@gmail.com>** ose të telefonojnë në numrin **069 20 68 603.**

Redaksia

cyan magenta yelloë black 1

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 2 (106). 1 - 28 Shkurt 2015

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Hysen LIKDISHA
Sashenka NDREKA
Abdurahim ASHIKU

Kontribuan për këtë numër:
Arthur NELSEN
Mentor HOXHA
Faik XHANI
Halil RAMA
Dionis XHAFA
Sulejman TOMÇINI
Destan RAMA
Islam CANI
Beqir SINA
Selman MËZIU
Mevlud BUCI
Aleko MINGA
Mahmud HYSA
Afrim KAROSHI
Daniel BICA

Arkivi i gazetës është ME pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Punonte në stoqet e kromit, plagoset nëna 38 vjeçare

Gjatë muajit shkurt, një ngjarje e rëndë ndodhi në qytetin e Bulqizës, ku mbeti e plagosur një nënë 38 vjeçare e cila po punonte në stoqet e mineralit për të mbledhur gurë kromi.

Sipas burimeve nga policia lokale, Mimoza Islami, 38 vjeç, nënë e tre fëmijëve, është plagosur teksa po mblidhte gurë kromi në një nga stoqet private të mineralit, në minierën e Bulqizës. Si për gati çdo ditë, ajo ka qenë duke mbledhur gurë kromi, kur është goditur nga rrëshqitja e gurëve të stokut duke mbetur e plagosur.

Menjëherë asaj i kanë ardhur në ndihmë punonjësit e tjerë që punonin në këtë stok minerali, të cilët e kanë dërguar atë për ndihmë mjekësore në spitalin e Bulqizës. Pasi i është dhënë ndihma e parë, në mungesë të mjekëve specialistë, 38 vjeçarja është dërguar në Spitalin Rajonal të Peshkopisë për të marrë një ndihmë më të kualifikuar mjeksore, ku ende vazhdon të kurohet.

Burime nga ky spital thanë se ajo kishte marrë nga goditjet prej rrëshqitjeve të gurëve të kromit, fraktura të rënda në gjymtyrët e poshtme dhe në kokë. Ndërkohë policia lokale bën me dije se ka shoqëruar për në komisariatin e policisë, brigadierin dhe drejtuesin teknik të firmës private, ku punonte 38 vjeçarja.

Mimoza Islami jeton në qytetin e Bulqizës dhe është nëna e tre fëmijëve. Ashtu si shumë gra të tjera të këtij qyteti, për t'i ardhur në ndihmë familjes për të siguruar të ardhura financiare, ka gjetur mundësi punësimi në stoqet e kromit, ku janë të përfshirë jo vetëm gratë, por edhe fëmijë që nga mosha 6 vjeç, si dhe pleq. Për çdo ditë në këta stoqe, pa dallim moshe e gjinie, sulen fëmijë, gra dhe pleq, të cilët rrëmojnë në to për të nxjerrë bukën e gojës për ta dhe familjet e tyre, që jetojnë në kushtet e varfërisë ekstreme.

Në vijimësi është shkruar e folur shumë për të ndaluar punën e jashtligjshme në stoqe, pasi rrezikohen jetët e njerëzve, ende vërehet me keqardhje se puna në to vazhdon normalisht. Kujtojmë se gjatë punës së jashtligjshme në këto stoqe, janë shënuar jo vetëm aksidente me plagosje, por edhe me humbje jete.

Aksidenti i parë i rëndë me humbje jete në këto stoqe, ka ndodhur në 2007-tën ku mbeti viktimë Nevruz Gjoka, 45 vjeç. Po kështu në 2008-tën një tjetër aksident me vdekje ka qenë ai ku humbi jetën Xhevat Bulqiza, për të vijuar me nënën e tre fëmijëve, të ndjerën Lirie Mera, 45 vjeç, që mbeti poshtë masivit të gurëve të cilët u shembën mbi të. Ndërsa një tjetër grua, 40 vjeç, L. Sollaku, nënë e dy fëmijëve jetimë, që banon në një dhomë në ish pallatet e punëtorëve, si pasojë e një aksidenti në stoqe duke mbledhur krom për të rritur fëmijët, ka mbetur e paralizuar dhe aktualisht apelon për ndihmë për tu operuar jashtë shtetit. Po kështu në një tjetër aksident të radhës, një nënë mbeti e shokuar kur teksa po mblidhte gurë kromi në stoqe, pa t'i mbulohet me gurë djali i saj 12 vjeçar L. Fiku, që punonte me të, i cili fatmirësisht shpëtoi.

Përkundër rrezikimit të jetëve të tyre, puna në stoqe, në këmbim të pak parave që fitojnë për të siguruar bukën e gojës, vijon. Shkak për sfidimin e rrezikut të humbjes së jetës, bëhen kushtet ekstreme të varfërisë në të cilat gjinden familjet e tyre.

H.Likdisha

Si ka qenë jeta e minierës nga guri i parë i zbuluar deri në ditën e sotme. Nga italianët në periudhën e diktaturës deri te koncensionet abuzive Darfo e ACR. Nga sukseset e shfrytëzimit në mineralit deri të rreziku i shkatërrimit. Balfin Group rrit investimet, sjell kinezët për t'i zgjatur jetëgjatësinë.

Nga **HYSEN LIKDISHA**

18 shkurti i këtij viti, që lidhet me ditëlindjen e 67-të të Minierës së Bulqizës, thënë ndryshe i gjigantit të industrisë kromnxjerrëse në vendin tonë, ka kaluar në heshtje.

Për kromin ia vlen gjithnjë të diskutohet. Ai është quajtur "ari i murrmë", krahas naftës që është quajtur "ari i zi". Edhe pse kemi të bëjmë me një pasuri të madhe dhe të pakrahasueshme për ekonominë e vendit, të cilën po e shfrytëzojmë prej 67 vitesh, përvjetori i saj kalohet në heshtje totale si të ishte një ngjarje e rëndomtë pa kurrfarë rëndësie.

Edhe pse besoj se është e tepërt të flasësh për rëndësinë e kësaj miniere pasi një gjë e tillë njihet mirëfilli nga fakti se kromi i nxjerrë nga kjo minierë ka patur dhe vijon të ketë ndër vite një peshë të konsiderueshme në ekonominë e vendit tonë. Për këtë mjafton të sjellim në memorje se para viteve '90-të kur vendi ishte mbërthyer në darën e izolimit total, në këtë minierë punohej me moton "kromi çan bllokadën", ku në kongreset butaforike të ish PPSH-së, deklarohej se 32-37% të GDP-së, e mbulon kjo minierë. Ndërkohë edhe sot sipas statistikave, mësohet se peshën kryesore në eksportet tona aktualisht e mban kromi i Bulqizës.

Kromi, si produkt shqiptar, është si ari i Afrikës, si diamantet e Kongos, si nafta e Arabisë, si gazi natyror i Rusisë, apo makinat gjermane. Të gjithë i kërkojnë, askush nuk i refuzon. Kjo për faktin se xeherori (minerali) i kromit të Bulqizës, ose mademi i Bulqizës, është mjaft cilësor i pasur në oksidet e kromit Cr^2O^3 ku përmban 41-46% të këtyre oksideve. Ka përqindje të lartë hekuri dhe të ulët alumini, veti kjo që e bënë shumë të kërkuar në metalurgji dhe të rrallë në llojin e vet. Është një nga mineralet më të rëndë që nxirret nga nëntoka jonë.

Më 18 shkurt u mbushën 67 vjet që shfrytëzojmë kromin e kësaj miniere dhe askush nuk kujtohet qoftë edhe për të bërë në kuadër të këtij përvjetori, të paktën një urim përshëndetje. Shkurti është dhe mbetet muaji i minatorëve të Bulqizës, ku më e pakta në këtë kuadër, drejtuesit në vijimësi duhet dhe mund të bëjnë një urim për mijëra e mijëra veteranë, ish minatorë, inxhinierë, teknikë, drejtues, disa prej të cilëve nuk jetojnë më, që ndër vite punuan në këtë minierë.

Historikisht përvjetorët e Minierës, në vazhdimësi janë festuar të shoqëruar me simpoziume shkencore, ku referuesit inxhinieroteknikë, nëpërmjet kumtesave të mbajtura, kanë shpalosur historikun e ndritur të minierës, ku prodhimi sasior e cilësor i mineralit të xeherorit të kromit, ka njohur rritje të ndjeshme, duke shkuar në 250 mijë ton në vit.

Ndaj në shenjë respekti, mirënjohje e urimi dhe veçanërisht homazhi për ata qindra minatorë që dhanë edhe gjënë më të çmuar, jetën e tyre duke punuar në këtë minierë, ndjeva detyrim moral që të shkruaj këto pak radhë për këtë minierë, në kuadër të përvjetorit të 67-të të hapjes së saj.

PAK HISTORI NGA HAPJA E MINIERËS SË BULQIZËS.

Zbulimi i kromit në territorin e Bulqizës u bë rastësisht gjatë pushtimit italian, ndërsa shfrytëzimi i minierës nisi pak vite pas çlirimit. Në vitin 1940, Hamit Duriçi, banor i fshatit Vajkal të Bulqizës, tek po kulloste bagëtinë gjen një gur të zi dhe me shkëlqim gjysmëmetalik, më i rëndë nga gurët e tjerë, të cilin ia dorëzon një oficeri italian, që vepronte në atë zonë. Italianët kërkuan nga banorët që të mblidheshin këta gurë të veçantë. Banorët filluan të mbledhin gurin e rrallë, të cilin e transportuan me mushka në Qafën e Buallit. U grumbulluan kështu 2000 tonë krom, por italianët nuk mundën ta tërhiqnin kromin në vendin e tyre. Mirëpo mbeti një dokument historik se në Bulqizë ka një tufë daljesh kromi, të cilat janë mjaft premtuese.

Ka qenë 14 shkurti i vitit 1948, kur një ekip inxhiniero-teknik, i ardhur nga Tirana, ka bërë të mundur që më 18 shkurt të po këtij viti në Bulqizë të dëgjohen shpërthimet e para të minave. Pikërisht këto shpërthime shënuan edhe datëlindjen e kësaj miniere. Puna ka nisur me 30 punëtorë të ardhur nga rrethet e Dibrës, Matit dhe Mirditës. Minerali nxirrej në sipërfaqe me karroca dore. Vetëm pas 10 vitesh, pra në 1958, u vendos shfrytëzimi i minierës me galeri nënkati. Në vitet '60-'70 u vu në shfrytëzim pusi nr.1, me thellësi 150 metra. Dhe pas viteve '72-'74 filloi prodhimin pusi nr.2, me tri nivele. U arrit që miniera të shfrytëzohet deri në nivelin e 16 ose 6 metra nën nivelin e detit.

Pas vitit 1960 gjeologët Sefedin Qorlaze, Sh. Stërmasi, Jorgo Kola, Agim Dobi, Bashkim Lleshi etj, me studimet e bëra rritën rezervat gjeologjike që dhe sot mbajnë gjallë minierën e Bulqizës dhe minierat e tjera. Miniera e Bulqizës ka patur kryeinxhinier qysh në fillimet e saj të para (1955-1973) Todo Mançon (diplomuar 1952 në Akademinë e Minierave e të Metalurgjisë në Krakov të Polonisë) nga Boboshtica, zemra e të cilit deri sa pushoi së rrahuri nuk ju nda nga Bulqiza. Ai ideoi dhe aplikoi sistemin e shfrytëzimit të vendburimit me galeri nënkati e shembje. Kushdo që kujton e flet për minierën e Bulqizës nuk mund të harrojë emrin e tij.

Pikërisht këtu në Minierën e Bulqizës, punuan edhe inxhinierët e parë të minierave Andrea Xega (i diplomuar në Tuluzë 1931), Dhori Pano (i diplomuar në Saint Etienne 1939), Sotir Dodona (drejtor i minierës i diplomuar në Institutin e Minierave të Leningradit, 1951), Ligor Gurra dhe Halil Hoxha (të diplomuar në Akademinë e Minierave e të Metalurgjisë në Krakov të Polonisë respektivisht1952 dhe 1954) dhe më vonë vijnë e punojnë inxhinierët e diplomuar në Fakultetin e Gjeologjisë e Minierave të Universitetit tonë si Bujar Pata (kryeinxhinier), Llambi Gegprifti (drejtor), Martin Cukalla (drejtor), Jorgo Kola, Mark Boriçi (projektues), Dhori Pano, Ligor Gurra, Reshat Zajmi, Hamza Gurra, Jeshar Dema, Niko Lula, Përparim Hoxha, Fadil Cani, Nexhmedin Marku e shumë të tjerë.

Bulqiza ishte edhe një universitet i dytë, për të gjithë ata qindra e qindra kuadro me arsim të lartë që punuan aty. Shumë kuadro të Bulqizës transferoheshin në vende të tjera pune ku hapeshin, ndërtoheshin e shfrytëzoheshin miniera të reja, ose në institute studimore e projektuese e deri rektorë të Universitetit të Tiranës, etj.

Minerali që del nga zemra e Bulqizës, tash 67 vjet, ka shkuar e shkon edhe sot e kësaj dite, si mineral por edhe si lingota ferro-kromi, në Evropë e në Azi (Kinë, Gjermani, vendet skandinave, Itali, Angli etj.). Të gjithë e duan atë mineral, për cilësitë e tij të veçanta, shumë cilësore që inxhinierët e shkencëtarët që merren me prodhimin e çelikut, ngjyrave, industrinë refraktare e kimike, por dhe me detale e pajisje të fluturimeve kozmike e të prodhimeve të armëve të sofistikuara, për të cilat nuk flitet e nuk shkruhet, e vlerësojnë si të pazëvendësueshëm kromin e Bulqizës.

aktualitet

67 vjet miniera e Bulqizës - askush nuk kujtohet për “arin e murrmë”

Miniera, një histori suksesi, abuzimi dhe varfëri

- Qyteza e Bulqizës edhe pse me nëntokë të pasur, ishte dhe ka mbetur nga më të varfërat në vend.
- Kromi i Bulqizës është dhe mbetet një pasuri e madhe jo vetëm për të, por për gjithë vendin ku aktualisht mbulon pjesën më të madhe të eksporteve në rang vendi. Por qyteza nuk ka pësuar zhvillimin ekonomik.
- Banorët nuk kanë mundësi të tjera punësimi. Kështu, jo vetëm burra më krahë të fuqishëm, por fëmijë, gra, pleq e plaka, sa zbardh dita i qepen malit për t’u përpirë për orë të tëra nga ato zgavra të llahtarshme që fshehin krom. Ky mineral për banorët e Bulqizës është kthyer në sigurimin e bukës së përditshme, duke i lënë në zgrip të jetës, ndërsa “padronët” i ka kthyer në zengjin të së sotmes. Punëtorët nxjerrin nga nëntoka krom për një pagesë qesharake.




Foto: Hysen Rrahmani

KROMI PAS VITEVE ’90-TË - NJË HISTORI ABUZIMI E DËSHTIMI

Historia minierës së Bulqizës përbën ndoshta një nga dështimet më të mëdha me koncesionet, ku mpleksen viktima të pafajshme, fitime marramendëse dhe afera të dyshimta korruptive, që shkojnë deri në nivelet më të larta të qeverive ndër vite. Deri në vitin 2000, miniera vijoi të menaxhohet nga shteti, duke u përballur me një seri problematikash, që e bënë shfrytëzimin e saj aspak rentabël edhe për mungesë financimesh. Në vitin 2001, ish qeveria e atëhershme socialiste, miratoi koncesionin e parë të minierës së Bulqizës, së bashku me disa objekte të tjera që përfshinin edhe Fabrikën e Pasurimit të Kromit Bulqizë.

Koncesioni iu dha një kompanie italiane “DARFO”. Për më shumë se 5 vite italianët shfrytëzuan minierën, rezervat dhe stoqet e akumuluara në vite pa bërë asnjë investim. Nga fundi i vitit 2006, DARFO u largua dhe ia shiti koncesionin një grupi, ruso-austriak të quajtur ACR.

Shitja u mbikqyr nga ish ministri i atëhershëm i Ekonomisë Genc Ruli, i cili ishte dhe njeriu që negocioi marrëveshjen e re të koncesionit me kompaninë ruso-austriake ACR. Sipas marrëveshjes, që u votua në Kuvendin e Shqipërisë, në vitin 2007, ACR-ja detyrohej të investonte deri në fund të 2010 të paktën rreth 22 milionë euro, për të rinovuar teknologjinë dhe për të përmirësuar kushtet e sigurisë në punë.

Koncesioni i ri solli shpresën se më në fund problemet në minierë do të përfundonin dhe investitorët e rinj do të nisnin investimet për të përmirësuar kushtet e minatorëve dhe rendimentin e minierës, duke realizuar punimet e thellësisë. Por, kjo nuk ndodhi. Kompania e re koncesionare “ACR”, e nxitur nga çmimet rekord të kromit në vitet 2007-2008, nisi shfrytëzimin masiv të rezervave të akumuluara nga vitet e komunizmit, ndërsa investimet zvarriteshin. Ndërkohë në minierë, për mungesë investimesh deri edhe për të blerë vagonë, puna vazhdonte me karroca dore dhe pa kushtet e sigurisë në punë. Në të tilla kushte minatorët humbisnin jetën njëri pas tjetrit.

Pas tre vitesh shfrytëzim, ACR kishte shkelur të gjitha planet e investimeve që detyronte marrëveshja. Në këtë situatë në 7 korrik të vitit 2009, kompania i drejtohet Ministrisë së Energjitikës, ku i kërkon të ndryshojë marrëveshjen e koçensionit. Vetëm dy ditë më vonë ish ministri Genc Ruli firmos ndryshimin e marrëveshjes duke shtyrë mbi 13 milionë euro investime për vitet 2009-2013 edhe pse sipas koncesionit investimet duhet të kishin përfunduar sakaq.

Vetëm pak ditë para se të linte detyrën Genc Ruli, kishte ndryshuar një marrëveshje të votuar nga Kuvendi në kundërshtim të hapur me ligjin.

Pas publikimit të skandalit në Top Channel, ish ministri Ruli reagoi duke dhënë versionin e tij se pse e ndryshoi marrëveshjen pa e kaluar në Kuvend, me pretendimin se deputetët ishin me pushime verore. Pak ditë më vonë prokuroria njoftoi publikisht çeljen e hetimeve. Dosja edhe sot vazhdon të endet në zyrat e saj, ndërsa abuzimet në minierë vazhdonin.

Pas zgjedhjeve të vitit 2009 në krye të Ministrisë së Energjetikës vjen Dritan Prifti, i cili tentoi të anullonte koncesionin duke e quajtur marrëveshjen zyrtarisht të dështuar. Por edhe kjo nismë u zhbë shpejt. Kërcënimet dhe akuzat për heqje koncesioni mbeten vetëm deklarata dhe nuk u mor asnjë hap ligjor për t’u dhënë fund abuzimeve dhe shfrytëzimit barbar të minierës. Në të tilla kushte ekspertë dhe specialistë të minierave dhanë alarmin se miniera rrezikon të shembet, për shkak të shfrytëzimit pa kriter dhe investimeve të munguara. Madje pjesa jugore e minierës, thënë ndryshe “Zona D”, është cilësuar e pa sigurtë për punë, pasi ka mbivendosje punimesh, të cilat rrezikojnë shembjen e saj.

Qyteza e Bulqizës edhe pse me nëntokë të pasur, paradoksalisht ishte dhe ka mbetur nga më të varfërat në vend. Çdo gjë në Bulqizë lidhet dhe mbahet gjallë vetëm nëpërmjet kromit, ku edhe vetë qyteza është e ngritur prej tij. Kromi i Bulqizës është dhe mbetet një pasuri e madhe jo vetëm për të, por për gjithë vendin ku aktualisht mbulon pjesën më të madhe të eksporteve në rang vendi. Por përkundër kësaj qyteza nuk ka pësuar ndryshime në zhvillimin për mirë të saj. Po ata ndërtesa të para viteve ’90-të, ku minatorët dhe familjet e tyre jetojnë në ish godinat e punëtorëve dhe barakat të mbuluara me llamarina edhe pse nga nëntoka nxjerrin “arin e murrmë”. Banorët duke mos patur akses tjetër punësimi, janë të lidhur pazgjidhshmërisht me gurët e kromit. Kështu në të tilla kushte, jo vetëm burra më krahë të fuqishëm, por fëmijë, gra, pleq e plaka, sa zbardh dita i qepen malit për t’u përpirë për orë të tëra nga ato zgavra të llahtarshme që fshehin krom. Ky mineral për banorët e Bulqizës është kthyer në sigurimin e bukës së përditshme, duke i lënë në zgrip të jetës, ndërsa “padronët” i ka kthyer në zengjin të së sotmes.

Prodhimi aktual i kromit nga koncesionari AlbChrome, me kontraktor Balfin Grup, përfshirë edhe 106 licensa të firmave të vogla private , është rreth 200 mijë ton në vit. Punëtorët nxjerrin nga nëntoka krom për një pagesë qesharake. Të fortët e grumbullojnë e më pas me një çmim shumë të ulët ua shesin kromin kompanive të licencuara, të cilat e transportojnë në Durrës.

KINEZËT - SHPRESA E RINGRITJES SË MINIERËS

Fundqershori 2014-të solli për minierën investimin e nevojshëm për frymëmarrje të saj, atë të hapjes së pusit nr.9 me gjatësi 600 metra duke filluar nga niveli +420 m e përfunduar në nivelin -180 metra. Një investim i kompanisë koçesionare “AlbChrome”, pjesë e Grupit Balfin me një vlerë prej 20 milion dollarësh.

Hapja dhe montimi i makinerive e pajisjeve të pusit është marrë përsipër nga kompania kineze Ëenzhou Mining Co Ltd, kompani e cila ka angazhuar një personel prej 70 punonjësish për këtë qellim. Angazhimi i kompanisë është që punimet për hapjen e pusit të përfundojnë për një periudhe 20 muaj e gjysmë.

LEJET MINERARE

Mbivendosjet, hiqen 20 licenca në Bulqizë

Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka revokuar për arsye të mbivendosjeve 20 leje minerare. Nga procesi i verifikimit të të dhënave nga viti 2005 deri në tremujorin e tretë të vitit 2013 është konstatuar se këto mbivendosje janë kryesisht në vendburimin e kromit në Bulqizë, vendburimet e kromit në Theken, Baterr dhe Krastë. Për të gjitha lejet janë evidentuar mbivendosjet në planin vertikal dhe në atë horizontal, tha Ministri Damian Gjiknuri. Sipas ligjit aktual, në rast se leja minerare, e cila është dhënë në një periudhë kohore të mëvonshme është e pavlefshme për zonën e mbivendosur dhe ministri e revokon atë vetëm për zonën e mbivendosur. Shmangia e mbivendosjeve shënon një hap të rëndësishëm në drejtim jo vetëm të rritjes së sigurisë në punë për punëtorët e nëntokës por edhe shmangie e konflikteve mes subjekteve që zotërojnë lejet minerare. Ndërkaq, në kuadër të procesit të verifikimit dhe monitorimit të lejeve ekzistuese, Ministri Gjiknuri ka firmosur edhe fillimin e procedurave të revokimit për shkak të mosrespektimit të detyrimeve ligjore për 47 leje të tjera minerare në fushën e kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit. Në këto leje është konstatuar mos pagesë e garancive financiare të rehabilitimit të mjedisit dhe investimit apo përfundimi i kohës së shfrytëzimit.

Rruga e Arbërit nr. 106

Kandidatët duhet të dëgjohen për idetë dhe vizionet e tyre për të ardhmen e Dibrës, zhvillimin e ekonomisë lokale, biznesit, bujqësisë, arsimit, tregut, industrisë etj.

zgjedhje

Pse do ta votoja Hysen Ukën për kryetar bashkie?

Pas botimit në numrin e kaluar të një shkrimi mbi kandidaturat e ardhshme të zgjedhjeve lokale, duke iu referuar burimeve nga Peshkopia, kemi pasur disa reagime lexuesish, shumica e tyre me vlerësime, por edhe debat për disa kandidatura të mundshme për të garuar për bashkitë e qarkut të Dibrës.

Shkak i shkrimit të këtyre radhëve është futja në këtë listë edhe e disa emrave që kanë treguar një shkallë të lartë integriteti ndaj partive ku militojnë. Sipas shkrimit, emrat e promovuar mund të jenë jo vetëm përfaqësues të partive përkatëse, por edhe administratorë të mirë të bashkive dhe përfaqësues dinjitozë të interesave të komunitetit në tërësi.

Njëri prej kandidatëve të shenjuar është Hysen Uka. Nëse ndonjë shpreh rezerva ndaj këtij intelektuali, për faktin se është miku im, mund t'i them që kjo miqësi nuk lidhet me motive të rëndomta. Përkundrazi.

Sipas meje, kjo miqësi e shoqëri ka të bëjë me rrethana dhe motive që kanë të bëjnë pikërisht me vokacionin publik, me mbrojtjen dhe promovimin e interesave publike të komunitetit jo thjesht tani në prag të një gare zgjedhore, siç bëjnë shumë syresh. Hysenin nuk e njoh "nga fisi", as nga kafenetë apo drekat e darkat, nuk e njoh as për mblesëri tradicionale as për mblesëri biznesi. E njoh prej shumë vjetësh nga dashuria për librin, për gazetën "Rruga e Arbërit" dhe nga promovimi pa fund për realizimin e "Rrugës së Arbrit".

Kur 20 vite më parë intelektualët në Peshkopi mbanin gati valixhet për tu larguar në kryeqytet apo perëndim, Hysen Uka e kishte të ndarë mendjen për të qëndruar në Peshkopi. Kur ai pati mundësi të investonte në biznese fitimprurëse, ai nuk investoi në një sektor të "modës së fitimeve", por në një librari, që nga pikëpamja ekonomike është jofitimprurës. Personalisht kam qenë dëshmitar për oferta për ta shitur librarinë, duke i ndërruar destinacionin në këmbim të shumave të majme, por Ceni refuzoi: "Nuk e ndërroj librin me asgjë", kjo ishte fjalia e tij refuzuese.

Hysen Uka futet në atë rreth jo shumë të gjerë njerëzish që e kanë dashur dhe e duan Peshkopinë në këto kohë të vështira për qytetet periferike. Kur bridhte dyerve të institucioneve për Rrugën e Arbërit, të gjithë e përcillnin dhimbshëm, duke menduar se sapo kishin përcjellë një "të çartur". Sepse

Hysen Uka ka një vizion për Dibrën, ka një dëshirë dhe energji të pashtershme për të kontribuar, ka ide dhe plane, por ka edhe një besim se ato mund të bëhen realitet nën një qeverisje të drejtë dhe me mbështetjen e qeverisë qendrore.

ata, pavarësisht përfitimeve që kanë marrë e po marrin me këtë çështjen e rrugës, në atë kohë nuk ishin në gjendje të përfytyronin se si do të zhvillohej Dibra me Rrugën e Arbërit.

Hysen Uka është një i majtë në bindje politike; ky është një fakt që e dinë të gjithë. Pra, ai nuk e fsheh këtë fakt, si shumë të tjerë aspirantë fakultativë të partive politike në prag ndërrimi të pushtetit. Hyseni ka një arsimim për t'u admiruar; që nga shkencat humane deri te ato të marrëdhënieve ndërkombëtare; njeh shumë mirë politikën dhe praktikat demokratike dhe ka një nuhatje për t'u admiruar për sa i përket perspektivës rajonale dhe europiane të Shqipërisë. Hyseni nuk ka ndonjë dëshirë të madhe për të bërë karrierë, por angazhimi i tij intelektual është për tu marrë në konsideratë dhe për tu provuar. Dhe nisma kandiduese nuk ka lindur prej tij, por për shkak të dëshirës së shumë të tjerëve që e njohin mirë dhe ia dinë aftësitë.

Hysen Uka nuk ka pará "për të blerë vota", por është e sigurt që nesër ai nuk do ta shiste pushtetin për të bërë pará. Ai mund të shkojë drejt bashkisë së qytetit pa asnjë qindarkë në llogarinë e bankës, dhe ai mund të jetë edhe shtetari që do të largohet nga bashkia pa asnjë qindarkë. Sepse Hyseni nuk shkon drejt bashkisë për të fituar para, por për të shërbyer.

Shqipëria në 25 vite tranzicion dëshmoi e provoi se ata që kanë pará nuk u futën në politikë si altruistë që e shkrinë pasurinë e tyre për ndërtimin e shtetit dhe progresin e vendit, por treguan se hodhën qindra e mijëra dollarë dhe kërkuan t'i rimerrnin ato shumëfish, madje, që në vitin e parë të pushtetit.

Hyseni Uka mund të jetë kandidati i koalicionit qeverisës. Në qoftë se përzgjidhet si kandidat, ai mund të mos jetë fituesi i zgjedhjeve, por ai mund t'i ofrojë anëtarësisë së partisë ku militon, ashtu edhe votuesve "pa parti", shpresë se punët në këtë vend mund të bëhen më mirë.

Hyseni nuk është "fis i madh" dhe nuk ka nevojë për qoka. Vëllai i tij nuk ka nevojë për një "copë drejtori" dhe nuk ka as dëshirën të bëhet menaxheri i tij. Po ashtu, kushërinjtë e paktë nuk pretendojnë të punësohen apo favorizohen. Një prej miqve të tij të afërt mund të jem edhe unë, por po e deklaroj që tani se nuk do të kem asnjë përfitim prej kësaj zgjedhje, sado e vogël qoftë, sado tërthorazi që të jetë. Në qoftë se ai do ketë fatin të hyjë në zyrën e bashkisë së madhe të Dibrës, ai i ka të gjitha liritë ta ushtrojë atë detyrë me seriozitet, në respekt të popullit pa dallime partiake dhe në zbatim të ligjit.

Hyseni ka një vizion për Dibrën, ka një dëshirë dhe energji të pashtershme për të kontribuar, ka ide dhe plane, por ka edhe një besim se ato mund të bëhen realitet nën një qeverisje të drejtë dhe me mbështetjen e qeverisë qendrore. Hyseni ka në kokë ide për projekte që do ta fitonin mbështetjen e qeverisë. Hyseni ka ide që mund ti japim zhvillim rajonit në mënyrë të paimagjinueshme, sa nuk e kemi parë në këto 20 vite. Me Hysenin kryetar bashkie, "të mëdhenjtë e Dibrës" do humbasin ndikimin personal mbi pushtetin, por edhe ata vetë, dhe ca më shumë qytetarët e thjeshtë, do ta fitojnë besimin se shteti mund të jetë i barabartë për të gjithë, pavarësisht ku jetojnë, nga Lura në Bllatë, nga Cerjani në Kala, nga Muhurri në Reç, aty ku ka nevojë të ndjehet dora e qeverisjes.

Por që Hyseni të jetë një kandidat i mundshëm, së pari, lind nevoja e një konkurrimi të drejtë brenda Partisë Socialiste, ku gjithë kandidatëve t'u jepen mundësi të barabarta për t'u dëgjuar dhe për të shpallur platformat e tyre. Kandidatët duhet të dëgjohen për idetë dhe vizionet e tyre për të ardhmen e Dibrës, zhvillimin e ekonomisë lokale, biznesit, bujqësisë, arsimit, tregut, industrisë etj. Dhe kjo arrihet në bazë të anëtarësisë pas rregullave demokratike të lojës brenda një force politike. Në fund të fundit, kandidati duhet të zgjidhet në një forum partie, sado i lartë të jetë, dhe jo në restorantet e periferive apo kulimat e fshehta politike.

BUJAR KAROSHI

Njoftim

Në shkollën tuaj keni një talent që duhet promovuar, në lagjen tuaj keni një artist që duhet prezantuar, një artizan duarart, një mjek të aftë, një bujk punëtor, një qytetar shembullor...

Pranë jush gjendet dikush që e meriton që shembulli dhe puna e tij të bëhet e njohur...

Na shkruani në adresën e emailit ose na ndiqni përmes faqes në FB "Rruga e Arbërit" dhe një gazetar i yni do të vijë pranë jush...

Mos ngurro! Gjithmonë ka gjëra të mira pranë jush që duhen vlerësuar!

shkruaj email: <rrugaearberit@gmail.com>

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit

<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Zgjedhjet lokale

"Rruga e Arbërit", e hapur për të botuar të gjitha programet e kandidatëve

Numri e kaluar gazeta bëri një panoramë të parë mbi zgjedhjet e ardhshme vendore, dhe menjëherë pas saj pati edhe reagime lexuesish mbi kandidaturat e shpallura. Disa pëlqehen dhe disa jo, sipas synimeve të rrymave brenda partive politike. Sidoqoftë, faza e përzgjedhjes do të kalojë, dhe shumë shpejt partitë politike do të ndeshen në një fushatë, që parashikohet e ashpër.

Zgjedhjet e qershorit janë zgjedhje vendore, dhe së pari ato duhet të zhvillohen duke pasur ne qendër zhvillimet vendore. Në zona të mëdhaja, siç janë tani bashkitë e reja, do të jetë e vështirë për kandidatët që t'i prekin ato gjatë një muaji, por do të jetë më e lehtë për ta të hartojnë platforma elektorale, programet e të cilave bazohen tani në një bazë të gjerë elektorale.

Gazeta "Rruga e Arbërit" dëshiron që Dibra të zhvillojë një fushatë model, ku kandidatët, pavarësisht partive nga vijnë, të jenë në gjendje të hartojnë programe në dobi të komunitetit. Gjithashtu, do dëshironim që edhe fituesit të mos e shihnin veten si fitues të një partie politike, por si fitues të komunitetit që kanë marrë përsipër të qeverisin. Mes të djathtës dhe të majtës, ndodhet populli i Dibrës, që për hir të vërtetës, në gjithë këto vite demokraci, në vend që të zhvillohej e demokratizohej, ka shkuar në të kundërtën: duke qenë një nga qarqet më të varfëra të vendit dhe me perspektivë zhvillimi shumë të largët.

Për të ndihmuar në këtë proces, gazeta, duke filluar nga muaji i ardhshëm, mbetet e hapur për të botuar programet elektorale të të gjithë kandidatëve që do konkurrojnë në katër bashkitë e qarkut, duke ndihmuar kështu sadopak në përhapjen e informacioneve dhe njohjen nga lexuesit të programeve të tyre. Dhe e gjithë kjo pa shpenzime financiare.

Më poshtë po ribotojmë një listë të kandidatëve që pretendojnë të fitojnë garën brenda partive politike.


BASHKIA E PESHKOPISË
PD: Ilir Krosi, Rrahim Kaleci, Shkëlzen Qoka, Naim Gazidede.
PS: Ulsi Manja, Shukri Xhelili, Donika Hyseni, Hysen Uka.
FRD: Sali Shehu

BASHKIA E BULQIZË:
PD: Durim Balla, Defrim Fiku, Mois Llani, Roland Keta
LSI: Ardit Kaja, Lefter Alla, Hajri Laçi, Ilir Balla

BASHKIA KLOS:
PD: Bedri Hoxha, Femi Hoxha, Basir Çupa
PS&LSI: Lutfie Meta, Ferit Hoxha

BASHKIA BURREL:
PS: Adelina Farriçi
PD: Nezir Rizvani, Rustem Nuzi
FRD: Afrim Reçi

aktualitet


Lumi Reka. © Arthur Neslen

Banka Botërore, megjithatë, akoma po planifikon një kredi prej 70 milion Eurosh për të ndërtuar një tjetër digë të madhe në Mavrovë, në fushën e Lukovës, në një zonë në kufi me Kosovën, ku kufijtë kombëtarë mes dy vendeve janë ndryshuar kohët e fundit në një mënyrë që rastësisht krijon mundësinë e ndërtimit të digës.

Zhvillimi i bujshëm **i HEC-ve** kërcënon burimet e fundit ujore natyrale të **Europës**

Shqetësimet rreth mjedisit pothuajse kanë kthyer mbrapsht një nga projektet kryesore në fushën e ndërtimit të digave, por "rrjedha e artë e lumenjve" të Europës Jug-Lindore i vendos këto sisteme ekologjike dhe gjallesat e egra të tyre në rrezik, duke përfshirë edhe rrëqebullin e Ballkanit, tashmë në gjendje kritike.

Gazetari Nilsen i "The Guardian" hedh një vështrim mbi situatën kritike të mjedisit në Ballkanin Juglindor, ku sistemet ekologjike janë vënë në rrezik nga kërkesat e vazhdueshme e në rritje për shfrytëzimin e këtyre burimeve ujore për energjinë. Artikulli hedh dritë mbi "udhëkryqin" në të cilën gjendet qeveria shqiptare, nga një anë nën presionin e kërkesave në rritje nga biznesi për të shfrytëzuar burimet e bollshme ujore të vendit, dhe nga ana tjetër nën presionin po në rritje për të ruajtur ekosistemin natyror dhe për ta shfrytëzuar më mirë një burim të jashtëzakonshëm mundësish po me këto burime.

Artikulli merr në shqyrtim disa lumenj edhe projekte në Shqipëri dhe në Maqedoni, duke përfshirë edhe planet për ndërtimin e HEC-eve në lumin e Vjosës, por më poshtë, po vendosim të përkthyer në shqip, vetëm pjesën e artikullit, që trajton projektet për ndërtimin e Hec-it në Mavrovë, një projekt që prek rajonin e Dibrës; projekt për të cilin e kemi trajtuar edhe më përpara në gazetën tonë.

Nga **ARTHUR NELSEN**
për gazetën britanike "*The Guardian*"

Dimë më shumë rreth lumenjve në Amazonë sesa në burimet ujore të paprekura të Ballkanit, të fundit të tilla në Europë. Por këto sisteme ekologjike unike të Juglindjes së Europës mund të zhduken shpejt, bashkë me speciet e rrezikuara, siç është rrëqebulli i ballkanit, nëse planet për ndërtimin e më shumë se 2000 digave vazhdojnë. Kështu paralajmërojnë ambientalistët.

Institucionet financiare ndërkombëtare kanë hedhur qindra miliona dollar në ndërtimin e digave në rajon, duke argumentuar kësisoj që HEC-et janë një burim energjie i gjelbër që iu ofron vendeve të varfra një dalje nga pasiguria energjetike.

"Guardian" mësoi që Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) është shumë afër heqjes dorë nga projekti prej 65 milion Europeve në parkun kombëtar të Mavrovës në Maqedoni, pasi kritika e ambientalistëve theksoi me këmbëngulje mundësinë e shfarosjes së rrëqebullit të Ballkanit prej këtij projekti.

...

Organizata joqeveritare austriake RiverWatch ka të dhëna që rreth 435 diga po planifikohen të ndërtohen në Shqipëri, 400 në Maqedoni dhe në Bullgari respektivisht, 700 në Serbi, më shumë se 100 në Bosnje dhe në Hugari, 70 në Mal të Zi, dhe më shumë se 50 në Slloveni.

Një zëdhënëse e BERZH i tha Guardian që nuk ka fonde të dhëna akoma për projektin Ura e Boshkut dhe projekti aktualisht është i pezulluar. "Në këtë çast, po zhvillohet një vlerësim i ri ambientalist. Derisa të mbarojë ky shqyrtim, asgjë nuk do të ecë përpara", tha ajo.

Në Shqipëri, digat e licensuara janë tashmë kanë një vlerë investimi prej 1.8 miliardë stërlina, sipas dokumenteve të shqyrtuara nga Guardian.

Një të katërtat e 646 HEC-eve që ka analizuar RiverWatch gjenden në parqe natyrore kombëtare dhe në zona të mbrojtura, ose zona të arta ambientaliste të shqyrtuara nga grupime si Natura 2000, Emerald, World Heritage, Ramsar dhe Biosphere.

22 prej këtyre projekteve gjenden në Mavrovë, parku kombëtar më i vjetër dhe më i madh i Maqedonisë, një hapësirë e egër mahnitëse prej 730 km2, me pyje ku gjendet mështekën dhe pisha, gryka, ujëvarash, torfë dhe malet më të larta të vendit.

Shkëmbinj rrasë të ngjyrosura dalin drejt qiellit derisa zhduken në mjegull. Ajri është alpin i freskët. Grumbuj bore dhe pisha të ngrira ngrihen mbi pjesën tjetër të bimësisë në rrugët gjarpëroshe të parkut. Nën ta, uji i akullt blu i lumit Reka përplaset mbi gurë, duke u kthyer në shkumë.

Mavrova është shtëpia e më shumë se 1000 specieve bimore, dhe siguron një vendstrehim për arinjtë, ujqërit, shqiponja të arta dhe specie të rrezikuara si për shembull rrëqebullin e Ballkanit, nga i cili besohet se vetëm 50 prej tyre janë gjallë akoma.


Por ambientalistët ruajtës thonë që digat e planifikuara do të sjellin rrugë, linja transmetimi, zhurmë, shqetësim industrial dhe një fluks në rritje të aktivitetit njerëzor, që me gjasë do të trembë kafshët e parkut – duke i bërë këto të fundit një pre të lehtë për gjuetarët e paligjshëm.

"Rrëqebulli është një kafshë shumë e këndshme dhe gjithashtu shumë i fshehtë", thotë Aleksander Stojanov, një koordinator projekti për Projektit e Rimëkëmbjes së Rrëqebullit të Ballkanit. "Preferon shkretëtira të paprekura ku nuk ka shqetësim. Ndërtimet do të detyronin rrëqebullin të largohej nga zona e mbrojtur dhe do të shkonte në zona të pambrojtura – ku nuk ka mbrojtje për ta – dhe do të përballje me gjuetinë e paligjshme. Me siguri ka rrezik për zhdukje."

Rrëqebulli është një ikonë e dashur në Maqedoni, e vulosur në monedha, pulla dhe në bluza të skuadrave të futbollit. "Është simboli ynë në botë", tha Shuip Marku, një ish-fermer në qytetin e afërt të Dibrës. "Është luani ynë."

Megjithatë, gjuetarët e paligjshëm janë aktivë, madje edhe brenda parkut dhe mendohet se kanë vrarë një nga rrëqebujt që grupi i Stojanov i kishte vendosur një rrip me GPS. Pasi një raport i BERZH hodhi poshtë mundësinë që rrëqebulli të banonte në park, ministria e mjedisit të Maqedonisë refuzoi lejet për Projektin e Rimëkëmbjes së Rrëqebullit, që këta të fundit të vendosnin aparate fotografike në park, dhe fotoja e fundit e rrëqebullit është marrë në vitin 2013.

Në zonën e Mavrovës, propozimet për ndërtimin e digave kanë edhe një dimension etnik, duke nxitur tërbim në mes komunitetit etnik shqiptar, i cili tashmë vuajnë mungesa uji në verë, dhe kjo mungesë shkatërron bujqësinë lokale, dhe po ashtu traditat kulinare të "ushqimit të shëndetshëm" të zonës.


Parku i Mavrovës. © Mihai Popa Alamy

Më vonë, BERZH u detyrua të tërheqë këtë deklarata por shqyrtimi mjedisor i bëra nga kjo bankë u kritikua gjerësisht për një sugjerim tjetër të përfshirë në të, sipas të cilit digat do të ndihmonin vidrat, duke iu dhënë më shumë mundësi për ushqim.

Organizata Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (ONRN) u ankua për shqyrtimin "sipërfaqësor, të paplotë dhe drejtuar keqas", që tregonte një "mungesë bazë të të kuptuarit të sjelljes së vidrave si dhe funksionimin e duhur të sistemeve ekologjike të lumenjve."

Në një letër drejtuar BERZH, letër që i ka rënë në dorë edhe Guardian, drejtori i ONRN-së, Julia Marton-Lefèvre i kërkoi BERZH që të ndalonte financimin e një projekti HEC-i në Ura e Boshkut në Mavrovë, duke thënë që sillte "kërcënim direkt për llojet dhe gjallesat e pranishme në këtë zonë.".

Pothuajse 100,000 kanë nënshkruar një peticion kundër projektit, 119 ambientalistë protestuan, dhe në Dhjetor, komiteti i tanishëm i Konventës së Bërnës shtoi presionin, duke hapur një hetim rreth depozitimit të mbetjeve afër lumenjve.

Një zëdhënëse e BERZH i tha Guardian që nuk ka fonde të dhëna akoma për projektin Ura e Boshkut dhe projekti aktualisht është i pezulluar. "Në këtë çast, po zhvillohet një vlerësim i ri ambientalist. Derisa të mbarojë ky shqyrtim, asgjë nuk do të ecë përpara", tha ajo.

Një burim nga banka shtoi: "Ka shumë zemërim nga ambientalistët ruajtës dhe kjo e bën punën në terren për stafin tonë shumë të vështirë. Ka gjasa që duhet të kthehemi mbrapsht dhe të heqim dorë."

Banka Botërore, megjithatë, akoma po planifikon një kredi prej 70 milion Eurosh për të ndërtuar një tjetër digë të madhe në Mavrovë, në fushën e Lukovës, në një zonë në kufi me Kosovën, ku kufijtë kombëtarë mes dy vendeve janë ndryshuar kohët e fundit në një mënyrë që rastësisht krijon mundësinë e ndërtimit të digës.

Në zonën e Mavrovës, propozimet për ndërtimin e digave kanë edhe një dimension etnik, duke nxitur tërbim në mes komunitetit etnik shqiptar, i cili thotë që ujërat do të largohen nga fshatrat e tyre, të cilat tashmë vuajnë mungesa uji në verë, dhe kjo mungesë shkatërron bujqësinë lokale, dhe po ashtu traditat kulinare të "ushqimit të shëndetshëm" të zonës.

"Është një problem i madh", thotë Marku. "Njerëzit besojnë që këto projekte kanë për qëllim që të vjedhin ujin dhe të detyrojnë me forcë që shqiptarët të braktisin vendin e tyre".

Mijëra shqiptarë etnikë kanë emigruar tashmë nga Dibra, duke filluar protesta kundër ndërtimit të digave në vende si Italia, protesta këto që pasqyrojnë protestat në Dibër, megjithëse këto të fundit janë mbajtur, duke anashkaluar atë që Marku dhe të tjerë thonë, nën presion frike nga administrata zyrtare.

opinion

Dibra në kontekstin politik, ekonomik dhe shoqëror

Nga **DIONIS XHAFA**

Atë ç'ka nuk mund t'ia mohosh Dibrës është fakti se kjo krahinë, përtej gjykimit me dylbi lokaliteti, mbart "mbi shpinë" histori, ndoshta më shumë se çdo krahinë tjetër e banuar nga shqiptarët. Dibra është rast unikal në trevat e banuara nga shqiptarët, që është e ndarë në dy shtete, që përcaktojnë fatin e tmerrshëm historik të një treve të ndarë nga fuqia dhe sistemet politike të bluara ndër vite. Është dhimbje e kobshme të kujtosh të kaluarën historike të Dibrës dhe realitetin e sotëm dibran.

KONTEKSTI POLITIK

Për fat të keq, Dibra sot, si një zonë e pozicionuar gjeografikisht në një cep të Shqipërisë, vuan vëmendjen e duhur të asaj politike që bluhet në Tiranë. E tërë politika thuajse bluhet në kryeqytet dhe në rrethe vetëm sa konsiderohet se bëhet jetë e mirfilltë qytetare dhe përfaqësim i denjë politik. Edhe pse politika edhe në Tiranë më së shumti është përfaqësuese e padrejtësisë sesa e të drejtës, në Dibër vetëm sa ka dritë-hije të vobegëta të asaj që konsiderohet politikbërje, në kuptimin e plotë të fjalës. Kështu ngjan të jetë realiteti politik në Dibër këtej dhe andej kufirit shtetëror. Ndërsa, jo më mirë është realiteti edhe në qytetin përtej kufijve të shtetit shqiptar. Qyteti i Dibrës, njëjtë sikundër rrethi me qendër Peshkopinë, është sot vetëm një zonë periferike e politikbërjes të partive shqiptare në Maqedoni. Dora e politikës ndihet tejet pak në qytetin e Dibrës, i cili më së shumti mbahet në këmbë nga të ardhurat e emigrantëve të dibranëve që jetojnë më së shumti në Amerikë dhe në vende të Evropës Perëndimore. E thënë shkurt, politika e ka lënë si një zonë periferike Dibrën, si atë këtej dhe përtej kufijve, duke e trajtuar zonën me indiferentizëm, në dy shtetet respektive.

KONTEKSTI EKONOMIK

Ndoshta dhe më shumë se për vëmendje politike, më saktë të një politike të drejtë (e cila rrallë gjendet të jetë e tillë), Dibra vuan pikëpamjen ekonomike. Më e rëndë situata është sidomos në Dibrën në anën e Shqipërisë, ku si pasojë e një tranzicioni të lodhshëm e të tejzgjatur, dibranët kanë vuajtur dhe vuajnë një sistem politik që në jo pak raste është dhe i padrejtë ekonomikisht. Krahina e Dibrës llogaritet të jetë në mos më e varfëra, ndër më të varfërat ekonomikisht në Republikën e Shqipërisë. Banorë e familje të tëra që mbajnë frymën gjallë nga remitancat, puna e rëndë në bujqësi dhe në miniera, flasin për një realitet që vret. Një shoqëri ku gjenden përplot të papunë, të mjeruar e në gjendje të vështirë ekonomike, edhe përditshmëria nuk ka asesi të përjetohet ndryshe, veçse zymtësisë. Aty ku ka varfëri ka zymtësi dhe aty ku ka zymtësi, jeta fiket në terrin e vuajtjes së përditshme.

KONTEKSTI SHOQËROR

Me shembjen e një sistemi gjakatar, të mbështetur më së shumti në parimet e mbrapshta staliniste,e ku mungonin liria e plotë dhe të tjera të drejta njerëzore, një dritë shprese ndriti për Dibrën. Por, se vlerat e një demokracie të mirfilltë, sipas një modeli perëndimor shtetëror, për fat të keq mungojnë ndjeshëm në krahinë. E mbushur në masë me njerëz të papunë, pa aktivitet të shëndoshë kulturor dhe social, Dibra dhe dibranët vuajnë pjellën e një politike të padrejtë. Një vend ku mungon industria, ku njeriu privohet të jetë i lirë në kuptimin e plotë të kësaj fjale të shenjtë, ku mungon kultura e teatrit, filmit, librit, ka fatin e keq të kafshojë mollën e kalbur të realitetit të vrazhdë. Një shoqëri që rri e ngrirë, e pllakosur, e nënshtruar në masë ndaj fatit që i ka caktuar kontekti politik, shoqëror dhe ekonomik, është tejet e vështirë të përparojë ndershëm drejt vlerave morale të shëndosha të demokracisë, të tilla si liria dhe mirëqënia. Kur dibrani i thjeshtë të mund të posedojë lirinë e kllapuar nga politika dhe mirëqënien individuale me punë të ndershme, do mund të shihen vobegtë drita shprese për një të ardhme sa më të mirë.



Ndikimet mjedisore *që vijnë nga aktiviteti minerar* **në Bulqizë**

Nga **DANJEL BICA ***

Bulqiza shtrihet në pjesën verilindore të Shqipërisë, me një lartësi që shkon nga 330- 1800m mbi nivelin e deti me një sipërfaqe 728 km², ndërmjet koordinatave gjeografike në veri shtrihet në +41° 30′ 43.10″ dhe në lindje +20° 14′ 56.21″. Sipërfaqja administrative 45,6 km² e cila përbën 6,26% të sipërfaqesh së përgjithshme të Bulqizës. Popullsia që jeton në qytetin e Bulqizës është 13000 banorë, ndërsa i gjithe rrethi numëron 43.000 banorë. Si çdo qytet tjetër në Shqipëri dhe këtu janë prezente problematika të shumta mjedisore që hasen në këtë zonë ku një nga më kryesoret janë mbetjet e kromit, si pasojë e hapjeve të galerive të shumta private, karrierat e kromit që gërmojnë tokën në shtresat sipërfaqësore, kanë çuar ne shkatërrimin e tokës dhe sipërfaqeve të gjelbëra që nuk respektojnë lejen mjedisore ose një pjesë e mirë e tyre nuk janë të licensuar fare. Mjedisi në këtë zonë është problematik pasi mbeturina e dala nga kromi apo inertet hidhen në sipërfaqe pa ndonjë rregullsi të caktuar, duke mbuluar sipërfaqen bimore, duke çuar në degradimin e tokës dhe sipërfaqes përreth që shoqërohen dhe me humbje të habitatit përkatës në atë zonë.

Por kemi dhe një ndotje të ujit nëntokësor pasi uji i dalë nga puset e galerive përmban grimca të ngurta, mineralizimi i ujërave i përket tipit hidrokarbonat magnezit, me pH 4.8- 5. Elementet e ndotjes që përmban uji vijnë nga lënda plasëse që është e tipit amonit si dhe nga gazrat që dalin në thelluesi mbi 800 m. Natyra e ujit të Bulqizës quhet agresive ajo gërryen dhe betonin se është e tipit magnezial, uji është me fortësi maksimale, megjithatë nuk ka ndonjë rregull si të këtij uji që del nga minierat në sipërfaqe. Me poshtë po ilustrojmë problemet mjedisore të gjetura: Minierat e kromit, inertet, Mbeturinat (të gjitha llojet), Ndërtimet pa leje, Ujërat e larta (deluvionet që vijnë si rezultat i ujërave të larta)

IDETË DHE STRATEGJITË PËR PËRMIRËSIMIN E SITUATËS MJEDISORE

Duke pasur parasysh problemet mjedisore që ndodhen në këtë zonë, ndërhyrjet për përmirësim janë të shumta, por theksojmë se të gjitha minierat e kromit duhen të pajisen me leje mjedisore sipas ligjit Nr. 10448 datë 14.07.2011 dhe të zbatojnë të gjitha pikat që përmban ajo në zbatimin me ligjin Nr.10 431, datë 9.6.2011 për mbrojtjen e mjedisit, inertet apo mbetjet e dalë në sipërfaqe të mos dëmtojnë mjedisin përreth vetëm në lejen e caktuar, t'u bëhet pritë ujerave nëntokësore.

Të behet një trajtim i mirë i mbetjeve, të mos lihen të lira në sipërfaqe, është e domosdoshme ndërtimi i një landfilli dhe një projektim për vend depozitimin e mbetjeve. Studimi i mbetjeve ka përcaktuar se më shumë se 50 % e mbetjeve bashkiake është aktualisht e biodegradueshme që do të thotë se sipas Direktivës së BE për Landfillet, që është e domosdoshme ndërtimi i një Landfilli për fakt se ky imponon një ndarje të konsiderueshme të mbetjeve të degradueshme nga mbetjet që përfundojnë në Landfill. Për më tepër ka sasia të konsiderueshme të materialeve që mund të riciklohen si qelqi, tekstile dhe plastika etj. Sasia e mbetjeve të prodhuara nga shëndetësia është e ulët për faktin se mbetjet grumbullohen zakonisht në pikën e gjenerimit dhe marrja e mostrave nuk është kryer në strukturat shëndetësore. Bashkia të marrë masa në ndërtimet pa leje të mos lejojë ndërtimin e tyre, ujërat e rrjedhshëm si ato të dala nga nëntoka dhe ato sipërfaqësore t'u bëhen prita dhe t'u jepet një drejtim i mirë i tyre.

Drenazhimi i zonës është dhe një problem tjetër që duhet rishikuar me kujdes por që të zbatohen të gjitha këto të përmendura më sipër duhet që të bëhet dhe një studim i mirë mjedisor i të gjithë zonës dhe fondet për mbrojtjen e mjedisit të mos jenë të kursyeshme, dhe duhet të punësohet një grup i mirë ekspertësh në fushën mjedisore.

Duke pasur parasysh nga çka thamë më sipër për zonën nevojiten: Ndërhyrje në aspektin mjedisor, të zbatohen të gjitha ligjet mjedisore. T'u jepet leja mjedisore për shfrytëzimin e aktiviteteve personave që plotësojnë kushtet e lejes. Bashkia e Bulqizës duhet të jetë më e kujdesshme në aspektet mjedisore.

Mjedisi në zonën e Bulqizës, pa mbështetjen dhe ndërgjegjësimin e banorëve po shkon drejt degradimit pasi ata nuk janë të mirëinformuar këtu mungojnë organizatat mjedisore dhe donatorët e huaj për investimet dhe mbështjetje. Kjo si rezultat i keq menaxhimit të mjedisit nga banorët dhe pushteti vendor, jam i mendimit se duhet të jetë me i vëmendshme në problematikat mjedisoret e zonës. Zhvillimi i planit të mbetjeve me objektiva strategjike që të përcaktojnë qartë aktivitetet dhe rezultatet e pritura. Duhet të përcaktohen planet përfundimtare për depozitimin, trajtimin e mbetjeve veçanërisht n.q.s. lidhet me një zonë tjetër, si në rastin konkret. Një plan menaxhimi për mbetjet e rrezikshme që përfshijnë një plan riparimi për zonat e dëmtura gjatë aktivitetit minerar ku nuk është zbatuar plani i rehabilitimit. Krijimi i qendrave të trajtimit të mbetjeve për sterilizimin dhe trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore. Riparimi i venddepozitimeve ekzistuese për mbetjet urbane në Bulqizë (x2)

Bulqiza ka sipërfaqe të konsiderueshme të zhveshura nga pyjet që ndikojnë negativisht në mbrojtjen e tokës nga erozioni. Për këtë arsye mbrojtja e mjedisit do fokusohet kryesisht në shtimin e pyjeve si dhe në mbrojtjen e burimeve të tjera natyrore nga degradimet që mund të vijnë si rezultat i keq menaxhimeve.

Shoqata "Ekspertët e rinj mjedisor kombëtar"

AJA
AlpJon ALBANIA
Address: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kati II.
Tiranë, Albania
Mob: +355 (0) 67 47 32 492
E-mail: info@alpjonalbania.com
Web: www.alpjonalbania.com

Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
padit Kryetarin e Bahskisë së Peshkopisë dhe tre vartës të tij

Ilir Krosi: *Dikujt duket se nuk i pëlqen që të rikandidoj për* **bashkinë e Dibrës**



ILIR KROSI: Unë jam në mandatin e tretë dhe jam një kandidat potencial për t'u rizgjedhur në krye të kësaj bashkie.

Jam i gatshëm të bashkëpunoj me transparencë me organet e drejtësisë, duke u vënë në dispozicion të tyre...

Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka kallëzuar penalisht kryetarin e bashkisë Peshkopi, Ilir Krosi me akuzën për shpërdorim detyre. Po me këtë akuzë kallëzohet edhe kryeinspektori aktual i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të bashkisë Peshkopi, Gafur Gazidede, si dhe ish kryeinspektorët, Halil Zhuka dhe Dilaver Drizi.

Krosi ndodhet në krye të bashkisë Peshkopi për tre mandate radhazi nën siglën e PD-së, ndërkohë që pretendon të garojë përsëri në zgjedhjet e 21 qershorit. Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka thënë se në të paktën në shtatë raste zyrtarët e lartë të kësaj bashkie nuk kanë vepruar siç parashikon ligji për ndalimin e punimeve të kundraligjshme të kryera në territorin e bashkisë Peshkopi, duke shkaktuar mospërmbushjen e detyrimeve ligjore për mbrojtjen e territorit.

Menjëherë pas akuzës ka reaguar kryebashkiaku Ilir Krosi. Në një takim me median ai ka theksuar se ndjehet i befasuar nga lajmet, ku bëhet fjalë për një kallëzim penal të IKMT-së për disa punonjës të bashkisë, përfshirë edhe atë vetë. "Në fakt kjo është surprizë, ka thënë Krosi. Ne nuk kemi dijeni për një procedim të tillë, pasi IKMT-ja na kërkuar dhe vazhdon të kërkojë shpesh herë informacione për ndërtimet e paligjme, ku ne i kemi vënë respektivisht në dispozicion informacionet e duhura, duke mbetur të hapur e bashkëpunues me ta".

"Ky është një moment i trazuar politik ku media elektronike dhe ajo e shkruar po publikojnë lajme të tilla ku në të shumtën e rasteve ata dalin tollumbace të radhës. Ka katër vite që KRRT-ja e bashkisë Peshkopi nuk ka lëshuar leje ndërtimi pasi nuk kemi plan-urban për qytetin për të cilin po përfundojmë studimin në këtë drejtim. Në këtë rast bëhet fjalë për disa avlli dhe shtesa të vogla që kanë shkaktuar më tepër probleme mes fiseve e fqinjëve. Disa nga këto shkelje janë në studim e sipër për tu korrigjuar, pasi janë bërë në shkelje të lejeve të dhëna, të cilat theksoj se janë në procedurë e sipër nga ana jonë. Gjithësesi, unë mbetem i hapur në këtë drejtim për të bërë transparencën e duhur", ka theksuar kryetari aktual i bashkisë së Peshkopisë

Në fund, ai e mbyll reagimin e tij, duke e lidhur kallzimin penal me zgjedhjet e ardhshme lokale.

"Unë jam në mandatin e tretë dhe jam një kandidat potencial për tu rizgjedhur në krye të kësaj bashkie, thotë Ilir Krosi. Kjo është në sajë të një presioni pozitiv që unë kam nga ana e elektoratit, nga strukturat e PD-së dhe për këtë unë kam shprehur gatishmërinë për ta pranuar sfidën e rikandidimit, edhe pse për të katërtën herë. Por kjo nuk i pëlqen dikujt dhe përpiqen të na njollosin me akuza të tilla të pa qena. Jam i gatshëm të bashkëpunoj me transparencë me organet e drejtësisë duke u vënë në dispozicion të tyre", ka thënë kryetari aktual i bashkisë së Peshkopisë.

Hysen Likdisha

Radika, *lajme kontradiktore mbi vazhdimin* **e projekteve**

"Fatkeqësisht, kjo është edhe një herë vërtetim i asaj që është thënë disa herë: ministrat dhe qeveria e Maqedonisë nuk janë për t'u besuar deri në momentin kur nuk do të ndërtohet një ligj i ri, i cili do të revokojë ligjet e mëparshme dhe do ta ndalojë njëherë e mirë ndërtimin e hidrocentraleve me ujërat e Radikës".

Pas publikimit të gazetës britanike "The Gardian" të lajmit se BERZH po shikon tërheqjen nga financimi mbi hidrocentralin "Ura e Boshkut" ka pasur reagime nga shoqëria civile dhe organizatat që janë marrë me mbrojtjen e ekosistemit të lumit të Radikës dhe Parkut Kombëtar të Mavrovës.

Ndërkohë, burime të gazetës thonë se ndërmarrja energjetike ELEM në Maqedoni e ka përgënjeshtruar lajmin e gazetës britanike, duke thënë se "nuk kanë një përgjigje zyrtare nga BERZH". Sipas tyre, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka kërkuar më shumë procedura, prej te studimi i ndikimit mjedisor te projektit "Ura e Boshkut" e deri te procedurat e tenderimit, të cilat duhen përsëritur, pasi janë evidentuar shumë mangësi. Sipas ELEM, BERZH ka pezulluar punën me këtë projekt, derisa të përfundohet një studim i ri për ndikimin mjedisor.

"Por e keqja është se termat e referencës i shkruan ELEM dhe ata gjithmonë kanë mundësi të shtrembërojnë gjerat, duke dhënë instruksione të gabuara", - thotë Bardhyl Marku.

Një anëtar i një shoqatë për mbrojtjen e Radikës tha se kanë kontaktuar edhe një ekspert mjedisor që ka bërë studimin për hidrocentralin e Fushës së Llukovës, i cili ka shkruar në studim ato gjëra që i kanë interesuar qeverisë dhe ELEM, pavarësisht se ai nuk ka qenë dakord. "Unë jam paguar për ta bërë një gjë të tillë", - ka thënë në konfidencë ai.

Burime nga Ministria e Mbrojtjes së Ambientit Jetësor ne Maqedoni kanë deklaruar se, ndërsa për projektin "Ura e Boshkut" mund të ketë vonesa, për projektin "Fusha e Llukovës" mund të ketë ecuri të shpejtë të punimeve. Burimi thotë se të gjitha dokumentacionet janë gati, mungojnë vetëm financimet.

"Fatkeqësisht, kjo është edhe një herë vërtetim i asaj që është thënë disa herë: ministrat dhe qeveria e Maqedonisë nuk janë për t'u besuar deri në momentin kur nuk do të ndërtohet një ligj i ri, i cili do të revokojë ligjet e mëparshme dhe do ta ndalojë njëherë e mirë ndërtimin e hidrocentraleve me ujërat e Radikës".

Më 4 mars, lidhur me këtë çështje do te ketë diskutim publik në Mavrovë për shpallje të parkut kombëtar të Mavrovës si zonë të mbrojtur. Ndërsa në Shkodër, më 9 dhe 10 mars do të mbahet një konferencë me qëllim mbrojtje të basenit të Drinit. Në këtë konferencë do të marrin pjesë disa organizata nga Maqedonia.

Gjatë këtij muaji, disa organizata mjedisore në Tiranë protestuan para Ministrisë së Jashtme dhe kërkuan ndërhyrjen e Shqipërisë në pengimin e devijimit të lumit Vjosa në Greqi, çështje e ngjashme me të Radikës.

Një burim në takim, tha se është folur edhe për çështjen e Radikës, dhe ministri Bushati ka garantuar se po e shikojnë çështjen në proces dhe në përputhshmëri me të drejtat ndërkombëtare. "Shqipëria, - ka thënë Bushati, - nuk do të lejojë të preken interesat e Shqipërisë dhe çdo mosmarrëveshje do të zgjidhet bazuar në ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të detyrueshme dhe të nënshkruara për të dy shtetet".

Rr.A.



Firmos dhe **komento peticionit** në **change.org**

http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides



Të gjitha informatat me rëndësi, si shkrime, intervista, lajme, video dhe audio, lidhur me mbrojtjen e lumit Radika mund t'i gjeni në:

http://saveriverradika.com

Fjalë arabe *që qarkullojnë* **në të folurën e Dibrës**

Nga **SULEJMAN TOMÇINI**

Ashtu si në mbarë gjuhën shqipe,edhe në të folurën e Dibrës përdoren shumë fjalë arabe,qe kane hyrë nëpërmjet turqishtes. Disa prej tyre ruajnë kuptimin dhe domethënien e tyre origjinale,ndërsa disa të tjera jane transformuar.Këte transformim mund ta kete bere gjuha turke,nga e cila erdhën tek ne,ose edhe vete gjuha shqipe gjate viteve.Unë nuk e njoh gjuhën turke,që të mund të japë ndonjë mendim të specializuar për përdorimin dhe kuptimin e këtyre fjalëve në këtë gjuhë.Por po mjaftohem duke i rënditur një pjesë të madhe të tyre,se mund të ketë edhe të tjera,duke dhënë kuptimin e tyre në gjuhën arabe.Ndërkohë mund të ketë edhe ndonjë fjalë shqipe që rastësisht ngjason me atë arabe,gjë që mund të sqarohet nga studime te mëtejshme nga specialistët e fushës.

Them se disa prej këtyre fjaleve mund të ishin zëvendësuar me kohë me fjalë të shqipes,disa të tjera tashmë jane rrënjosur dhe janë bërë pjesë e fondit të saj leksikor.Megjithate, me pakë përpjekje, shumica e tyre mund te zëvendësohen me fjalë shqipe.

* * *

(Vijon nga numri i kaluar)

Furçë - furçë
Furrë - furrë buke
Gafil - i pavemendje, papandehur
Gafur - falës i mëkateve
Gaile - gjë e keqe, e ligë; ligësi; fatkeqësi; tmerr; vdekje
Gajb - mungesë, gjithshka e padukshme, e fshehur; dyshim; bota e përtejme.
Gajret – pasion, dëshirë; zell, hov; duf
Gajtan – konop prej fijesh mëndafshi për zbukurim rrobash
Gamile – deve
Gardall - sinap, mustardë, hardal; kokrra sinapi.Në të folmen e Dibrës vjen me kuptimin kaba dhe i vjetër
Gargare - gargare
Garib – i huaj, prej një vendi tjetër
Gazelë – sorkadhe
Gazep - zemërrim
Gjynah - mekat,faj,delikt. Gjynahqar- mekatar, fajtor
Glon - zmadhim, tejkalim mase; teprim; ekzagjerim; veprim i skajshëm, teprim, ekstremizëm; përpjekje, zell
Gol - prej ketu edhe gogol - shpirt i keq; demon; përbindësh; lugat; monstër
Gonxhe - gjest lozonjar; spitullim, koketëri; flirtim
Gurabi – ëmbëlsirë e shkriftë me gjalp e miell
Gurbet – vend i huaj,emigracion,jeta në dhe të huaj
Gurgule - gurgullimë; zierje ngadalë
Gysël - larje; larje e të vdekurit; ujë për larje
Haber - lajm, njoftim, kumtim
Habs – ndalim, futje në burg, burgosje
Habsane - burg (habs- burg dhe hane- bujtinë)
Hadith – tregim; fjalë të thëna nga Profet Muhamedi
Hafif - peshëlehtë, i lehtë
Hafije - agjent i policisë sekrete, spiun
Hafuz – 1. ai që din Kuranin permendesh; 2. ai qe mban mend a ruan diçka
Hajat - jetë
hajër - mirë, mirësi; interes, përfitim; mirëqëni, pasuri. Prej këtu fjalët e përbëra si hajr + li – për të mirë; hajrsëz (hajr + sëz) – që nuk bën mirë,që s'ka ndonjë të mirë.
Hajmali - mbajtës i diçkaje, transportues peshash, duke i mbajtur ato ne kurriz; ruajtës i letrave me vlerë; prurës i një letre a dokumenti etj.
Hajn - tradhtar; i pabesë
Hajvan – kafshë
Hak - e drejta, e vërteta, ajo që të takon me të drejtë. Mori hakun – mori të drejtën,mori atë që i takon. Hak + marrje- marrje e të një të drejte që të takon.
Hakaret – i piste, i fëlliqur.
Hakikat - e verteta; thelbi i dickaje; realja
Hala - me një herë, sapo.Në Dibër ka hyrë me kuptimin **ende**
Hale – nevojtore
Halet – vegël a mjet pune.
Halis - i pastër, origjinal; i vërtetë
Hall – gjendje, situate, rrethanë, problem.Jam ne hall- jam ne vështirësi
Hallakatje - (vjen nga fjala halka që do te thote rreth). shkoj rrotull
Hallall - i lejuar
Hallat – vegël
Hallë - motra e nënës, teze
Hallkë – rreth; unazë
Hallku - krijesa, njerëz
Hallvë – ëmbëlsirë
Hamall - transportues, mbartës
Hamam – vendlarjeje
Hane - vjen, afrohet koha. *(Vijon numrin e ardhshëm)*



Komentet mbi këtë foto janë interesante. ndiqi ato dhe jep mendimin tend në linkun e mëposhtëm: https://www.facebook.com/dibra.debar.9?fref=ts

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Një muaj mungova dhe u shqetësove shumë për lajmet nga Dibra. Sepse ndonjëherë edhe duhet munguar, pasi për disa ngjarje, më mirë të mos dëgjosh, jo më edhe t'i lexosh.

Për median qendrore, gazeta dhe televizione, lajmet nga Dibra vlejnë vetëm kur bëhet fjalë për dhunë. P.sh., që një burrë rrahu gruan dhe fëmijët, të tre invalidë, gjen vend në çdo ballë gazete, njëlloj për të gjithë - "copy paste" - siç i thoni ju andej, sikur po tregon për modelin se si duhet të jenë burrat dibranë të kohërave moderne. Ose lajmi tjetër për një bandill, që shkoi me xhepat plot, si bos, të qethte tre prostituta dhe doli i rruar prej tyre... Apo kinezët e galerisë së Bulqizës, që, pasi shpëtuan nga grabitja, tregonin përralla se si arti i tyre i Kung-Fusë kishte çarmatosur hajdutët me kallashnikov...

Iku shkurti, i shkurtër siç është. Një ministër na pat thënë se në fund të muajit do kemi tender për rrugën, por ndoshta ngaqë muaji ishte i shkurtër, mund ta kenë lënë për në mars... Po s'pati as në mars, mos u mërzit, vjen prilli e kështu me radhë, muaj pas muaji. Se të gënjesh në këtë vend nuk është më turp.

Këndej ka filluar fushata. Na shkoi jeta në fushatë: 6 muaj përpara për të zgjedhur kandidatët, 6 muaj më pas për të numëruar votat. Kështu që gjysmën e mandatit na shkon me zgjedhje; gjysma me vjedhje. Për të qeverisur mbeten veç ca ditë.

Thashë ta nxjerr edhe unë njëherë emrin për kandidat, por nuk plotësoja kriteret: nuk kam para nën jastëk, se në bankë s'kam që s'kam - veç kredi, dhe nuk kisha fjetur një natë në Veleshtë.

Në fshatra vazhdojnë pakënaqësitë. Bien njerëzit të flenë pa drita dhe zgjohen në mëngjes me faturat milionëshe të dera. Ndërsa ata që i kanë vjedhur, kanë ikur në drejtim të paditur nga qeveria. Kështu që arrest për arrest, hajdutët i lëmë të lirë që të prishin paratë e vjedhura, ndërsa të varfrit i çojmë në burg, ku u sigurohet ushqim, drita dhe një dyshek për toke për të fjetur...

Si çdo fillim viti del në skenë Radika. Ca thonë do bëhet, ca thonë s'do bëhet. Ca nuk do e lejojmë, ca nuk kemi ç't'i bëjmë. Vetëm kur ta shohim lumin e tharë do të kujtohemi se sa shumë jemi marrë me fjalë...

Bulqiza pati tre festa në një ditë: 67 vjetorin e minierës, 50 vjetorin e sport klubit dhe 24 vjetorin e krijimit të PD-së. Për të fundit u kujtua partia ta festonte, për sportin u kujtuan sportistët, ndërsa për minierën u kujtua askushi. Të kishte ndodhur ndonjë aksident me kinezët në të njëjtën datë, ndoshta do ishte kujtuar dikush edhe për minierën...

Korabi e nisi sezonin me largimin e një akrobati dhe afrimin e një humoristi. Kështu që, edhe në qoftë se humbim - larg qoftë, e kalojmë dhimbjen me terapinë e humorit. Këtë e kuptuan edhe tifozët, që në ndeshjen e parë kishin shkruar parullën e madhe: "O Korab mos ki frikë, se ke djemtë në Amerikë". Pas kësaj parulle kuptova se ju në Amerikë nuk thoni më "Jemi prej Dibre", por "Jemi nga Korabi"...

Fillimi i vitit ishte i vështirë për dibranët. Rrugë të bllokuara, borë e madhe. Ftohtë. Një lexues më shkroi email dhe më tha: "Or taj voc, tahaj at rubrikën tande baje me ni rresht: Dibra ka mërdhajft"!



Ndiqe gazetën Rruga e Arbërit në Facebook
në linkun e mëposhtëm:
https://www.facebook.com/pages/Rruga-e-Arbërit

reportazh


FSHATI BLLACË

Në Teqenë e Bllacës

Bllaca, një fshat i vogël, por me emër të madh. Emri i tij njihet i regjistruar në defterin turk të vitit 1467. Banorët e parë të tij kanë qenë te besimit katolik.

Nga **DESTAN RAMA**

Një ditë, tek po meditoja, m'u kujtua ajo ditë gushti e vitit 2014. Kujtimet dhe mbresat e asaj dite s'më lënë të qete. Vendosëm që dy familje të shkonim për vizitë në Teqen e Bllacës. Pasi bëmë përgatitjet e duhura, u nisëm me të dy makinat për në Bllacë, në mëngjes.

Një pjesë të Fushës së Dibrës, luginën e Drinit të Zi deri tek Ura e Çerenecit e ka mbuluar një si tis i hollë i tejdukshëm. Janë avujt e ujit dhe vesa e mëngjesit që po avullojnë nga rrezet e diellit. Natyra ka veshur kudo petkun e bukur të gjelbërimit. Gjallesat kanë filluar punën në ditën e re. Milingonat punëtore po mbledhin pa pushim ushqimin në shtëpinë e tyre, ndërsa bulpthat shtyjnë me forcën e këmbëve të tyre topthat,që gjatë rrokullisjes sa vijnë e zmadhohen si të ishin topa bore. Bilbilat na shoqërojnë gjatë gjithë rrugës me atë zërin e tyre të mrekullueshëm, që të mahnit, të ëmbëlson shpirtin e të jep krahë për të fluturuar. Luginat e bukura të Grykës së Madhe dhe të Grykës së Vogël të fusin thellë në gjirin e tyre, të shtrëngojnë fort e s'të lënë të shkëputesh nga bukuria e tyre magjepsëse.

Sapo lëmë prapa Urën e Sebinit, makinat marrin rrugen malore në drejtim të fshatrave Kovashicë, Zogje e më tej për në Bllacë. Rruga është tepër malore dhe dredhon nëpër sqetullat e krahët e kodrave, a thua se është një litar i futur në thes.

Më në fund, pas një grahme të gjatë të motorëve të makinave arritëm në shesh mbi fshatrat Bllace e Zogje, të cilët duken poshtë si të ishin në fundin e botës. Këtu dallojmë në mes të lisave të lartë një kube me ngjyrë blu e ndërtuar e tëra me duroalumin e veshur me xhama me te njejtën ngjyrë. Kjo është Tyrbja e Teqes së Bllacës. Në të prehen disa klerikë të besimit Bektashian, të cilët ia kushtuan një jetë të tërë këtij besimi fetar. Me hiqmin e tyre mistik fetar dhuruan, ripërtërinë e shpëtuan shumë jetë njerëzish.

Hymë brenda në Tyrbe. Në Mezarët e tyre lexojmë emrat: Babë Sufa iParë, Babë Sufa i Dytë, Baba Zeneli, Baba Xhemali. Nënë Havaja, që na shoqëronte, na shpjegonte për çdo gjë. Në oborrin e Tyrbes ndodheshin disa varre të tjerë; ata ishin të dërvishëve që kishin shërbyer në Teqe dhe që shpirtin e tyre ia kishin falur asaj.

Më pas makinat ulin kokat dhe dredhojnë në rrugën me baltën e tharë në shpatin e kodrës që të çon në Teqen e Bllacës. Nga maja e kodrës të veshur me drurë të dendur lisi, poshtë, duket një fushë e bukur e veshur ngjyrë jeshile, në formën e një kupe me fund të rrafshët. Të kënaqet syri e të gëzohet shpirti kur shikon atë bukuri të rrallë në gjirin e maleve. Këtu ka qenë Liqeni i Bllaces para disa vitesh,- tha Avniu. Uji i tij shkonte ne Maqellarë për të vaditur tokat e atjeshme të etura për ujë. Por ja që vitet sollën ndryshime.

Fusha e Bllacës përseri u kthye në identitet. Sot bllacasit mbushin hangarët e tyre me barin e jonxhën që prodhon fusha, mbushin kosharët me misër e thasët me patate. Jo më kot dëgjojmë shprehjen: Patate si ajo e Bllacës s'gjendet kundi.

Në veriperëndim të fushës, buzë malit me të njëjtin emër, është pozicionuar fshati Bllacë. Një fshat i vogël ky, por me emër të madh. Emri i tij njihet i regjistruar në defterin turk të vitit 1467. Bllaca njihet si vendbanim i hershëm. Banorët e parë të tij kanë qenë te besimit katolik. Ashtu si kudo edhe këtu kanë ardhur e janë larguar armiq të shumtë pushtues osmanllinj, sërb, fashistë italianë, nazistë gjermanë e tradhtarë të shumtë. Populli i Bllacës ka ditur të qëndrojë përpara tyre me trimëri e heroizëm të pashoq. Edhe sot bllacasit kujtojnë bëmat e bijve te tyre: Hysen Tasha, Ismail Krosi, rënë në luftë kundër sërbëve, Man Jellën e Aqif Zenelin, rënë në Luftën Nacional-clirimtare. Gjithmonë përkrah tyre ka qenë Teqja e Bllacës. Ajo u bë çerdhe e bazë e luftës. Këtu u strehuan partizanet, u ushqyen u veshmbathen me mundësitë e kohës. Këtu u përhap për herë të parë drita e diturisë Kjo ndodhi në vitin 1893, kur u çel Shkolla e Parë Shqipe.

Kthesa e fundit e rrugës, majtas, për dy minuta na çoi në oborrin e dy ndërtesave binjake të strukura në gjirin e kodrës, me një oborr të mirëstrukturuar, të sheshtë e të bollshëm. Përpara na doli për të na uruar mirëseardhjen i zoti i shtëpisë, Hirësia e tij Baba Ismail Jangulli. Shtrëngimi i duarve e fjalët e ëmbla të tij na rrëqethën mishte e na gëzuan shpirtin U ndiem sikur ishim në shtëpinë e zotit.


TEQJA E BLLACËS

Baba Ismaili është njeri i thjeshtë i lindur në fshatin simpatik, Godvi, në Grykën e Madhe, Komuna Zerqan, rrethi Bulqizë. Në këtë fshat babai i tij, Mehmet Jangulli, bashkëkrahës i Ismail Qemalit, tek Vidhi i Madh, në kodër të fshatit, aty ku bëheshin mbledhjet, ngriti flamurin e dalë nga Qeveria e Vlorës, e mbrojti atë nga dora e armikut. Kështu u bë shembull i atdhetarizmit për të gjithë zonën e më gjerë. Baba Ismaili jetën e tij ia kushtoi fesë Bektashiane duke i shërbyer asaj me devotshmëri e përkushtim.

Drejton Teqen e Bllacës, e cila është një nder Teqet e shumta me emër në Shqipëri. Kjo është pjesë e Gjyshatës së Fushë - Krujës e themeluar që në vitin 1893 nga Babë Sufa i Parë. Në vitin 2014, ajo festoi me madhështi 121- vjetorin e themelimit të saj. Do të mbahet mend për gjatë nga të gjithë pjesëmarrësit në Kongresin e Bektashinjve në Tiranë, fjala e mbajtur nga Baba Ismaili. Ai foli pa letër, por fjala e tij peshonte rëndë nga emocioni dhe mesazhi që mbante.... Kush e don Helibejtin, të punoje me zemër.... dhe ne mbyllje; Myslimanë e Bektashinj, te gjithë shqiptarët janë, një besë, një gjak, një dritë. Fjala e tij tregoi se Baba Ismaili është një shërbëtor i Zotit, një simbol i besës.

Po të bëjmë një krahasim me të kaluarën, sot na del që kjo Teqe nga një ndërtesë e thjeshtë me gjashtë dhoma, sot me dy ndërtesa dykatëshe me hotel e pajisur më së miri me kuzhinë, me sallë ngrënie, me dhome të veçantë ku kryhen shërbesat fetare dhe plot dhoma të tjera që shërbejnë për të akomoduar të ardhurit besimtarë të panumërt.

Dikur ky vend i zotit pa ujë të pijshëm, sot zbret vrullshëm nga malet e Bllacës uji i ftohtë e i pastër si kristali duke u falur kështu jetë e kënaqësi banorëve të Teqes dhe vizitorëve të shumtë që vijnë këtu nga e gjithë Shqipëria.

Një ditë e paharruar kjo e sotmja për ne. Një pritje e përzemërt me dashamirësi,një ngrohtësi familjare e përkryer. U ndjemë si në shtëpinë tonë në atë drekë të shijshme, shtruar ne dhomën e bukur të ngrënies të mbushur plot me njerëz të mirë në atë vend të mirë. Aty u njohëm dhe u miqësuam me një familje nga Kruja, një nga Homeshi dhe të tjera. Këtu është vendi i paqes, i harmonisë njerëzore, i miqësisë, i dashurisë për njëri-tjetrin, - tha Baba Ismaili, dhe në çast jehoi zëri i tij i ëmbël duke kënduar, lahitë e tij të shoqëruar me tum-tumet e tumalekut, simbol i Teqes Bektashiane.

Urimet e pjesëmarrësve nuk reshtën gjatë gjithë kohës për babanë. Të paçim për jetë! Rrofsh sa malet e Bllacës! Të këndoftë goja dhe zemra!

U ndamë me Baba Ismailin, me atë njëri të Zotit, me shpresën se do të takohemi përsëri dhe shpejt. Na përcolli deri në kufirin e Teqes, sipas zakonit, dhe na uroi rrugë të mbarë!

Ne kemi në xhep fotografitë e shumta që bëmë, të cilat na çmallin sa herë i shikojmë a meditojmë për atë ditë të paharruar gushti.

OFROJMË
redaktime - korrigjime
ftesa - fletëpalosje
fotokopje - kartvizita
printime - lidhje libri duke filluar
nga 1 kopje e vetme!

Çmime të favorshme dhe shpejtësi!
Telefono: 068 65 08 441

SHTËPIA E LIBRIT FLETA XXI PESHKOPI BOOK HOUSE
LIBRI PRANË JUSH
LIBRARIA FLETA XXI,
PRANË MUZEUT, PESHKOPI

Rruga e Arbërit nr. 106

Arbër Rrapi, djaloshi
që "luan" me kryeministrin

Vjedhja e energjisë, nga "hall" në argëtim

Nga **SASHENKA NDREKA**



KUR KRYEMINISTI "VIHET NË LOJË"

Të bësh satirë me relitetin që dhemb, do një aftësi të madhe... Në ditët e sotme ka shumë pak Migjenër...Djaloshi dibran ka gjetut mënyrën e tij mjaftë origjinale për të pasqyruar një të vërtetë që ka mbërthyer Shqipërinë për fyti . Ai ka një emër mjaft te bukur që lidhet pazgjithshmërisht me gazeten tonë. Quhet Arber. Ai është një djalë Dibre, është vetëm 24 vjec dhe sapo ka përfunduar studimet e larta për informatikë. Mund të themi me plot gojën që është i riu më i famshëm i momentit, dhe jo pa qëllim. Loja e krijuar nga ai vetë "Edi Rama dhe Hajduti" ka bere një bujë mediatike, sidomos në rrjetët sociale.

Arbri pranon se vjedhja e energjisë elektrike ishte kthyer tashmë në një problem të madh ekonomik dhe shoqëror dhe ishte pikërisht Kryeministri Edi Rama që mori një rol mjaft aktiv në luftën e madhe kundrejt këtij fenomeni. Zgjedhja ishte krejt e natyrshme dhë mëse e goditur, për të arritur që loja të kishte vizibilitetin dhe suksesin e duhur. Ideja për të bërë një lojë me temën e vjedhjes së energjisë ka ardhur si një mënyrë për të ndërgjegjësuar njerëzit që të paguajnë energjinë.

Ndërsa e pyesim si lindi idea e fabulës Arbri përgjitgjet:" Realiteti jonë i përditshëm na jep dhe më jep shumë spunto për fabula të tilla dhe të ngjashme. Loja është e ideuar në Tiranë dhe në arkitekturën e saj mund të dalloni lehtë ndërtesat e njohura që përbëjnë peizazhin tonë të përditshëm. Është qyteti jonë i mbushur me drita dhe shkëlqim, por në të cilin kemi dhe shumë individë që mundohen në forma të ndryshme, shpesh herë jo korrekte të përfitojnë.

Personazhi i parë është "hajduti" i cili kërkon të vjedhë energjinë elektrike dhe personazhi tjetër kryesor është figura e Kryeministrit Rama, i cili përpiqet të kapë "hajdutin" në rrugëtimin e tij drejt burimit të energjisë. Me këtë rast dua të falënderoj stafin e punës dhe Klajdi Dinellarin për ndihmën dhe mbështetjen. Se kush fiton në fund, varet nga aftësitë e çdo përdoruesi dhe lojtari."

Arbri ndërkohë është i angazhuar dhe me shumë projekte të tjera. Ai aktualisht punon në një studio programimi dhe është vetëthemeluesi i saj, njëkohësisht është pronar i platformës shëndetësorë më të rëndësishme në treg doktoriim.com.

Ndërsa e pyesim për projektet më të fundit arbri nuk do të prononcohet pa i materializuar plotësisht ato, por na siguron se do të jetë dicka komlet ndryshe dhe po aq sencasionale sa kjo e Ramës me Hajdutin.

ENERGJIA DUHET PAGUAR

"Loja nuk ishte diçka për të cilën u punua shumë. Gjithçka u bë për 4 ose 5 ditë. Një lojë që ka tri elemente: idenë, grafikën dhe zhvillimin e programit. Më shumë kohë në këtë lojë na ka marrë grafika dhe sidomos personazhi i Edi Ramës. Ne dëshironim që ta shfaqnim sa më real. Mirëpo



ai si person ka shumë mimika, edhe ne duhet të zgjidhnim atë të duhurën. Kjo na i vështirësonte pak punën. Kemi bërë shumë skica derisa arritëm në skicën finale. Punuam gjithashtu edhe për të sjellë idenë e Tiranës në sfond, duke ndërtuar pallatin shumëkatësh në qendër, kullën e sahatit dhe xhaminë", tregon Arbëri për një gazetë qendrore. "Figura e kryeministrit është shumë karizmatike. Prandaj e kam vendosur në qendër të lojës, si me figurë, ashtu edhe me audio", shprehet autori i lojës. Me anë të vështrimeve dhe zërit, personazhi i Edi Ramës i ushtron presion lojtarit, që është në rolin e hajdutit të energjisë elektrike.

Pjesa audio është shkëputur nga një fjalim i kryeministrit mbi energjinë. Kjo audio vazhdon të përsëritet gjatë gjithë lojës me zërin origjinal të Ramës.Kryeministri në lojë thotë: "Pasi janë rreth 150 milionë euro çdo vit që vidhen, humbasin, shpërdorohen, janë 80 deri 100 kilometra rrugë, që në vend që të ndërtohen vit pas viti mbeten të pa ndërtuara. Për këtë arsye hajdutët e energjisë elektrike janë armik i përbashkët i popullit shqiptar, i Shqipërisë sot, i së ardhmes së fëmijëve tanë. Për këtë arsye ne do të jemi në një luftë, që nuk është bërë deri më sot, me çdo hajdut të energjisë elektrike, edhe me çdo gjykatës, që do të guxoj t'i trajtojë hajdutët e energjisë si kalimtarë përpara trupit gjykues, edhe do të mjaftohet me gjoba qesharake, nga 2 mijë lekë të vjetra për hajdutët që i vjedhin këtij populli 150 milionë euro".

Suksesi i lojës ka qenë një surprizë edhe për vetë 24-vjeçarin. "Jam i entuziazmuar që ka një impakt pozitiv ndaj lojës. Shpresoj që loja t'i pëlqejë kryeministrit, që edhe ai të ketë mundësinë të luajë me të. Jam i bindur që mund të bëhen më shumë përpjekje në zhvillimin e programeve dhe lojërave, pasi ka të rinj të talentuar, që nuk shfrytëzohen sa duhet për shkak të mungesës së mbështetjes", shton ai.

SI LUHET?

Që të kesh sukses në lojë duhet të jesh një "hajdut" i kujdesshëm. Loja nis me një hajdut, i cili zbret nga shtylla e energjisë elektrike me një kabull në dorë. Duke prekur ekranin, lojtari bën që hajduti të lëvizë. Ai duhet të jetë i fokusuar me sytë e kryeministrit Rama, pasi nëse ai (kryeministri) kthen kokën, hajdutin e zë korrenti. Duhet ta heqësh dorën nga ekrani i celularit, nëse kryeministri kthen kokën. Nëse arrin ta çosh hajdutin deri te shtëpia e vet, ku ai vendos kabullin në prizë shtëpia e tij ndriçohet, por qyteti zhytet në errësirë. Kjo lojë ka vetëm një nivel, por sfida për çdo lojtar është të vendosë një rekord të ri kohe.

Deri më tani kjo lojë është shkarkuar nga 18.000 përdorues dhe është e vlefshme në të gjithë smartphonët Android.

Eja në Botën e Ngjyrave
"ZAYA STUDIO"
nën kujdesin e piktorit Zaim Elezi, me një eksperiencë të madhe në këtë fushë
ORGANIZON KURSE PËR TË GJITHA MOSHAT
Së bashku ne mund:
- Të mësojmë të vizatojmë
- Të mësojmë të pikturojmë
- Të mësojmë gjithçka rreth artit figurativ
Adresa: **Rr. "Zenel Baboçi", pall. Ferar.** ***Tel:*** **068 22 46 400**

Kujtesë

Lule të pranverës për të humburit e 9 marsit '96

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Nëntëmbëdhjetë vjet pa Ata, pa djemtë e Maqellarës, Grevës, Melanit, Brezhdanit, Reçit..., djem në moshën më të bukur të jetës që më 9 mars të vitit 1996 lanë brigjet e detit të Vlorës për të mos arritur kurrë në brigjet e ëndrrës së tyre. Një plagë e madhe që Dibra e mban të mbyllur pa vullnet e dëshirë ta hapë, një plagë që nuk e di pse s'bëzan, pse nuk thërret e bërtet për të vërtetën e zhdukjes pa lënë gjurmë, një plagë që asokohe pushteti dhe shteti politik ia bllokoi gurmazin që të mos dalë zë.

Në kujtim të tyre po shkëpus një shkrim të Q. Hamzajt botuar në "Zërin e Popullit" më 15 maj 1996...

Le të mblidhemi në breg të Drinit apo në breg të detit për tu përcjellë djemve të Dibrës tufa me lulet e verës, mbledhur në kodrat e Maqellarës, Grevës, Melanit, Rashnapojës, Brezhdanit, Reçit...

* * *

KU BIE SANTA MAQELLARA?...

14 marsi, dita kur fëmijët bëjnë ritet e Ditës së Verës, kur nuset dhe vajzat e reja sjellin në shtëpi ujin e kristaltë të krojeve, ky 14 mars, këtë vit, fushën e Maqellarës e gjeti nën dëborë. Poshtë saj nxinte toka e mbi të rëndonte i plumbtë qielli...Por më i zi e i rëndë se plumbi erdhi në familjen e Ziaudin Qokut në Kllobçisht lajmi i kobshëm se djali i tij 20 vjeçar, Sulejmani, i sapomartuar, humbi jetën në det, duke kaluar me skaf për në Itali... Djemtë e Maqellarës, mjeshtër në bujqësi e punëtorë të fronteve më të vështira në minierë e gjeologji, mbetur pa punë, u janë drejtuar rrugëve të kurbetit, rrugëve të Maqedonisë, Greqisë, Italisë. Vetëm në një vend në rrethinat e Napolit punojnë më shumë se njëmijë maqellaras. Vendi ku punojnë më shumë thirret Santa Maqellara, se sa me emrin e vet, SantaMaria. Dhe ndodhin ngjarje të kobshme... E prapë emigrimi vazhdon. Rendin të rinjtë maqellaras drejt shpresës së madhe si fluturat drejt dritës, ndonëse si fluturat edhe digjen. Mjaft prej tyre kthehen me ndihmat e bashkëkombësve, me ndihmat e qytetarëve të mirë italianë. Listat, me emrat e njerëzve nga e gjithë Shqipëria, lexuar nën lotët çurkë para varreve, sa vijnë e shtohen. Djemtë kthehen në arkivole druri e metali. Ndodh që nuk kthehen as të vdekur...

Trupi i pa jetë i Sulejmanit u preh në gjirin e vendlindjes. Për djelmoshat e tjerë, 29 a më pak, kryesisht maqellaras, që ishin në të njëjtin skaf, asnjë lajm, asnjë shenjë. Dikush tha se i ka marrë një anije e huaj. Dikush thotë se janë burgosur në një vend të huaj. TVSH, tepër thatë, dy javë më pas njoftoi vdekjen e S. Qokut dhe të një viktime të pa identifikuar. Tha se ekspertët shqiptarë më 18 mars kanë shkuar në Itali për të ndriçuar ngjarjen.

Që atëherë heshtet...

Ankth dhimbjeje dhe pritjeje, vegim shprese në familjet e 2 vëllezërve në Burim, të 2 vëllezërve Elezi në Vojnikë, të njerëzve të një gjaku e të një moshe në Kllobçisht, Majtarë, Burim, Vojnikë, Maqellarë, Grevë, Melan, Trepçë, Rashnapojë, Brezhdan...

Dhembje pritjeje e pranishme në çdo familje dibrane...

Emigrantët në Itali pyetjen e parë për ikanakët e kanë "Mos jeni ato të skafit të 9 marsit..."

15 maj 1996

intervistë

Intervista me Orana Sinanin është realizuar në kuadër të bashkëpunimit të gazetës "Rruga e Arbërit" me faqen sociale në FB "Peshkopi,Dibër,Albania". Ajo do botohet edhe në faqen në internet http: peshkopidiberalbania.wix.com. Bashkëpunimi synon të bëjë publike me anë të intervistave sukseset e dibranëve në fusha të ndryshme të jetës.





Orana, aroma e gatimeve dibrane në Master Chef



Nga **SASHENKA NDREKA**

Ajo na bëri të gjithëve krenarë, teksa nga gozhdonte para ekranit çdo të shtunë në mbrëmje. Përfaqësuesja e parë dibrane në Master Chef dëshmoi edhe një herë nikoqirllëkun dhe vnjesen e vajzave dibrane, duke vërtetuar plotësisht pjesën e pare të shprehjes: "Merr vajza në Dibër, por mos jep".

Për 12 javë rresht ajo mbajti denjësisht përparësen e Master Chef duke i dhenë jetë një pasioni të ri për të. Poliglote, juriste, mësuese e gjuhëve të huaja, kuzhiniere... E çfarë do të donte më shumë një vjehërr?

Orana Sinani vjen më një rrëfim krejt të natyrshëm për aventurën që mori disa muaj më parë dhe që solli ndryshme në jetën e saj.

- Si janë fillesat tuaja në një zanat kaq të vjetër si gatimi?

- Gatimi për mua deri para MasterChef nuk është parë kurrë si një profesion. Është një pasion shumë i madh, i ushqyer nga familja ime, pasi tryezat plot na kanë mbledhur gjithmonë bashkë. Çdo gjë fillon që në fëmijërinë time...Kam fatin që kam jetuar gjithmonë me gjyshen dhe me hallën, të cilat gatuajnë shumë mirë, po ashtu mamaja ime është kujdesur që unë të mësoj çdo gjë që i duhet një vajze në kuzhinë.

Gatimin sot e shoh si një pasion të trashëguar, por dhe si një dhuratë të mamasë, të gjyshes dhe të hallës, për të mbledhur njerëzit e dashur në tavolinë dhe për të shijuar ushqimin! Sot falë tyre, unë nuk kam frikë të gatuaj si ushqimet tradicionale ashtu dhe ato moderne.

Meritë të veçantë ka babai im që është munduar gjithmonë të më frymëzojë me idenë se gatimi është një art dhe unë duhet të ndihem e lirë të eksperimentoj!

- Pjesmarrja në MasterChef ishte e mirë menduar, apo një vendim i momentit?

- Pjesëmarrja në MasterChef nuk ishte aspak e mirë menduar. Ishte një shaka e mamit, që më bëri ta mendoj kur pashë spotin e sezonit të parë. Nuk e mora seriozisht, sepse unë e kam një profesion dhe nuk e kisha menduar t'i hyja botës së gatimit, jam kufizuar gjithmonë në kuzhinën e shtëpisë time. Para mbylljes së sezonit të parë, kur u hapën aplikimet, një nga mikeshat e mia të ngushta më tha: "Do e bësh vetë aplikimin, apo të ta bëj unë? Unë mendoj që ti do t'ia dalësh aty". Kaq mjaftoi, mbështetja e njerëzve të dashur për të dërguar aplikimin. Më vonë thirrja për audicione më bëri të kuptoj sa shumë e doja dhe e ëndërroja kuzhinën e MasterChef!

- Cilat ishin pritshmëritë tuaja, duke qenë se u eliminuat në prag të gjysmë finales?

- MasterChef është një eksperiencë të cilën unë e kam shijuar në maksimum për vete faktin se nuk kam pasur pritshmëri! E vendosa që pasi mora përparësen se çdo gjë që do bej dhe çdo fazë qe do kaloj do jetë një arritje, dhe nuk e kam lënë veten në asnjë moment të kem ambicie të tepruar. Të qenit në prag të gjysmë finales thjesht më bëri të kuptoj sa shumë kisha arritur dhe sa e lumtur jam me çdo gjë që realizova.

- Mendoni se fakti që nuk ishit mësuar me praninë e kamerave dhe ekranit ju penalizoi?

- Në fillim ishte problem, të qenit në qendër të vëmendjes nuk është një gjë e këndshme gjithmonë, sidomos kur të gjithë presin që të gabosh. Më pas kuptova që asgjë s'duhet të më pengonte të shijoja atë që po bëja, ndaj jam sjellë gjithmonë natyrshëm dhe kam menduar se po bëj atë që kam me më shumë pasion!

- Cilin do të veçoje si momnetin më të bukur në MasterChef, po atë që s'do të doje të përsëriteshte më kurrë?

- Momenti me i bukur ne Master Chef pa diskutim ishte fitorja si kapitene skuadre në episodin ku zhvilluam garën në Dardhë të Korçës. Ishte për mua një eksperiencë shume e bukur, kam shijuar çdo gjë duke u nisur nga vendi dhe padyshim grupi: Yllka, Emre, Rudgert dhe Bleri.

Nuk do të doja të përsëritej *Pressure Test*, pasi është momenti kur gatuhet nën presion dhe unë nëse gatuaj nën presion nuk ndjej së bëj më të mirën time.

- Si është tani jeta juaj? Duhet ta pranojmë që jeni bërë e famshme...

- Jeta ime s'ka ndryshuar shumë! Unë sërish bëj drekën në shtëpi, gatuaj në festa familjare dhe kërkoj çdo dite receta që më pëlqejnë. Lexoj më shumë dhe përpiqem të informohem me çdo të re në fushën e kuzhinës. Ndryshimi është se në rrugë ka zonja që më buzëqeshin, dhe disa të tjera që më përgëzojnë.

- Si një dibrane e vërtetë, që nuk nguruat ta përsërisni disa herë në spektakël, cili është ushqimi tradicional që gatuan më mirë?

- Jam shumë krenare për Peshkopinë time, dhe të gjitha kujtimet më të bukura me gatimin lidhen me fëmijërinë time.

Të gatuarit e pjatave tradicionale dibrane është një edukatë e veçantë që mami ka insistuar të ma japë, dhe prej saj kam mësuar të bëj shumë mirë sheqerparen. Por si ajo s'e bëj dot, duhet ta pranoj, më duhen disa vite praktike...

- Nëse Rruga e Arbërit do të ishte ushqim, çfarë do të ishte?

- Ah! Për mua Rruga e Arbërit do ishte një sofër, nga ato të bukurat të mbushura me aromat e gatimeve të amvisave ku bashkohet një familje e madhe dibrane...

- Nga buja në mediat sociale dhe intervistat e njëpasnjëshme kemi mësuar dhe ju keni disa profesione njëherësh. Cilit do të veçonit dhe konsideronit më të dashurin?

- Pa dyshim mësimdhënia! Jam e privilegjuar që kam dhënë mësim për 6 vjet, dhe kam mësuar dhe unë vetë se çfarë përgjegjësie është të edukosh dhe të jesh shembull për të tjerët!

- Cilat janë planet tuaja më të afërta?

- Plane kam shumë, por ndryshe nga ç'është thënë, nuk kam ndërmend të lë profesionin si juriste, por as pasionin për gatimin. Ndaj tani gatimin e shoh me një sy tjetër.

Sigurisht, do t'i përkushtohem më shumë... Mbase mund të provoni gatimet e mia në ndonjë restorant!

Rruga e Arbërit nr. 106

sociale

Historia e Ambra Medës, dibranes që përballoi me shumë dinjitet një nga sëmundjet më të vështira në botë. Një histori njerëzore për tu marrë shembull: për kurajon, dinjitetin, humorin dhe guximin për t'ia dalë mbanë! Si një histori përralle në realitetin e ashpër shqiptar

Ambra, vajza që mundi sëmundjen me dashuri

Nga **BUJAR KAROSHI**



NË RINAS ME DY FLAMUJ

"Faleminderit të gjithëve për komentet dhe mesazhet e përzemërta gjatë gjithë kësaj periudhe. Me besoni, i kam lexuar të gjitha dhe jam përlotur. Duke ju falënderuar publikisht të gjithëve, ju njoftoj se më 9 shkurt do të zbres në aeroportin "Nënë Tereza". Do të vij në atdheun tim që më ka munguar aq shumë! Falënderoj Zotin, mjekësinë gjermane, dajat e mi Keta, njerëzit e gjakut, mediat shqiptare dhe gjermane si dhe te gjithë ata që kanë zgjatur dorën për të më ndihmuar, qoftë me një lutje shpirtërore apo fjalë zemre. Falë jush ia dola!" - shkruante Ambra Meda në profilin e saj në FB në fillim të shkurtit.

Dhe më 9 shkurt 2015, në mëngjes salla e pritjes së aeroportit të Rinasit ishte kthyer në një mjedis feste: njerëz të qeshur, lule, tullumbace festive... Dhe ajo shfaqet e gëzuar duke tundur dy flamuj: Shqipërisë dhe Gjermanisë. Të parët e ndihmuan me lutje, të dytën përdorën shkencën për ta kuruar... "Gjermaninë në mendje, Shqipërinë në zemër", - është shprehja e saj e preferuar.

Gëzimi, shoqëruar edhe me lot, ndjehej tek çdo njeri që priste Ambrën në Rinas, të ardhur nga të gjithë trojet shqiptare: Nga Kosova në Berat, nga Saranda në Shkodër, nga Durrësi në Pukë, nga Dibra e Tirana, nga gjithë Shqipëria. Të gjithë ata që për 18 muaj me radhë jetuan me sëmundjen e saj, me dhimbjen e saj, por edhe me guximin dhe kurajën e saj për të jetuar!

NGE FESTA NË SPITAL:
NJË ËNDËRR E KEQE

Historia e Ambrës filloi një ditë të nxehtë gushti në vitin 2013, kur pas një feste familjare, ndjeu disa shqetësime shëndetësore. Familjarët u drejtuan drejt QSUT-së, dhe pas analizave të para, mjeku Mustafa Xhani zgjodhi të bisedonte me dajën e Ambrës, gazetarin Defrim Methasani.

"Vajza juaj ka një sëmundje të vështirë, - tha Xhani. - Ne nuk kemi teknologjinë e nevojshme për ta shpëtuar. Ajo ka nevojë për ndërhyrje kirurgjikale, por kjo do ta vështirësonte shumë gjendjen e saj këtu".

"Bota më erdhi rrotull, - tregon Defrimi. - Ambra nuk dinte gjë dhe ne e kishim vështirë të gjenim një fjalë të mirë për t'i dhënë shpresë. I vetmi që m'u kujtua ishte Ismaili, kampioni i botës në Kik&Tai Boks, i cili, gjatë bisedave të zakonshme me të, më kishte thënë: "Nëse një ditë do të kesh hall, më thuaj". Pas telefonatës me të, pasi i shpjeguam situatën, ai nuk tha asnjë fjalë, dhe pas një heshtje të shkurtër tha: "Defrim, nga dita e sotme, Ambra do të jetë mbesa ime. A e sjell dot në Gjermani"?

Nga spitali drejt e në një agjenci udhëtimi. Biletat për Mynih kushtonin mbi 400 euro, por, thotë Defrimi, "Kush ka miq, botën ka", dhe shpjegon se grupi i tij i miqve në Prishtinë, Milaim Krasniqi dhe Sabush Osmani, i prenë biletat nga Prishtina për Mynih për pesë veta: Ambrën, babanin dhe nënën e saj, motrën dhe për mua", më çmim shumë më të lirë. Ne nuk paguam.

Pas vizitave të para në spitalin Klinikum Schaëbing, o konstatua se sëmundja e Ambrës ishte e rrallë. Ajo ishte rasti i 131 në botë. Pas konsultave të para, mjekët dhanë shpresë, por shpjeguan se ky proces do të jetë i gjatë dhe i kushtueshëm. shërimi i saj do të kushtonte nga 180 deri në 250 mijë euro, dhe kjo gjithmonë ishte një shifër e përafërt, pasi realizimi me sukses i kurimit do të ishte i gjatë dhe i paparashikueshëm.

"Fjalët nuk dilnin, - tregon Dëfrimi për atë situatë. Ai që u dha rrugë punëve ishte Ismaili. "Ambra do të qëndrojë në shtëpinë time. Unë do të gjej 50 mijë euro, ndërsa ju kthehuni në Shqipëri dhe kërkoni para borxh". Së paku, tani duheshin edhe 130 mijë të tjera që të kishte shpresë.

"Gjëja e parë që më shkoi në mend ishte të shisja shtëpinë", - tregon i ati, Skënderi, një vilë të bukur pranë rrugës "5 Maji". Ai u kthye me këtë mendim, por në agjencinë e parë që trokiti e pa se kjo do të ishte një proces i vështirë. Tregu i banesave prej kohësh kishte hyrë në krizë. "Vetëm dua ta shes, sado të kushtojë", - u thotë Skënderi punonjëses së një agjencie në Tiranë.

"Për herë të parë mendova se Facebooku mund të më ndihmonte", - tregon sot Defrimi, i cili tani e ka harruar pak vuajtjet e atyre ditëve. "Më shkonin e vinin emra miqsh e shokësh, që mendoja se mund të gjeja mbështetje. Por ishin shumë dhe nuk kishte kohë për t'i takuar të gjithë me radhë. Kështu që bëra një postim në FB.

"Shumë njerëz m'u gjendën pranë menjëherë, - thotë ai. - Mbështetja ishte aq e madhe, megjithëse shuma e parave që duhej ishte shumë e madhe, mbështetja e njerëzve që kontribuonin sadopak, më jepte besim se gjërat do të shkonin mbarë.

"Lotët e burrit" është një përshkrim i këtij momenti, të cilin ai e hodhi në profilin e tij në FB më 23 shtator 2013, ku tregonte se si njerëzit nga e gjithë Shqipëria jepnin mbështetje për mbesën e tij, pavarësisht problemeve të tyre në jetën e përditshme.

Pas këtij suksesi të parë, motra e Ambrës, Nerilda krijoi një faqe në FB "Kontribut per Ambra Meden", dhe i ftonte njerëzit të jepnin ndihma monetare në disa llogari bankare, në Tiranë dhe Mynih. Shumë shpejt faqja arriti mbi 37 mijë ndjekës, ndërsa faqja personale e Ambrës filloi të rritej dhe ajo sot numëron rreth 1800 miq. Gjithë mesazheve dhe komenteve në rrjetet sociale i përgjigjej Nerilda, motra e madhe e Ambrës. Fushatë për mbledhje fondesh filluan edhe nxënësit e shkollave të Tiranës, duke nisur nga gjimnazi "Sami Frashëri", ku Ambra duhej të vazhdonte vitin e dytë, e deri në shkolla të ndryshme të vendit, në Shkodër, Librazhd, Gramsh, Peshkopi, etj.

Shumë media qendrore në Tiranë i kushtuan vëmendje rastit të Ambrës dhe me shumë dashamirësi treguan gjithë ndikimin e tyre për mbledhjen e fondeve. Ndër të parët që dhanë një pagë nga rroga e tyre e parë ishte edhe ministri Erion Veliaj, deputeti Koço Kokëdhima, zv. ministrja Nora Malaj, etj. Ndërsa në Dibër të Madhe, nën organizimin e Valon Markes, Evzi Kaja dhe Bajram Kllobcishtes, me mbështetjen e kryetarit të Komunës, Rruzhdi Lata u organizua një koncert bamirësie.

Por fushata për mbledhjen e fondeve nuk pushoi kurrë, deri në ditën që zyra e Emigracionit në Mynih mori përsipër shpenzimet e operacioneve dhe kimios.

VËLLEZËRIT KETA & MIQTË E NJOHUR DHE TË PANJOHUR

"E para telefonatë e imja ka qenë një me doktor në një klinikë universitare në Mynih, i cili në atë kohë ndodhej në Angli. Ai i telefonoi klinikës ku vizituam Ambrën dhe menjëherë u hapën dyert e spitalit dhe u kujdesën maksimalisht për të, pa bërë asnjë pagesë paraprake", - tregon Ismail Keta për ato ditë të para të vështira.

"Ne nuk paguam në fillim, siç ndodhte normalisht. Mjekët na vizituan në mënyrë urgjente dhe u kujdesën maksimalisht për Ambrën. Pas analizave të para, krejtësisht dëshpëruese, mjekët na rekomanduan një grua, këtu në Mynih, e cila drejtonte një shoqatë për ndihmën që u jepej të sëmurëve të këtij lloji".

"Në vendosëm që të kërkonim fonde këtu në Gjermani, me mënyrën që dihen tashmë. Gjetani vendosi të bëjë një ndeshje për mbledhjen e fondeve dhe po ashtu edhe unë".

Në korrik 2014 Gjetan Keta u ndesh për titullin Kampion Bote në Mynih, ndërsa në tetor Gjetani e mbrojti titullin në një ndeshje fantastike në Bulqizë.

"Ajo që ndodhi më pas nuk ka shpjegim", - thotë Ismaili. Dyert u hapën njëra pas tjetrës, dhe këtë e bëri vetëm Zoti. Televizioni lokal këtu në Mynih bëri një reportazh dhe çështja e Ambrës u fut në çdo familje gjermane. Shumë shqiptarë ndihmuan, por Ambra u kthye në një personazh në çdo shtëpi të Mynihut. Pati një angazhim të madh qytetar, kështu që as erdhi më pas edhe Zyrën e Emigracionit, e cila mori përsipër shpenzimet e kurimit.

Gjithçka ndodhte në ditët e para, ishte jashtë syrit të Ambrës, e cila e ndjente se shërimi i saj nuk ishte i thjeshtë. Njerëz të sensibilizuar nga rrjetet sociale shkuan ta vizitonin në spital: ndër të parat ishin dy gratë e mrekullueshme, Lume Ismaili dhe Lume Osmani, që pothuajse e kanë vizituar vazhdimisht Ambrën në spital. Po ashtu edhe vëllezërit Rustemi nga Kërçova,familja Çipuri

cyan magenta yelloë black

jetë



Ambra Meda në spitalet e Mynihut ishte e rrethuar nga dashuria jo vetëm e njerëzve të saj apo kampionëve të botës Keta, por edhe nga gjithë trojet shqiptare, duke na përcjellë mesazhin: Të mbështesim njëri-tjetrin, të duam njëri-tjetrin. Sepse të gjithë vështirësitë munden vetëm me dashuri...

nga Peshkopia, Valon Marke nga Dibra e Madhe dhe shumë e shumë të tjerë...

Kur çështja e Ambrës u fut në shtëpitë e banorëve të Mynihut, vizitorë të saj ishin të shumtë: nga shumë kombësi dhe gjuhë, mes të cilave spikat princesha e Mynihut, Hermine Zu Salm-Salm. Ajo e vizitoi disa herë në spital dhe kurajo e Ambrës për të mundur sëmundjen u bë shembull për të gjithë.

"Në fillim nuk kuptoja asgjë, - tregon Ambra tani, në shtëpinë e saj, e rrethuar nga dashuria e familjarëve, sidomos motrës së vogël, Elit. Në konsultat e mjekëve, që shpesh flisnin anglisht, arrita të kuptoja që bëhej fjalë për një sëmundje të vështirë. Dy fjalët e para gjermanisht që mësova ishin "gjilpërë" dhe "dhimbje", por i dhashë kurajë vetes që do të luftoja për të jetuar".

Vajza nga Dibra iu nënshtrua një kurimi të vështirë të Klinikum Schaëbing në Mynih. Ajo përballoi 4 operacione të vështira dhe 14 seanca kimio. Përpara secilës ajo buzëqeshte dhe shprehte optimizmin në rrjetet sociale, e shoqëruar nga e ëma, Liljana, dajallarët Keta, Ismailin, Gjetanin dhe Feritin dhe shumë e shumë të tjerë.

Në 18 muajt e qëndrimit në spital, ajo i bëri të gjitha përpjekjet për të jetuar e gëzuar: vuri paruke dhe u gëzohej flokëve, këndonte, fotografohej, jepte mesazhe optimizmi, bisedonte dhe qeshte me pacientët e tjerë të klinikës, me mjekë e infermierë, sa të gjithë e donin.

"Njëherë pashë në korridor të spitalit një infermiere që e doja shumë. "Pse nuk vjen të mi bësh t'i gjilpërat, - i thashë. Ajo qeshi dhe m'u përgjigj: - Për të ardhur te ti është radhë e madhe".

Ambra iu nënshtrua operacionit më të vështirë më 26 maj 2014 dhe katër ditë para këtij operacioni, ajo gjeti guximin që në një video treminutëshe t'i prektë të gjithë ndjekësit e saj në rrjetet sociale. Video e saj përcillte mesazhe që sot na bën të ulim kokën poshtë dhe të mendojmë se sa të varfër jemi ndonjëherë. Sa zemërngushtë tregohemi dhe se, megjithëse rreth nesh ka plot gjëra të bukura për të prekur e shijuar, ne shohim larg me ligësi e smirë.

Ajo video e Ambra Medës tregon se, sado të pasur a të varfër të jemi, sado me pushtet të jesh apo sado të vuash në kërkim të punës e mbijetesës, brenda vetes duhet të gjesh energjinë e mirë dhe dashurinë për jetën.

Ambra tregon se sa zemër të madhe ka. Sa e përkushtuar është për ta luftuar sëmundjen dhe se asgjë nuk vlen para jetës. Në atë video ajo tregohet guximtare, realiste, ëndërrimtare, njerëzore. Me zërin dhe veprimet e saj na tregon se nuk kemi asgjë për të humbur, veçse të luftojmë për jetën dhe dashurinë! Me atë video Ambra na ndihmon të zbulojmë dashurinë brenda vetes, për tu bërë më të mirë e më të dashur jo vetëm në familje, por edhe në shoqëri.

PËRKRAHJA E ARTISTËVE

"Ka qenë një fat për ne, pasi që në fillimet kërkimit për ndihmë, përveç mediave, të kishim edhe mbështetjen e artistëve shqiptarë: këngëtares Aurela Gaçe, prezantueses Alketa Veisiu, prezantueses së Fiks Fare, Fiori Dardhës, Turian Hyskës, e shumë e shumë të tjerëve.

"Me rastin e Ambrës u njoha nëpërmjet rrjeteve sociale, - tregon Aurela Gaçe".

Ajo shfrytëzoi skenën e Crazy Calvin, një klub me muzikë live në Rrugën e Elbasanit, për t'u bërë thirrje ndjekësve të saj për të kontribuar që në fillim për Ambra Medën.

"U angazhuam si staf të ndihmonim sa mundeshim. Një natë i kërkuam edhe ndihmën e publikut në sallë. Sigurisht që ne nuk arritëm të siguronim mjaftueshëm të ardhura që do të shërbenin për kurimin e saj, por mbështetja e të gjithëve, edhe me lutje, ishte mirë për gjendjen e saj shpirtërore".

"Jo vetëm rasti i Ambrës, por shumë njerëz që preken nga sëmundjet, duan vërtetë shumë të ardhura. Për të ardhur keq në fakt, sepse shumë prej tyre nuk i kanë mundësitë. Përpara jetës, asgjë nuk ka vlerë. Kështu që edhe ata që mundën të ndihmonin Ambrën me të ardhurat e duhura, besoj ndihen shumë mirë, kur dinë që një jetë u shpëtua".

"Faleminderit Zot që sjell mes nesh edhe njerëz që kanë shpirt të madh. Kurajoja e Ambrës ishte e pashoqe. Sa herë e shihja në statuset e saj, më rrënqethej trupi. Pozitive edhe kur futej në operacion. Sytë e saj flisnin. Dashuria që dha e mori, ndoshta e bënë të ndihej se duhet të luftonte. Ambra e gëzoftë çdo sekondë të jetës së saj të re", - thotë këngëtarja e njohur Aurela Gaçe.

Pas kthimit të Ambrës në Shqipëri, ajo dhe Crazy Calvin organizuan edhe një mbrëmje të veçantë dedikuar Ambrës.

Një mbrëmje dedikuar asaj ishte edhe me 14 shkurt, ku pedagogia Xhoi Jakaj dhe nxënësit e Liceut Artistik organizuan një koncert me rastin e ditës së Shën Valentinit.

* * *

Pas kthimit nga Gjermania, duket se media është shumë e interesuar për historinë e saj. Dhe më shumë se sa historia e një vajze, duket se publikut i intereson se si ajo shihte dritë në një tunel errësire.

Në Top Channel, te Vizion Plus, A1 Report, në TVSH etj., Ambra tregoi thjesht historinë e saj, dëshirën për të jetuar dhe këmbënguljen për t'ia dalë mbanë, pavarësisht vështirësive. Dhe, siç tregon ajo, në këtë betejë nuk ka qenë vetëm, por me mijëra shqiptarë anembanë botës, që i kanë dhënë kurajë, besim dhe shpresë.

Në shtëpinë e Medëve, që "shpëtoi nga shitja" vijnë vazhdimisht njerëz. Kryesisht të afërm.

"Shumë njerëz kërkojnë ta takojnë, - thotë Defrimi. - Në Shkodër, gjatë vizitës në javën e fundit të shkurtit, ku Ambra takoi disa nga mbështetësit e saj të parë, ajo u lodh shumë. Edhe në restorant, gjatë drekës, vinin njerëz dhe kërkonin vetëm të përqafonin. Pa fjalë, pa kortezi të e zakonshme. Një përqafim dhe dukej sikur zemrat shkriheshin së bashku".

"Kjo përvojë pas operacionit është shumë emocionuese, - tregon Ambra. Në fillim, pas operacioneve dhe kiomiove të para, nuk mbaj mend asgjë çfarë ka ndodhur. Dalëngadalë filloja të kuptoja, të dëgjoja, të shikoja dhe gjithmonë më është mbushur zemra plot me dashuri".

"Dhe shpeshherë, kur vuaja, kur kisha dhimbje, nuk mendoja për vete, por për familjarët e mi që përpiqeshin aq shumë. Për nënën time, e cila nuk m'u nda asnjë ditë nga spitali".

"Sa shumë je lodhur këto kohë e njëherë nuk the "u lodha"! Sa shumë je mërzitur e njëherë nuk the "u mërzita". Sa shumë ke dashur të qash e në fytyrën time ke buzëqeshur! Unë jam vajza jote dhe, kur të shikoj të mërzitur më këputet shpirti, imagjino çfarë ke përjetuar ti o mbretëreshë e triumfit", teksa më shihje duke vuajtur. Ti ke qeshur përmes lotëve e më ke thënë: "Ne do ia dalim!". Ajo ç'ka unë jam sot është meritë e kësaj gruaje të palodhur! Më fal, o nënë për rrudhat që të kam shkaktuar këto kohë. Kur të shikoj, kuptoj sa ke vuajtur ti nga brenda", - shkruante Ambra për nënën e saj Lilianën, të cilën, kur e pyet për ato që ka hequr, të kthen vetëm një përgjigje: buzëqeshjen...

Ambra tani po shijon diellin e Tiranës: herë pas here ndonjë kafe me shoqet, shëtitje nga liqeni artificial, pret dhe përcjell njerëzit që e vizitojnë në shtëpi. Është e frymëzuar nga ajo që po përjeton tani dhe më shumë se kurrë ka dëshirë ta shkruajë historinë e saj në një libër. Po ashtu, dëshiron që sa më shpejt të jetë e mundur të krijojë edhe një shoqatë në ndihmë të fëmijëve që vuajnë nga sëmundjet e vështira: t'i ndihmojë ata t'i përballojnë dhimbjet dhe t'u tregojë rrugën e shërimit, që kalon nga shpresa, besimi dhe dashuria.

Ambra Meda në spitalet e Mynihut ishte e rrethuar nga dashuria jo vetëm e njerëzve të saj apo kampionëve të botës Keta, por edhe nga gjithë trojet shqiptare, duke na përcjellë mesazhin: Të mbështesim njëri-tjetrin, të duam njëri-tjetrin. Sepse të gjithë vështirësitë munden vetëm me dashuri...




Rruga e Arbërit nr. 106

"Zëri i malit të Shënmërisë",
një rrëfim mahnitës i poetit dhe shkrimtarit të 25 librave

recensë

Kodi mistik i komunikimit në romanin e Naim Berishës

Nga **HALIL RAMA**



Në romanin e ri të Naim Berishës, "Zëri i malit të Shënmërisë", gjejmë kodin e komunikimit mistik me një mal të pazakontë e të perëndishëm. Me një gjuhë të pasur letrare e mjete shprehëse domethënëse, Naimi sjell për lexuesin mitin dhe kultin e malit të shenjtë të vendlindjes së tij. Është padyshim ky një sukses i veçantë i këtij autori, i cili në hapësirën e letërsisë shqipe, si poet, romancier, tregimtar, fabulist, hajkist, përkthyes dhe, njëherësh, kantautor, hyn tashmë me më shumë se 25 libra artistikë. Librat e tij, si në poezi dhe në prozë janë përshëndetur, mirëpritur dhe analizuar, jo vetëm nga kritika, por edhe nga shkrimtarë të shquar, të vjetër e të rinj të vendit tonë, përmes shkrimeve të posaçme në organe letrare, recensave, parathënieve, diskutimeve letrare, etj, si profesorët: Bedri Dedja, akademik, Odhise Grillo, Dritëro Agolli, Teodor Laço dhe shumë të tjerë.

"Zëri i malit të Shënmërise" trajton një temë të veçantë, atë të mitit dhe kultit të malit, madje, e një mali të shenjtë, i cili mban emrin e Shën Marisë, nënës së Krishtit, teme e cila ndërthuret bukur artistikisht me dashurinë pothuaj përgjëruese të heroit lirik të veprës, djaloshit kureshtar Shemshedin Kulla për malin e tij të zemrës, hero, i cili gdhendet si me daltë nga autori që në moshë të vogël fëminore e deri mësues, poet dhe kryetar i bashkisë së qytetit të tij, Arabashkë. Paralel me dashurinë për malin në fjalë rritet dhe forcohet dhe dashuria e djaloshit fshatar për vajzën e bukur vetullkurorë nga qyteti i Arabashkës, të cilën e njohu rastësisht, teksa bënin plazh, në një ditë të bukur vere bri lumit të fshatit të tij, Xhelaxhoshit, Alma Perhati.

Me joshjen dashurore, rrëfimi romanesk i Naim Berishës tek "Zëri i malit të Shënmërisë" është një subjekt që zbulon gradualisht thellësitë shpirtërore dhe psikologjike, burimin e vërtetë të erosit.

Më pas mësohet se Shemshedini ka braktisur jetën e mërzitshme të emigracionit dhe është kthyer përfundimisht në vendin e tij, aty ku është lindur, rritur dhe formuar, në vendin e të parëve të vet, aty ku gjen kënaqësinë e vërtetë të shpirtit të tij, një dukuri kjo disi e veçantë, që shfaqet si një shenjë qiellore, gjurmët atmosferë ndryshuese të së cilës, mbeten të pashlyeshme në kujtesën e lexuesit.

Linja e dashurisë së Shemshedinit dhe Almës, në gjithë rëndomësinë e jetës, duket disi e pazakontë. Ajo dëshmohet, më së shumti, si një idil lumturues e herë - herë si një dhuratë, që Zoti ua bën njerëzve të përkushtuar ndaj Tij. Dashuria e dy të rinjve për njëri - tjetrin shpërfaqet me një mjeshtëri të admirueshme në gjithë faqet e romanit, sa të detyron ta lexosh atë me një frymë. Ajo përshkruhet me një bukuri, gati mahnitese, me një gjuhë të pasur, stil të rrjedhshëm dhe konçiz si dhe me një sqimë stilistikore që të mban pezull gjithë kohës së leximit.

Dashuria shihet dhe trajtohet si një fryt i pastër i shpirtit të dy protagonisteve, Shemshedinit dhe Almës, apo dhe i tërheqjes trupore. Por më shumë se kaq, ajo është një gjendje gati e jashtëzakonshme, jo dhe aq e vetëdijshme dhe kënaqësidhënëse sesa një shfryrje psikologjike-shpirtërore, një kundërveprim, si me thënë ndaj trysnive të jetës së tmerrshme të kurbetit apo dhe atyre shoqërore në vendlindje, një qetësim i nevojshëm, i lirshëm dhe komfort pas një traume të gjatë.

Rrëfim befasues që të prek në shpirt,
të ngjall ndjenja dhe mendime të thella

Sapo e lexon këtë roman, i katërti në radhë i këtij shkrimtari, ti e kupton se ky libër në mos sot, në një të ardhme jo të largët, do të bëhet klasik. Çdo vit, në këta njëzet vitet e fundit ky autor u ka dhënë lexuesve të vet nga një libër artistik që të kënaq dhe, jo rrallë, të befason, të prek në shpirt, të ngjall ndjenja dhe mendime të thella.

Dhe kjo nuk ndodh vetëm me romanet e tij: "Vetevrasja e shpirtit", "Bjeshkët e dashurisë", "Gurkështjella", "Zëri i malit të Shënmërisë", por edhe me librat e shumtë me poezi, me fabula, tregime, hajke, e tjerë.

E lexoja këtë roman dhe vetvetishëm më ndërmendësohej Gabriel Garcia Marquez me realizmin e tij magjik. Por "Zëri i Shënmërisë" është një zë origjinal yni, që del nga palca e trollit të pamposhtur dibran, një zë i dimensioneve universale, i cili është, njëherësh, sa ushqim shpirtëror aq dhe art sublim.

Shemshedini, (nënkuptim i autorit) heroi i veprës, është, si me thënë, një shestim i një shtegtari ...! "Zog i qiellit", ka një libër me poezi, prej vitesh, Naim Berisha, përngjasimi i shkrimtarit me heroin e veprës së vet, duket si një formë e çuditshme e përjetësisë së mësuesit poet dhe artist.

Miti dhe kulti i malit të pazakontë e të perëndishëm

Dashuria dhe lidhja e përzemërt dhe e pazgjidhshme me malin e tij të perëndishëm, me të cilin ka gjetur kodin e komunikimit mistik, të fshehtë e misterioz qysh në fëmininë e tij, dëshmon ringritjen e tij mbi harrimin që, shpesh dhe rendomthi, mbulon gjithçka. Për të mos dalë prej orbitës së jetës a historisë, Shemshedini s'i ndahet malit, ngjitjes të herëpashershme të tij. Atë e shohim të lozë, të qeshë, të kuvendojë, të qaj halle e derte me të, si me vetveten, si me Zotin, rob i të cilit ai ndihet.

Vuajtjet e nënë Arjanës nën trysninë e egër të të shoqit, babait të Shemshedinit, sëmundja e gjatë dhe e mërzitshme e saj, konflikti me babanë për shkak të rrahjes së saj prej tij pa asnjë arsye, po, thjesht, për shkak të alkolit a drogës që mund të merrte, konfrontimi fizik me të, gjuha e egër që përdoret, ikja, më në fund, e babait nga shtëpia dhe degdisja e tij me një vejushe të përdalë të qytetit diku larg, e prek thellë në shpirt adoleshentin Shemshedin Kulla.

Lidhja dashurore me Almën e rizgjon atë, hap një dritare të re në botën e tij. Një dritë e rrezëllitëse përtërin shpejt shpirtin e djaloshit. Mirëpo nuk shkon gjatë dhe nënë Ariana ndërron jetë. Ligështimi i tij qe i papërshkrueshëm. Lidhjet e tij me malin e zemrës intensifikohen më shumë. Si të mos mjaftonte kjo e keqja shkon me tej. Fisi i Almes bie në gjak. Sadiu dhe Alma, dy prindërit e Almes insistojnë të marrin me vete, në Francë, jo vetëm Almen, por edhe Shemshedinin, ne se ky dëshironte, me qëllim që t'i shpëtonin gjakmarrjes. Shemshedini nuk pranon. Ai arsyeton se Alma nuk duhej të ikë me prindërit jashtë, pasi, tashmë, ajo është nusja e ligjshme e tij dhe gjaksi nuk kish punë me të. Përfundimisht, Shemshedini s'e miraton largimin e saj, pavarësisht se sugjerimi i fshehtë i Malit të Shënmerise ishte i kundërt, pra që ta ndiqte të fejuarën, të ikte përkohësisht bashkë më të. Ndërkaq, Alma ishte shtatzënë me Shemshedinin. Atë e tmerroi më keq ikja e Almës. Në Lion të Francës Alma pas disa peripecive, kualifikohet, dhe me pas lind djalë, Dinin e vogël. Shemshedini entuziazmohet nga lindja e trashëgimtarit, por prapë nuk ka fuqi ta lërë atdheun. Prindërit e Almes, ish-komunistë, nuk e kishin fort për zemër dhëndrin demokrat, por edhe pse nuk ia thonin hapur këtë Almës, gjithsesi, tendenca e tyre ish e dukshme.

Ndërkohë, Shemshedini përparon aq shumë sa dhe vetë atij nuk i besohet. Ai behet kryetar i bashkisë së qytetit të tij të dashur. Të gjithë qytetarët e tij e donin pa masë. Ai mendonte për Arabashkën më shumë se për veten. Brenda një kohe të shkurtër ai bëri ndryshime të mëdha. Veç të tjerash, asfaloi gjithë rrugët që përshkonin malin e Shënmërisë, hapi dhe udhë të reja, ngriti dhe dy pika te bukura turistike në Rrafshe te malit të Shënmërisë. Më tej veprimi vazhdon rrjedhshëm dhe besueshëm. Kushëriri i Almes, pra, ish-dorësi, që kishte vrarë, vritet. Gjaku mirret. Kjo e bën të lirë, në të vërtetë, Almen te kthehet ne atdhe. Për më tej, në mort të kushëririt në Shqipëri vijnë vetëm Sadiu me Emën. Mosardhja e Almes dhe e djalit, Shemshedinin e preku thellë ne zemër. Ai i pret prindërit e saj në zyrën e kryetarit të bashkisë, i shëtit me makinën e tij në pikat e reja turistike të malit të Shënmërisë, si dhe i çon në shtëpinë e tij të re tejet komode, të cilën ia kish dhënë shteti për ta paguar pak nga pak. Më pas veprimi zhvillohet vrullshëm. Vjen pajtimi me babanë përmes shokut të tij të ngushtë Kadriut. Por as kjo e papritur gazmore nuk e zbuti depresionin e Shemshedinit. Një ditë ai sëmuret rëndë në vendin e punës.

Romani përmbyllet me ardhjen, çuditërisht, të papritur të Almes dhe Dinit të ri nga Franca në Shqipëri. Pritet nga të gjithë, por jo nga Shemshedini. Ai ndodhej i shtrirë, ende, në gjendje kome, i porsadale nga salla e reanimacionit.

Shemshedini është një mësues i zoti dhe, njëherësh, një poet në zë. Në realitetin ekzistencial ai shfaqet herë si mbitokësor e herë si kozmik, gjithë i veshur me një imagjinatë dhe mendësi mistifikuese. Kësisoj ai duket sikur merret vesh me Zotat e qiellit, përmes malit të shenjtë të Shënmërisë, me lumin që rrjedh në këmbë të këtij mali të perëndishëm si dhe me jashtëtokësorë. Kudo që haset në faqet e romanit, fjalët dhe veprimet e tij të përtërijnë ndjenjat dhe, njëherazi, të dritësojnë mendimet.

Mali i Shënmërisë është vetvetishëm një mal i sublimuar. Ndërsa vetë Shemshedini e mbisublimon atë duke krijuar, ndërkaq, mitin dhe kultin e një mali të pazakontë e të perëndishëm.

Duke komunikuar me këtë soj mali, ai, në të njëjtën kohë, komunikon me Zotin.

Përderisa ai nuk iu përgjigj një sugjerimi të malit më shumë se mik e vëlla, atij të Shënmërisë, të malit Zot, Shemshedini, dikur ose, më saktë, më në fund, u ndie i keqndëshkuar, madje, pothuajse, për vdekje. Unë mendoj se në këtë kontekst nënkuptohet dhe një farë uni narcizik, qe e kanë poetët, si një dëshmi, ndoshta, psikologjike e një farë epërsie e veprimit njerëzor dhe sidomos e shkrimtarëve.

Me një gjuhë të pasur letrare e mjete shprehëse domethënëse, Naimi sjell për lexuesin mitin dhe kultin e malit të shenjtë të vendlindjes së tij.
"Zëri i malit të Shënmërise" trajton një temë të veçantë, atë të mitit dhe kultit të malit, madje, e një mali të shenjtë, i cili mban emrin e Shën Marisë, nënës së Krishtit,

NAIM BERISHA
Zëri i Shënmërisë
Botimet M&B
ISBN: 978-9928-172-37-2
Nr. faqeve: 168
Çmimi: 500 lekë

Ftesë për sponsorizim


Studiuesi Xhezair Abazi po përgatit një monografi antologjike për Haki Stërmillin! Ftohen biznesmenë dhe qytetarë atdhetarë që ta mbështesin botimin e kësaj monografie me rastin e 120-vjetorit të lindjes.


Për më shumë informacion kontaktoni autorin ose mund të na shkruani në adresën e emailit të gazetës!

Faleminderit!

botime

Ahmet Zogu në dy botime





NGA NJË LIBËR ME KURIOZITETE TE NJË VËSHTRIM HISTORIK: AHMET ZOGU JOSHËS I BLENDI FEVZIUT DHE MBRETI I SHIQPTARËVE I KRISTO FRASHËRIT

Nga FAIK XHANI

Në tetor të vitit 2014, në Tiranë doli nga botimi libri i autorit Blendi Fevziu "Ahmet Zogu. Presidenti që u bë mbret". Libri ka 274 faqe me një Prolog në fillim, një Epilog, 17 nëntituj dhe një album të pasur fotografik. Pritshmëria e tij ka qenë e madhe. Promovimi shumë madhështor. Jehona tepër e madhe. Si duket, me qenëse Blendi është gazetari që ka punuar në një nga mediet më të fuqishme audovizive siç është Televizioni Klan ka pasur mundësinë e reklamimit më të fuqishëm dhe shumë prej politikanëve, qeveritarëve dhe parlamentarëve u ka hapur dyert e atij televizioni. Me këtë rast ata kanë dashur, t'i kthejnë nderin. Shumë prej tyre, mandej edhe kryeministra, kanë marrë pjesë në promovimin e librave të këtij autori.

Bëhet mirë që merret pjesë dhe vlerësohet libri, por nuk është aspak serioze që për t'i dhënë më shumë meritë se sa ka në fakt një autor, si Blendi Fevziu me botimet e tij dhe veçanërisht me këtë botim, ku shkulet Tirana për të marrë pjesë dhe kryesisht: politikanë, qeveritarë e parlamentarë.

Blenti Fevziu është gazetar me emër, por kurrë një botues i asaj lartësie që reklamohet, kryesisht nga besnikët e tij, parlamentarë, politikanë e qeveritarë që dashje pa dashje ushtrojnë një presion dhe shantazh ndaj lexuesit, si e si që librat e këtij autori të shiten.

Librat e tij, me përjashtim intervistave, janë një përmbledhje obsionesh nga autorë të ndryshëm, që shpesh duken si arna në kostumin e ri, apo shartesa mbi nënshartesën bazë ku autori Blendi Fevziun mbetet mikës (i përzier).

Është për të ardhur shumë keq që një nga botimet më prestigjoz dhe me vlera shkencore për Ahmet Zogun, i prof. Kristo Frashërit "Ahmet Zogu" vështrim historik ", lihet në harresë dhe nuk i bëhet asnjë llojë promovimi. Është e pabesueshme, por fakt që deritani asnjë nga politikanët, shtetarët dhe parlamentarët nuk kanë thënë qoftë edhe një fjalë të vetme për këtë botim e për autorin e saj, kurse për Blendi Fevziun u mblodhën nga të katër anët e lëshuan tollumbacet me shumë ngjyra duke e vlerësuar maksimalisht e më mirë të themi, duke e katapultuar deri në qiell botimin e tij.

Ky libër gjithçka mund të thotë, por nuk thotë atë më kryesoren, që në fund të fundit i duhet më shumë se kurr popullit shqiptar e veçanërisht brezit të ri se si Ahmet Zogu u bë president e mbret dhe sa i përligji këta funksione para popullit dhe vendit, shqiptarve dhe Shqipërisë.

Të ngreshë në qiell një libër ku pjesa e autorit nuk është as sa ¼ e faqeve të tij, që më shumë merret më jetën private të Ahmet Zogut se sa me kushtet historike, kontradiktat zhvillimore, klasat dhe shtresat shoqërore, arritjet dhe dështimet, taktikat dhe strategjitë, realitete dhe ndryshimet, analizat dhe sinoptikat zhvillimore e mesazhore nuk është aspak seroize, mandej do të thosha një fatkeqësi e jona.

Librit "Ahmet Zogu. Presidenti që u bë mbret." më shumë është joshës kuriozitetesh se sa një libër me vlera historike analitiko-mesazhore. Ai është një zhvillim më i plotë dhe detajor i librit "Oxhaku famëmadh Zogu" i autorit Ramiz Lushaj, i shtëpisë botuese "Dardania" botim i vitit 1995 me ndryshime formative dhe dizenjimi.

Ky libër më shumë ngjan me një ese të gjatë që fokusohet në jetën private të Ahmet Zogut, në cilësitë fizike, morale, psikologjiko-shpirtërore të tij se sa një vështrim historik të një presidenti që u bë mbret.

Libri "Ahmet Zogu. Presidenti që u bë mbret" është një sipërmarrje e rëndësishme e autorit Blendi Fevziu në kuadrin e rishikimit të historisë për të ndriçuar e lartësuar figurën e Ahmet Zogut dhe për ta vendosur atë në piedestalin më të lartë të historisë të popullit e kombit tonë.

Realisht, fatkeqësisht, më mirë të themi aksidentalisht autori Blendi Fevziu i jep lexuesit një sërë të dhënash që në vend se ta shtojë simpatinë, admirimin dhe dashurinë për Ahmet Zogun e ulin atë, mandej edhe e zbejnë deri në atë masë: Si një mbret i dështuar, si njeri që ishte vënë në shenjestër të atentateve, si joshës i grave, njeri që deklaronte hapur vrasjen e kundërshtarëve për interesa të tij, si kryeministri, presidenti dhe mbreti që ngriti në system ryshfetin, si njeriun me vesin më të keq të duhanpirjes, problemtaik të Shoqatës Kundër Duhanit etj.

Duke qenë i zbrazët nga vektori historiko-analitik , autori Blendi Fefziu me qëllim të mirë apo aksidentalisht do të thoja, por me vërtetësi jep portretin moral të Ahmet Zogut. "Zogu nuk i besonte askujt, madje as njerëzve të afërt që ishin me të prej vitesh." (f. 134).

Vetë autori, por edhe me përshkrimin e shumë personazheve emblematik të kohës, bashkëpunëtorë, politikanë, parlamentarë, diplomatë, gazetarë, ushtarakë etj. pikturon më së miri portretin fizik dhe moral të Ahmet Zogut, stilin dhe metodën e punës së tij. Në sintezë : Ai nuk thoshte kurrë atë që mendonte…Në karrierën politike ai premtoi dhe i theu premtimet me lehtësinë më të madhe. Në politikën e jashtëme u përpoq të ishte me të gjithë dhe po të gjithëve u theu fjalën…Zogu dinte të gënjente për mrekulli. Ai nuk kënaqej me dredhi dhe me mohime të thjeshta…Parimet morale s'kishin asnjë vlerë për të, madje i përbuzte. (f.129). Stili i komunikimit me vartësit ishte i panjohur për çdo vend të Europës. Tentaiva për të zbuluar se çfarë kishe në kokë ishte një ndërmarrje sfilitëse, si për diplomatët e huaj ashtu edhe për vërtësit…(f.128). Pushteti dhe komandimi qenë lumturia, mjerimi dhe droga e tij e vetme.

Të gjitha këto e të tjera që autori Blendi Fevziu i pasqyron me hollësi e vërtetësi në libër nuk e lartësojnë, përkundrazi e zbejnë, e fajsojnë dhe e minimizojnë figurën dhe rolin e Ahmet Zogut, i cili pavarësisht se arriti majat më të larta të karrierës së tij: ministër i brëndshëm 25 vjeç, kryeminisër 27 vjeç, president 31 vjeç dhe më në fund Mbret nuk arriti të shkëlqejë në fronin e mbretit. Ndonëse ai me shkathtësinë, inteligjencën, taktikat dhe metodat që përdori arriti në majat më të larta ose siç na bënë me dije Prof. Kristo Frashëri vetia për të ngjitur shkallët e hierarkisë nuk është e njëjta me aftësitë për të qeverisur. (Ahmet Zogu. Vështrim Historikf. 169). Nga aftësia e parë, e cila quhet karrierizëm, përfiton individi, nga aftësia e dytë, e cila kur është e mirë, përfiton vendi. Nga ky këndvështrim Ahmet Zogu u takon atyre karrieristëve që ka plot historia, të cilët tregohen të shkathët për të ardhur në pushtet, por dalin të ngathët për ta ruajtur fitoren e arritur.

Kapituj të këtij libri si "Nga pavarësia tek "internimi" në Vjenë", "Kongresi i Lushnjes dhe vitet e triumfit" (1920-1923), "Zogu dhe kundërshtarët e tij politik", "Shpallja mbret dhe oborri mbretëror" etj, ndonëse përshkruajn me detaje të holla rrugën dhe metodat që përdori Ahmet Zogu për të zënë majat më të larta të karrierës së tij nuk përshkohen nga analiza të thella, por paraqiten thjeshtë si ngjarje, pak ose aspak nuk nxjerrin esencën e ndodhive dhe të shkaqeve që çojnë në ndryshime, dhe shumë pak për të mos thënë fare nxjerrin përfundime me vlera dhe japin prognozën parashikuese mesazhore.

Ndonëse fokusohen dhe përmenden një sërë personazhesh, ndodhishë, datash, kthesash historike, që lexuesi ndoshta i takon për herë të parë, autori nuk thellohet në shkaqet hsitorike, në rolin e shtresave dhe klasave shoqërore, në përfundime shkencore, mandej nga një herë dedukton jo drejt, cektësisht dhe anashkalon gjërat kryesore. Kështu duke folur për pjesëmarrjen në Kongresin e Lushnjës autori thotë: "Një pjesë e delegatëve kishin mbërritur herët në mëngjes dhe qenë ende të përbaltur…Asnjë prej përfaqësuesve të 27 qyteteve nuk e dinin se pa dashje, ata po hynin në një ndër mbledhjet më të rëndësishme që do të njihte historia e Shqipërisë…" (f. 39).

Si mund të pranohet ky përfundim kur për organizimin e këtij kongresi ishte punuar shumë dhe gjatë? Delegatët ishin plotësisht të ndërgjegjshëm për atë që po bënin, se ata nuk kishin ardhur rastësisht. Ose: në faqen 55 autori shkruan: Një prej problemeve më të rëndësishme të qeverisë ishte edhe caktimi përfundimtar i kufijëve që po dizenjoheshin në vend nga një komision i fuqive të luftës…" Më tej në f.109. shkruan: "Çështja e Vermoshit dhe Shën Naumit, caktimi i kufirit midis dy vendeve është parë nga historiografia komuniste si një tradhëti e Mbretit Zog. Shqyrtimi i dokumentave e përcakton atë si një aktmarrëveshje dypalëshe nën sygjerimet e ndërkombëtarëve për të harmonizuar më mirë vijën kufitare. Vermoshi dhe Shën Naumi janë përdorur më shumë si argumente të luftës politike se sa si argumente të mirfilltë historikë."

Këtu Blendi hedh gurin dhe fsheh dorën. Ai bie në batakun e madh. Kjo është një ndër çështjet ku ndahet shapi nga sheqeri. Vuloset tradhëtia apo ngrihet në qiell Zogu si Mbret. Këtë shqiptarët duhet ta dinë mirë dhe qartë. Kur egzistojnë dekomenta, përse z. Blendi nuk i shpalos dhe nuk ia paraqet lexuesit? Përse nuk i përgjigjet dhe nuk e kundërshton Prof. Kristo Frashërin?

Çështja është e qartë. Dekomentat flasin qartë. Prof. Frashëri e ka trajtuar gjërësisht dhe e ka argumentuar plotësisht duke konkluduar: " Që me 27 prill 1924 Lidhja e Kombeve njoftoj se në përfundim të trajtimit të çeshtjes edhe nga Dhoma e Drejtësisë Ndërkombëtare (Gjykatorja e Hagës), Manastiri i Shën Naumit i takonte Shqipërisë… Ky territor i ishte njohur shtetit shqiptar …Pavarësisht nga shtojcat tinëzare të kushtetutës, t'i dhurohej një shteti tjetër vetëm se prej tij A. Zogu pati përfitime personale, ishte pa dyshim një cënim i integritetit kombëtar të shtetit shqiptar, pra një faj i rëndë ndaj atdheut, ndaj kombit. (Prof. K. F. f. 106, 107 Ahmet Zogu. Vështrim Historik)

Profesori i nderuar na i jep qartë 16 pikat e marrveshjes, debatet parlamentare që janë pasqyruar në mbledhjet e parlamentit të kohës, proçedurat e nxituara dhe amendimet që iu bënë kushtetutës, të cilat përligjën zyrtarisht marrjen e këtyre tokave padrejtësisht, me tradhërti nga vetë Ahmet Zogu. Kjo, jo se i ka shpëtuar autorit Blendi Fevziut, por se si pikë nevralgjike që është, që Zogun e fut në rrugën e tradhëtisë, ai e anashkalon. Blendi e di se këtë nuk e përtyp shqiptari lexues, prandaj edhe hamendëson e dedukton duke bërë fajtore historiografinë shqiptare.

Po kështu në kapitullin "Pushtimi i Shqipërisë" në të cilin autori Fevziu sjellë shumë hollësi, ndodhi, emra personalitetesh, takime ambasadorësh, ushtarakësh, qëndrime të vendeve të ndryshme etj. nuk thotë gjënë kryesore. Atë që i duhet thënë çdo shqiptari, qartë dhe saktë. Ai përpiqet të argumentojë e të sjelli në memorie qëndrimin e reagimin e Zogut ndaj ultimatumit dhe kërkesave të Italisë, mandej na ka dhënë edhe dekleratën e tij të fundit ku midis tjerash thotë:" Unë dhe qeveria ime nuk do të pranojmë kushte të tilla që kanë për qëllim minimin e lirisë së fituar me gjakun e popullit. Përballë pushtimit, e ftoj popullin të bashkohet sot, në këtë moment rreziku, të mbrojë sigurinë e vendit dhe pavarësinë e tij deri në pikën e fundit të gjakut…"

Dhe përfundimisht e la në udhëkryq. Nuk bëri as minimumin vlerat, ngrenë në qiell antivlera, mjafto që t'u shërbehet atyre për të çimentuar karriget e pushtetit.

Shkrimtari i talentuar Lutfi Hanku duke folur per metaforizimin e një libri thekson: "Emërtimi i një vepre i ngjan portës së një pallati apo të një qyteti që, kur hyn brenda njihesh me madhështinë e vlerave që përputhet emërtimi me brendinë." Vlera e hulmtimit dhe përgjithsimit të librit të Blendit as që përputhet fare me titullin "Ahmet Zogu. Presidenti që u bë mbret". Mjeshtria e artit të fjalës së shkruar nga autori Fevziu nuk i jep lexuesit profilin e një presidenti që bëhet mbret.

Kapituj të tillë si: "Në rrugët e Europës", "Vitet e lutës në Angli", Vitet e fundit të Mbretit Zog" mbeten shumë të zbehta përpara argumenteve dhe realiteteve që sjellë prof. Frashëri. Ata jo se nuk kanë interes kurreshtar, por nuk përligjin në mënyrë të denjë përpjekjet e Ahmet Zogut për interesat e Shqipërisë dhe të shqiptarëve. Ata më shumë janë përpjekje të një mbreti për tu rikthyer në karrigen e tij se sa përpjekje për zhvillim e përparim të Shqipërisë e shqiptarëve.

Sa për kapijtut: "Dasma Mbretërore", "Njeriu i 50 atentateve", "Zogu dhe gratë", janë pjesë që trajtojnë jetën private të Mbretit Zog, të cilat vërtetë paraqesin kureshtje, por nuk janë thelbëzore.

Përfundimisht: Në morinë e librave të shkruar për Ahmet Zogun, vëndin kryesor me vlera historike dhe shkencore e përbëjnë: Monografia e botuar në Anglisht në Santa Barbara, Kaliforni në vitin 1984 nga historiani amerikan Bernd Jurgen Fischer, varianti i tij shqip "Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri" përkthyer nga Krenar Hajdari, Tiranë 1996 si dhe libri "Ahmet Zogu. Vështrim Historik" i prof. Kristo Frashërit. Ata janë kontribute shtesë dhe i bashkangjiten fondit të historiografisë shqiptare nga ku lexuesit tanë marrin njohuritë e nevojshme shkencore dhe më të plota për Ahmet Zogun si personalitet politik dhe Sovran i popullit shqiptar.

Pavarësisht se libri i autorit Blendi Fevziu nuk ka nivelin dhe vlerat e dy librave të mësipërme në vetevete ka mbushur një boshllëk nga ku lexuesi merr të dhëna dhe nxjerrë përfundime me vlerë si: Dëshirën për të ndërtuar një shtet të fortë dhe të vërtetë, dashurinë për prindërit e veçanërisht për nënën, ku shembulli i Ahmet Zogut është vërtetë admirues, respekti, mirëkuptimi, harmonia dhe besnikëria bashkëshortore, ndërtimi i një jete dinnjitoze nga Mbreti Zog dhe familja e tij në vendet e ndryshme të botës…

Nga ky libër lexuesi mëson se si të përballet me çdo padrejtësi, me shtypjen dhe varfërinë, si të ngrejë vigjilencën për dukuritë negative që vihen re edhe sot në Shqipëri për hartimin e miratimin e ligjeve, për të frenuar shpenzimet e tepërta dhe luksin e parlamentarëve, qeveritarëve e politikanëvet tanë, mbi të gjitha për të kërkuar zbatimin e betimit të bërë para popullit nga deputetët, politikanët e pushtetarët e çdo rrëngu.

Rruga e Arbërit nr. 106

"Është fatkeq vendi
që nuk ka heronj" - *(Brehti)*

Skënderbeu *i takon Kombit, por rrënjët i ka në qytetin* **e Çidhnës**

Nga **ISLAM CANI**

RRËNJËT E KASTRIOTËVE

Siç çdo shqiptar kudo që ndodhen edhe unë jam i lumtur që shkruajnë, hedhin dritë kujtojnë dhe nderojnë veprën e madhe të Heroit Kombëtar Gjergj Kastriotit, pavarësisht se çdo kush prej tyre do që ta bëjë atë pjesë të shpirtit, të familjes apo të vendit të vet, Pse Jo ?! të tillë janë historianë, shkrimtarë, bashkohës, atdhetarë e autorë vendas e europianë. Autorë të tjerë kërkojnë në arkiva, hulumtojnë, pretendojnë e kanë mendime ndryshe mbi origjinën dhe vendlindjen e Kastrioteve, në mënyrë të vecantë të Skënderbeut.

Gjithsesi, të gjithë lartësojnë figurën e tij, pavarësisht se të gjithë duan të marrin sado pak nga drita vezulluese shekullore, nga vepra e hyjnizimi i tij, për të forcuar rrënjët, fshatin, krahinën, fisin, deri në familje. Të gjitha këto janë virtyte të fisnikërisë, modelit të trashëguar, yllit të pashuar në shekuj, lartësimi i shqiptarëve kudo në europë e më gjërë. Fisnikëria është virtyt dhe moral i shqiptarëve, që do ta shqipëroja në mençuri e hyjnizimin që së lashti e deri në ditët tona. Të më fali lexuesi, por kjo fisnikëri spikat dukshëm në atë që e quan populli "zotnillëku i dibranëve"

Me të drejtë çdo shtet, vend, krahinë, individ, do të dëshironte që H. Kombëtar, këtë vigan të historisë, ta kishte nga vendi i tij, por ka dhe ziliqarë që hedhin teza e bëjnë tymnajë e mjergullnajë, e çuditen se si ky strateg është shqiptare, arbëror !? Harrojnë se, në shumë ligje të shkencave ekzakte, por dhe ligjet natyrore vërtetojnë se dy të kundërta tërhiqen ndaj njëri tjetrës. Ndaj dy të kundërtave është ndërtuar dhe jeton bota; ndaj të kundërtave zhvillohen reaksione kimike më shumë. Ka edhe një thenie të popullit se, aty ku ka buruar sido që të ndodhë do të pikojë... ! Pa u zgjatur do të thoja se historia dhe të dhënat arkivore, dokumentojnë se Kastriotët njihen në mesin e shekullit XIV, me Pal Kastriotin, gjyshi i Skënderbeut i cili kishte në zotërim fshatrat Sinë dhe Gardh të Poshtëm në zonën e Çidhnës dhe të Dibrës. I biri i tij, Gjoni mori në zotërim disa vise të tjera, ai mori në dorë Principatën, në vitin 1402. Forcimi i Principatës së Kastriotëve erdhi duke duke zgjeruar pushtetin e tyre me shtrirje më të madhe gjeografike. Sipas burimeve nga Instituti i Historisë së cilës i jam referuar shpesh herë rezulton se për herë të parë fisi i Kastriotëve përmendet në vitin **1368 (1383-1474**) si ndërtues e kështjellar të Dibrës, Mirditës, Matit deri në Kaninë, pra njiheshin si ndërtues kombëtarë.

Sikurse u tha gjatë mesjetës, bujarët shqiptarë në përgjithësi, kanë përdorur emra të ndryshëm të maleve, kepave, shpendëve, vendit dhe profesionit të tyre. Madje kjo praktikë ka vazhduar deri në ditët tona, madje edhe te Kastriotët në Çidhën.

Autorë e historianë të shumtë i referohen dhe bashkëkohësit të Skënderbeut Gjon Muzaka, përmend një të dhënë me interes duke thënë se "gjyshi i Zotit Skënderbeg quhej Zoti Pal Kastrioti dhe kishte në zotërim dy fshatra të quajtura Sinja dhe Gardhi i Poshtëm." Kështu Muzaka thotë se Pal Kastrioti ka qenë zot i Sinës dhe i Gardhit të Poshtën rreth çerekut të shek. XIV ose relativisht rreth viteve 1380, pikërisht në kohën e fuqizimit të krerëve feudalë shqiptarë.

Autorë e historianë të shumtë që nga Barleti, Fan Noli, S. Pulaha, A. Buda, Dh. Shuteriqi, K. Frashëri etj. Pavarësisht se, hedhin ide, por shumë më pak e mbështesin në toponimet e krahinës së Çidhnës e Dibrës. Mendoj se duke bërë bashkimin studimeve me toponimet, me fiset, me trasëgiminë dhe gjuhësinë, me rrënjën e më pas me trungun e zhvillimin degësor. Origjinën e Kastriotëve dua ta trajtojmë si pemë gjigande me shumë degë, për të cilën do të japim fakte e argumente reale e bindëse. Ku sipas meje është e padiskutueshme vendorigjina Çidhna por me 5 shtylla përforcuese që e bëjnë të përjetshëm Heroin Çidhnak, Sinjan e Dibran.

Në këtë shkrim, shpreh përpjekjet e mia bindëse të padiskuteshme në strukturën ndërtimore që nga "dheu e rrënja", natyrshëm që kush ka dëshirë është i lirë që kësaj skeme të përdorë arkitekturën.



Rrënjët i studioj larg në kohën e mbretërisë Ilire të Veriut. Aty, fillon jeta dhe rrënja. Fjalën e vjetër "rrënjë" në mesazhin e bukur dhe të dhimbshëm e ka dhënë historia jonë e ngulur në kujtesën popullore të shqiptarëve me forma dhe përdorime të ndryshme krahinore e dialektore si, ***"Nuk ka degë pa rrënjë", rrënja është në dhe" rrënja është Atdhe...për të cilën flasin toponimet dhe emërtimet.***

Rrënja ka hyrë edhe në kufijtë e zemrës njerëzore shqiptare ku dijetarë të shumtë kanë thënë "Gjuha e ka rrënjën në zemër". Kjo duket qartë me jetën e banorëve të qytetit tonë të hershëm të Çidhnës, e Sinës, ku dëbimet masive të banorëve në kohra lutrash të shumta, ashtu si të gjithë shqiptarëve në shekuj, kanë marrë një shprehje të spikatur *"u shkulën me rrënjë e me degë"* ose "*shkulën me degë e lis*" u degdisën thuhej, ndërsa, kudo që shkuan u ngulën dhe jetuan gjuhën e nënës gëzuan, rrënjët i shtuan, nga një bimë, një degë u bënë një fis .....Dua ta vazhdoj shkrimin për njohjen e mëtejshme të rrënjëve të vjetra të Kastriotëve duke gjurmuar në kohra mbi dyndjet e ilirëve dhe të arbërve, situatat dhe evolimet në etapa historike. Emigrimet janë bërë në grupe, fise të tëra e kohra të ndryshme.

Shtegëtimet e ilirëve veriorë kanë filluar qysh herët në kohën e helenëve, në shekujt e mëparshëm (shek. VII-V) p.Kr. këto janë me dokumentuara të pakta.

Dëbimet të detyruar nga luftrat iliro-maqedonase, iliro romake, në shekujt II-I pes.

Dyndje të tjera u realizuan në kohërat e sulmeve barbare, në kohën luftrave të bizantëve dhe osmavëve, përkatësisht në shek. VI, IX, XII deri në shek XVII te erës sonë. Dyndjet e banorëve ishin në greqi, në itali dhe në vende të tjera fqinjë.

Jo pa qëllim trajtova shkurtimisht emigrimet sepse dua të bëj lidhjen e lëvizjeve të fiseve nga Çidhna e Dibra që në kohët e hershme. Zanafilla e kastriotëve fillon nga fiset e degdisura në kohën e luftrave dhe të shkatërrimit të qytetit ilir të Çidhnës. Aty fillon rrënjëzimi e degëzimi i ilirëve dhe bujarëve, i mjeshtrave të punës dhe të armës. Historia e fiseve shqiptare është historia e pashkruar e Shqipërisë, ajo ndodhet ende në errësirë, shkruan në veprën e M. Shuflajt, ku ndër të tjera shkruan se;

Shtrat të parë fisnor etnik ai, konsideron fiset ilire të Labeatëve, Pirustëve, Sardeatëve, Batieatëve, Matringve, Albinve, etj.

Shtrat i dytë janë pas tij, janë fiset që përmenden 1304 duke radhitur fiset e vjetra të Çidhnës: Rizonve, Matrëngës, Mashotin, Albinët, Dhogët, Grubës, Spatus, Scuras, Buceos, Manerkos, etj.

Në shtratin e tretë hyjnë fiset që ruajtën identitetin dhe rezistuan që nga lashtësia, sigurisht dhe emra e fise të reja me reputacion ekonomik, tregtar dhe ushtarak si; Matranga, Rizani, Majsku, Lleshi, Vigu, Bisi, Kola, Manerkolli, Guri, Bitri, Spata, Koltraka, Bardhi etj.

Herët në periudhën e luftrave iliro-romake-maqedone, nga masakrat e pushtuesëve mbi banorët e qytetit të Çidhnës dhe gjithë pjesës së ilirisë së veriut filluan largimet e popullsisë. Një pjesë u morën skellëver e u degdisën për në romë, të tjerë ju rikthyen maleve në kalatë mbrojtëse për të mbijetuar. Ajo që vlen të theksojmë është se fise të tëra ilire të veriut u larguan, në hapsira të ndryshme gjeografike ku sot gjen toponime, emra, mbiemra e fise, një kulturë kjo e trashëguar ndër mijëra vitesh.

Kështu ndodhi dhe me largimin e fisit matranga të çidhnës të cilët u degdisën si shumë banorë të tjerë nga koha e rrënimeve dhe e luftrave të ashpra për të mbrojtur qytetin dhe familjen e tyre që në kohën e luftrave romake. Vërtetë emigruan, por kudo që shkuan morën Dheun me vete, emrin, gjuhën, traditën, i dhanë jetë jetës së tyre prej shqiptari, dibrani e çidhnaku të vërtetë. I referohem kryefjalës së shkrimit tim; fisit Matranga të Çidhnës, luftëtarë, fisnikë, ndërtues, dijetarë, predikues e profesorë të nderuar. Matrangën e Çidhnës si shumë fise të tjera e gjejmë të emigruar në Itali në qytete të shumta arbëreshe (matraxha), i shpërndarë në Gjakovë – Kosovë, si fis, si toponim në Kukës, në Çaj te Laku u Canit, në Çidhnën e vjetër është si fis dhe si toponim, në Shkodër, në Gollobordë, ruhet si fisi Matranxha.

Kush ishin Matrangët ? Fise të rëndësishme banonin në qytetin e Çidhnës si, Matranga, Rizoni (në dialektikën e vendasve vjen dhe si Rizvani, ashtu sic ndodh me Gjoni – Jovan), Kola, Mashoti, Bardhi, Çoku, (Çeku), Prifti, Skura, Bitri, Kolleshi, Kolnezha, Koka, Kolmajsku, Duka (zotër të qytetit në mesjetë), Karoshi (ushtarakë e shoqërues të karvaneve), Koltraka etj. Nga ky fis i vjetër formues të qytetit të Çidhnës në trojet e tyre stërgjyshore jetojnë me toponimet, kisha Matrangës, kisha e Vilzës, Trojasi, Fushë-Ban, kisha dhe trojet e Shënkollit, kisha e Shëngjergjit, Shumërtajtha që lidhet me kroin e kishës matrangës etj. Matranga zotërues dhe predikues fetar, shpesh e njihnin dhe Luca i paganve, (ndriçues, mjeshtër, ciceron). Krahas Matrangës (matrangjës), ishte dhe Mashoti si fise të Çidhnës së vjetër, nga ky i fundit kemi mashën dhe shotin (mashoti).

Matranga, duke qenë fis me potencial e zotërues i Çidhnës, shpesh nga vendasit njihej si Atzot (themelues, kryesues, zot i të gjithëve, prind) ose me shprehjen Babazoti e Tatzot-Tanzot. Këto cilësi i ruajtën dhe i trashëguan edhe pasardhësit e tij, por edhe çekiçët e tij (ciceronët). Atzoti i matrangës së çidhnës kohë më vonë përfaqësohet me Rizanin. Rizani kishte pjesën e Sinës, ai shquhej si shpikësi i parë i ndërtimit, kasolleve, izmave, kështjellave, pirgjeve e kalave, krahas shfrytëzimit të ujrave e liqeneve, si ngulësit e parë në Çidhën. Nga familja matranga lindën shumë fëmijë si gjithë bujarët e tjerë ruanin dhe trashëgonin emrat e të parëve të lidhura sigurisht me pronat që ata zotëronin si, Vigun, Rizanin, Matrajsin, Argjën, Hyjrajn (zanën), duke ju lënë përkatësisht dhe zotërime vendore e ujore.

Djali i parë i Matrëngës ishte Vigu (r), si mbrojtës në pikën kryesore në mbrojtje të Tërthores në lumin Drin atje ku sot është kroi Vit, (me duhet të bëj lidhjen e pastër të emrave dhe të toponimeve). Emri Vigun, pësoi transformime dialektore dhe kohore si, Vigur, Vitur, Vigan etj, duke na lënë të kuptojmë vigjilencën, fuqinë zotëruese, vlerën e fisit dhe të vendit. Dua të bëj një paralelizëm ndërmjet Vigut dhe Skënderbeut sepse në kohën e luftrave me osmanët, vetë Skënderbeu strukturoi kalatë në përgjithësi dhe në veçanti kalanë në malin e Vigut që shërbente si pikë strategjike vrojtuese e kontrolluese të të gjitha rrugëve dhe kalave fqinje deri në Petralbë e Petrelë. Pra historia ecën në gjurmët e të parëve. Pas Vigut vjen fisi i Shasharit sot ruhet si toponim.

Djalin e dytë, Rizanin**:** zotërues në Sinë, në mbrojtje të lumit e liqenve në kodrën e gështenjave, e cila shërbente si pikë vrojtimi. Shpesh banorët e njihnin Rizanin si fisin e "Gështenjave". Në pyllin me gështenja filluan ndërtimet e para, pirgjet me gurë të thatë, që shërbenin si vende strehimi, si kështjella të vogla në formë të thjeshtë katrore apo të rrumbullakët. Rizani ndërtues i Çidhnës dikur dhe Sinës më vonë kishte nën kontroll teritorin deri në Vajmëdhenj e Thekanush. Vend i ngrohtë, me ujra, pyjeve me gështenjë dhe njerëz të zotë, bujq e blektorë, ku mbillej elbi, tepa, tërshëra, merreshin vreshtari, me peshkimin e bletarinë. Matranga me pasardhësit dhe ciceronët e tij të besueshëm, herët kanë qenë zotërues në në këto zona të Setës (artatusit) dhe Voksetës, e më gjërë.

Argjër-i, Argjini; një tjetër pasardhës i Matrangës me teritoret e tij nga Gurë Lura e Sotme, Lurën deri në kufi me Vigun. Prej tij, vjen fisi Guri trashëgohen me fiset e Bitrit dhe të Kalisë. Kështu i gjithë fisi Matranga zotëronte Çidhnën, Grykë Nokën, Xhaxhishtin, në Kroin Vit, në Prat deri te Varrët e Cullve ku sot janë shtëpitë e Skepit, poshtë shtrihej deri në Shashar. Në atë zonë që thamë më lart (zotërimet e matrangës), janë dhe sot toponimi tek Kreshta e Skënderbeut, te Gështenjat, toponimi gështenjat e Sinës, po aty janë shenjat e ndërtimeve të para murore (izmat), ndërtimet e nëndheshme me gurë dhe me plisa; këtë e deklarojnë mbi 20 persona të pyetur të moshave të vjetra. Aty janë toponimet, zotërimet, të dhënat fisnore na bëjnë lidhjen dhe vazhdimësinë nga Matranga te Kastriotët, sepse në trojet e matrangës kemi toponimet kroi i Tatzotit, ose kroi Princit, trojet e Tatzot, etj.

Matranga, Rizoni në vazhdimësi të jetës dhe trashëgimisë si zotëruesëve të Çidhnës vijnë në breza me Dhogën dhe Palin tani të njohur si Kastriotë. Dhoga; kishte qytetin dhe Setën ndërsa fuqinë e Matrangës e mori Lleshi.

Rizanët ishin ndërtuesit e qytetit të Çidhnës e Sinës, dhe specialistë, mjeshtra të gurit dhe ndërtimit, të mençur, ideatorë e ushtarakë, kontrollues dhe drejtues të qytetit, si të tillë me duart e arta dhe me mendjen e hollë të tyre ata e zgjeruan mjeshtërinë e tyre në gjithë vendin. Ndërtimi I Çidhnës dhe Sinës, vendosja dhe ruajtja e toponimeve në ndërtimet e qyteteve, të kalave e kështjella i dhanë emërtimin Kastriotë. Kohë më vonë Kastriotët u zgjeruan me ndërtime e zotërime përgjatë Drinit në Fushën e Thatë, në Kuke e Kastriot sot, në Macdhovë ose Fusha Sale. Koha e rindërtimit të vendit, ju diktoi të ndërtojnë dhe meremetojnë kala e pika të tjera mbrojtëse. Kështu në historinë si feudalë u njoh Pali gjyshi i Skënderbeut, Gjoni djali i Palit. Pal Kastrioti, tanimë njihej feudal e bujar, ai kishte në zotërim dy katundet sikurse e thamë më lart, Sinë e Poshtme, Sinën e Epërme, dhe Gardhin e Poshtëm, Gardhin e Epërm, zonën e Çidhnës dhe të Dibrës. Ndërsa, Gjoni**,** i ati i Skënderbeut, i zgjeroi më shumë zotërimet e tij jo vetëm në Dibër, Mat, Mirditë e deri në Krujë e më gjërë. Njihen tanimë Kastriotët jo vetëm zotërues, drejtues dhe strategë, princër të arbërisë.

(vijon në faqen 17)

emigracion

Po të punosh këtu një ditë hash bukë shtatë ditë,
kurse atje duhet të punosh shtatë ditë për të hangër bukë një ditë.

Xhemal Zeqja në ëndrrën e këputur të kthimit

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**



Pak njerëz sot në Peshkopi e kujtojnë Xhemal Zeqon, të qeshurën, gazin me shokë e miq, punën me kulturën. Xhemali tash 18 vjet e ka lënë Peshkopinë, mori rrugën e vështirë të ikjes maleve. Gjevgjelinë dhe kalimin e kufirit e ka në sy dhe në trupin që i dridhet sa herë e kujton.

E ka në mallin e mallit të shpirtit Peshkopinë, por kur shkon atje e ndjen veten të huaj.

Të huaj kur ngjit shkallët e pallatit ku u rrit dhe u burrërua.

Të huaj kur shëtit nën kurorën e blirëve të Agushit.

Të huaj?!...

O zot si u bëmë të huaj në tokën ku na ra koka? Si vdiqëm të gjallë dhe kush nuk na njeh e nuk na sheh, nuk njohim e nuk shohim?

Xhemal Zeqja e ka lënë Peshkopinë në vitin 1995, fizikisht, individualisht por datë lënie dhe ikje ai njeh e mban mend 17 majin 1998, kohën kur u bë qytetar legal në Athinë, ai së bashku me bashkëshorten dhe fëmijët.

Në Peshkopi pasi la (ia hoqën) punën si përgjegjës kulture në divizion dhe në park, ca kohë punoi kamerier (e mbaj mend kur shërbente në kafenenë e një shoku të tij të ngushtë), roje nate në një karburant, vendosi të mërgojë... E vështirë ikja, më thotë ai, e vështirë dita e parë e punës, të vështira ditët që vinin e iknin. Kallupaxhi, siç quhet puna më e vështirë në ndërtim, punë me hekur e beton, me kallëpe druri e metali, djersë deri në rrjedhje çezme, kurriz deri në këputje, gojë të mbyllur për shkak të mosnjohjes së gjuhës. ...

Kështu do të kalonin ditët, muajt vitet. Do t'ia merrte anën punës, do t'ia merrte fjalën gjuhës, do të ndërtonte jetën si gjithë të tjerët...

Djali e kaloi kufirin kur ishte vetëm dy vjeç. Vajza lindi në Athinë. Gruaja, për ta mbajtur shtëpinë të ngrehur ka punuar dhe punon si të gjitha gratë shqiptare, si e imja dhe e jotja, punë nëpër shtëpia, punë që siç thonë në Dibër "shpinë këputur e punë pa dukur". Shyqyr që gratë greke janë dembele, aq sa as dyshekun ku kanë flejtë nuk e rregullojnë e papastërtinë e kanë tapi brez pas brezi. Shyqyr që grekët nuk e pëlqejnë bishtin e kazmës dhe të lopatës, nuk e pëlqejnë çimenton mbi rroba e pikat e bojës mbi fytyrë. Shyqyr që shqiptarët kanë në trup genin e punës, punës pa qibër, tapinë e mbijetesës kudo e kurdo.

Xhemali jeton qetësinë e njeriut që mendon e punon të hedhë rrënjë. E ka zgjidhë problemin që shumë shqiptar e kanë "shpatë mbi kokë".

"Me dokumente jam mirë, më thotë. Kam leje qëndrimi të përhershme së bashku me gruan. Djali ka leje qëndrimi pesëvjeçare kurse vajza ende është në shkollë, nën 18 vjeç..."

Shpresë ka tek qeveria e majtë e Cipras. " Po e mundësoi Cipras do të marrim nënshtetësi greke..."



Qeveria Cipras, me deklaratat e hedhur në hapat e saj të parë të qeverisjes për dhënie nënshtetësie për emigrantët ka ngjallë shpresa tek të gjithë ata që deri tani kanë jetuar mes dilemës hamletiane "Të rrimë apo të ikim...", mes rrënjë hedhjes apo rrënjë shkuljes.

Ka mall për Peshkopinë, shumë mall.

"Malli më merr për çdo gjë, më thotë. Më merr për gurët, për blirët, për shëtitjen mbrëmje mes shokësh, për pallatin, për gjithçka. Kur shkoj nuk arrij ta shuaj mallin, ndjehem si i huaj. Në pallatin ku jam rritur të gjithë janë të ardhur, asnjë nuk njoh e asnjërit nuk i them dot "mirëdita" pa ngjallë habi. Ka një rreth të ngushtë, shumë të ngushtë, që ende janë atje, shokë me të cilët mund ta pijë një kafe e të kthejmë fletën në kujtimet e fëmijërisë dhe rinisë..."

Përmend disa emra duke humbur në kujtime të largëta....

...Dëfrim Fida, Besim Çorja, shok i ngushtë i vëllezërve të mi...

Përmend edhe të tjerë, "brigadën" e shpirtit të tij që ndodhet në Tiranë. Të parin përmend Jeton Shehun. Me jetonin ka një miqësi të veçantë, nga ato miqësi që kanë për themel dhe kolona sinqeritetin, dashurinë e madhe për njeri-tjetrin. E kam provuar këtë kur Jetoni erdhi në Athinë para një viti. Trokiti së pari në derën e Xhemalit përpara se të trokiste dhe të ngjitej në katin e shtatë të apartamentit ku unë banoj për tu takuar me Natashën, vajzën e xhajës së tij. E kam të shkrirë në shpirt atë takim, e kam të fiksuar edhe në një foto në celular të dy mbi motoçikletë...

Përmend me mall MensurShehun, Bes Prapanikun, Esat Shehun, Bashkim Kadriun i cili pasi punoi disa vite në Greqi, në Nafplio, është këthyer në Shqipëri.

E ka edhe një plagë, plagë që i mbetet e pashëruar kur një shok, një mik, një vëlla i jetës, ikën pa kthim, ikën në dhimbjen e përjetësisë. Petrit Uka që ka ikur një ditë pranvere është malli dhe brenga e tij.

Atë ditë që biseduam më kërkoi ta pimë kafen në një lokal ku jemi takuar disa herë. Më mori

"Malli më merr për çdo gjë, më thotë. Më merr për gurët, për blirët, për shëtitjen mbrëmje mes shokësh, për pallatin, për gjithçka. Kur shkoj nuk arrij ta shuaj mallin, ndjehem si i huaj. Në pallatin ku jam rritur të gjithë janë të ardhur, asnjë nuk njoh e asnjërit nuk i them dot "mirëdita" pa ngjallë habi. Ka një rreth të ngushtë, shumë të ngushtë, që ende janë atje, shokë me të cilët mund ta pijë një kafe e të kthejmë fletën në kujtimet e fëmijërisë dhe rinisë..."

në telefon dhe më kërkoi librin "Rrëfimet e komshiut". Disa ditë më parë ishte në promovimin e serisë prej gjashtë vëllimesh "Njerëz që i dua" dhe të filmit dokumentar "Vera-mësuesja në dy ishuj" punë imja në mërgim, organizuar nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Athinë. Më ngrohu prania e tij. Më ngrohu edhe për një fakt që prej vitesh më mungon, faktit që ne dibranët nuk mblidhemi me njeri-tjetrin siç mblidhen lushnjarët, vlonjatët, përmetarët, korçarët...jugorët. Në Veri, fatkeqësisht, nuk ka shoqata mërgimtarësh në Greqi ndërsa në Jug ka fshat e shoqatë...

Ia dorëzova librin. E pyeta në se lexon libra dhe sa ishte i lidhur me librin shqip. Më tha se kohën e lirë e mbush me lexime librash shqip, libra që i merr apo ia sjellin nga Shqipëria. Më flet edhe për një libër me poezi të E. Bungurit që i ka ngjallur mall e dashuri.

E ka një shtëpi në Tiranë, shtëpi ku nuk troket askush, "shtëpi-magazinë" siç thotë.

E pyes në se do të kthehet në atë shtëpi, të hapë derën dhe ta mbushë me jetë.

"Për fat të keq, më thotë, do të rri në Greqi".

E thotë me dhimbje. Dhe shton...

"Po të punosh këtu një ditë, hash bukë shtatë ditë kurse atje duhet të punosh shtatë ditë për të hangër bukë një ditë"...

Xhemal Zeqja me rrënjë nga Dibra e Madhe nën Maqedoni tash po e ndërton jetën në një tjetër vend...

Kështu është shkruar për shqiptarët...

Athinë 20 shkurt 2015

Skënderbeu i takon Kombit, por rrënjët i ka në qytetin e Çidhnës

(vijon nga faqja 16)

Princi Gjon Kastrioti banonte në Sinë, por kishte dhe kështjellë (kullë) në Kastriot, vendbanim në Kështjellën e Varoshit (Stellush), në Gur të Bardhë dhe në Krujë.

Njihet qartë se banonte sipas situatave herë në Sinë të Çidhnës e herë në Kastriot dhe nëpër kala e kështjella të tjera të sigurta të Dibrës e sidomos në malësi.

Gjon Kastrioti, si djali nga një familje princërore brenda një kohe të shkurtër i zgjeroi territoret e familjes dhe u bë zotërues i fuqishëm.

Ai vuri nën kontroll rrugën më të rëndësishme të karvaneve prej Adriatikut e deri në Kosovë, duke ju siguruar atyre mbrojtje, siguri për tregtarët (që kalonin nga zotërimet e tyre) nga Dubrovniku deri në Prizren.

Kështu Kastriotët si pasardhës të Matrangës dhe Rizanve ishin zotërues e komandantë mbrojtës krahinorë (1382-1415), zotërues të mëdhenj të tokave, të kriporeve, skelave e shufadove.

Në këtë periudhë sundimi i Kastriotëve shtrihej në një hapsirë më të gjërë, tokash, rrugësh, skela, por dhe kështjella e kala, pika vrojtimi, sidomos në Dibër, Mirditë, Mat e përgjatë rrugës Çidhën –Tiranë – Durrës.

Fisi Duka me poste në qeverisjen bizantine, si ushtarakë e luftëtarë, drejtues të zotë, si administrator i qytetit. Duka i njihte Kastriotët si zotërues të vendit. Ndërsa fisi Karoshi njihet si, ushtarak dhe shoqërues i karvaneve në Mesjetë në të njëjtën kohë kemi dhe fisin Kovaçi.

***

Meqënëse ka ende hamendësime, teza dhe antiteza do shkruaj shkurt mbi biografinë e Gjergj Kastrioti (SKENDERBEU).

Gjergji lindi më 1405, në Sinë dhe kishte vendbanim në Kastriot, ai mbylli sytë më 1468. Kastriotët ishin të besimit katolik (të trashëguar nga matranga dhe predikuesi I parë fetar), kështu si të tillë ata e pagëzuan djalin e tyre sipas riteve fetare të krishtera në kishën e Sinës. Gjergj gjithë forcën e gjeti në vendlindjen e tij në Çidhën, aty ku kishte genin dhe rrënjët. Skënderbeu erdhi pikërisht në Çidhën në vitin 1443 për të organizuar e drejtuar lëvizjen çlirimtare kundër pushtuesve osmanë.

Faktori kryesor i ardhjes së Skënderbeut është se ai ishte bir i Çidhnës, origjina nga fiset e para Ilire të qytetit të Çidhnës ishte shtysë për ardhjen e tij. Fakti tregon se osmanllinjtë e etshëm për ta zhdukur nga rrënja këtë fis, me betejën më të madhe të Tërvjollit 1444 në Topojanin e Sinës, e cila është 170 hektarë, rrënuan qytetin e Sinës dhe të Çidhnës, me synimin të merrnin Oenën dhe kështjellën e Macdhovës. Forcat e mëdha vinin matanë Drinit, goditja e parë e filluan në Qafë Thanë, Domosdovë, Librazhd, grykës së Drinit, Peladhi dhe qëllimi final ishte të zhduknin jo vetëm njerëzit, por dhe të tresnin gurët në gëlqere në Sinë dhe në Çidhën. Pas këtyre luftrave Çidhna u rrënua popullsia u largua dhe u kthye në fshat.

Më shumë mbi origjinën e Kastriotëve do tju njoh në vazhdim të botimeve "Çidhna - Dje, Sot, Nesër"

Rruga e Arbërit nr. 106

profil

Janë pikërisht këto juristë të shquar nga Dibra që kanë patur në dorë, dosjet më të nxehta penale dhe civile të tranzicionit shqiptar.

Kontributi i juristëve dibranë në fushën e drejtësisë

Nga MENTOR HOXHA



Treva dibrane është shquar për figurat e mëdha që i ka dhënë Shqipërisë dhe kombit shqiptar. Midis shumë figurave historike, politike, shkencore, letrare, artistike dhe kulturore bien në sy edhe mjaft emra nga fusha e drejtësisë si kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Bashkim Dedja, anëtari i komisionit parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Ulsi Manja, anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Neshat Fana, kryeprokuroi i Vlorës, Ramadan Troci, anëtarja e Gjykatës së Rrethit të Tiranës, Irena Hoxha, anëtari i Gjykatës së Apelit, Abaz Deda, avokatët Baftjar Rusi, Ramazan Topuzi, Përparim Noka, Hajdar Noka, Muhamet Hoxha, Ismail Uka etj., pa harruar gjyqtarët Dashurie Gjunkshi, Qazim Gjoni dhe mjaft të tjerë.

Janë pikërisht këto juristë të shquar nga Dibra që kanë patur në dorë, dosjet më të nxehta penale dhe civile të tranzicionit shqiptar. Vitet e pluripartizimit në vendin janë shoqëruar me ngjarje të mëdha politike, sociale, korruptive dhe kriminale që kanë tronditur publikun shqiptar dhe atë ndërkombëtar. Disa nga këto ngjarje kanë bërë xhiron e botës. Në gjithë morinë e këtyre ngjarjeve është gjyqi ndaj krerëve të lartë komunistë që nga Ramiz Alia (presidenti i fundit komunist), Nexhmije Hoxha (bashkëshortja e Enver Hoxhës) etj., skandali në Bankën e Shqipërisë dhe arrestimi i Guvernatorit, Ardian Fullani; kryengritja antiqeveritare e 14 shtatorit e 1998-ës, Marrëveshja detare me Greqinë, protesta antiqeveritare e 21 janarit dhe vrasja e katër protestuesve, arrestimi i Komandantit të Gardës së Republikës, Ndrea Prendi dhe i katër gardistëve, arrestimi i drejtorit të INUK, Zyhdi Dajti, rrëzimi dhe kapja e avionit me drogë në Divjakë, vrasja e Kryekomisar Dritan Lamajt dhe konfrontimi fizik brenda Kuvendit midis deputetit demokrat Genc Srazimiri dhe deputetëve socialist Pjerin Ndreu dhe Arben Ndoka.

Të gjitha këto dosje të nxehta janë hetuar, gjykuar dhe mbrojtur nga juristë dibranë. Prokurori i gyqit komunist ka qenë Neshat Fana nga Shumbati i Dibrës. Flet arresti për Guvernatorin e Bankës, Ardian Fullani dhe drejtorin e INUK, Zyhdi Dajti është bërë firmosur nga Ramadan Troci nga Reçi. Mbrojtja e pilotit italian Giorgio Riformato i akuzuar si trafikant i lëndëve narkotike është bërë nga Ramazan Topuzi nga fshati Lugje i Zall - Dardhës. Përparim Noka nga Blliçja ka mbrojtur në Gjykatën e Tiranës zëvendës komandantin e Gardës së Republikës, Alfred Ahmetcenaj, kurse Baftjar Rusi ka mbrojtur deputetin socialist Pjerin Ndreun, dy të arratisurit nga burgu, Admir Tafilin dhe Fran Marashin, të arratisur në mënyrë spektakolare nga burgu i sigurisë së lartë në Drenovë. Po ashtu ka mbrojtur edhe biznesmenin 44 vjeçar Arben Frrokun, i arrestuar dhe i akuzuar si vrasësi i kryekomisarit Dritan Lamaj.

Gjykata Kushtetuese, si një ndër Gjykatat më të rëndësishme në vend, është drejtuar në periudhën e tranzicionit shqiptar nga dy juristë të shkëlqyer Dibra; Fehmi Abdiu nga Sohodolli dhe Bashkim Dedja nga Luznia. Kjo gjykatë ka aq fuqi sa të pezullojë edhe kreun e shtetit, kryeministrin, të heq mandate deputetësh, të miratojë apo të shfuqizojë ligje të rëndësishme. Fehmi Abdiu ishte dibrani i pari që e mori këtë detyrë, por aftësia profesionale dhe diplomatike e luznakut, Dedja detyroi ligjvënësit shqiptarë të të gjitha forcave politike ta rizgjidhnin për të dytën herë në krye të këtij institucioni.

BASHKIM DEDJA, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Bashkim Dedja ka qenë aktiv në Lëvizjen Studentore Antikomuniste të Dhjetorit 1990. Është diplomua në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 1993. Ka punuar si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën e Apelit në Tiranë dhe Gjykatën e Apelit Durrës. Është pedagog i jashtëm pranë Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Tiranës në të drejtën penale dhe në Shkollën e Magjistraturës në lëndën "Shkrimi dhe arsyetimi ligjor", si dhe është ekspert i trajnimit vazhdues. Bashkim Dedja ka bashkëpunwwuar në disa grupe pune për hartimin e Kodit të Punës si dhe përmirësimin kodeve të Procedurës civile dhe penale. Në muajin maj të vitit 2010 u emërua anëtar i Gjykatës Kushtetuese dhe që nga muaji shtator i vitit 2012 është Kryetar i Gjykatës Kushtetuese, institucioni më i lartë kushtetues në vend. Nën drejtimin e Bashkim Dedes, kjo gjykatë ka marrë disa vendime të rëndësishme dhe të vështira: Rrëzoi vendimin e qeverisë për të shtyrë me gjashtë muaj hyrjen në fuqi të "ligjit të Nëpunësit Civil". Akti Normativ është rrëzuar si antikushtetues, pasi shkel parimet që përcakton ligji themeltar i shtetit. Kjo gjykatë rrëzoi edhe ankimin e opozitës së sotme për të shfuqizuar ligjin për ndarjen territoriale të miratuar në Kuvend me 88 vota nga mazhoranca aktuale. Gjithashtu, nën drejtimin e Bashkim Dedës, Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar edhe marrëveshjen e nënshkruar midis qeverisë shqiptare me asaj greke për ujërat territoriale.

NESHAT FANA, anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë

Neshat Fana është nga fshati Shumbat i Dibrës, është një ndër juristët më me zë në Shqipëri. Ka mbajtuar këto detyra të rëndësishme: prokuror, anëtar i Gjykatës së Lartë dhe i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Drejtor i shkollës së Magjistraturës, avokat i çështjeve më të rëndësishme politike, civile dhe penale.

Gjatë ushtrimit të profesionit ka pasur mbështetjen, respektin dhe admirimin profesional e moral të kolegëve dhe të publikut, parime të pacënueshme të tij. Pas rrëzimit të PD-së nga pushteti në vitin 1997, Neshat Fana u bë avokat i liderit të opozitës në atë kohë, Sali Berisha. Ai mbahet mend për mbrojtjen që i bëri Berishës në procesin e 14 shtatorit '98, së bashku me kolegun tjetër të tij, Kreshnik Spahiun, i cili u zgjodh më pas zv/kryetar i KLD-së. I etiketuar nga socialistët si avokat i Berishës dhe i Partisë Demokratike, është sulmuar shpesh nga kundërshtarët e tij politikë. Me të ardhur socialistët në pushtet u shkarkua si drejtor i shkollës së Magjistraturës. Ka qenë kandidatura më e mundshme për të zëvendësuar prokurorin e përgjithshëm, Theodhori Sollakun. Neshat Fana u bë i njohur në publik si prokuror i udhëheqësve të lartë komunistë menjëherë pas rrëzimit të komunizmit në Shqipëri, ku u gjykuan Ramiz Alia, presidenti i fundit komunist, Nexhmije Hoxha, e veja e Enver Hoxhës dhe udhëheqës të tjerë.

Fana ka mbaruar Fakultetin e Drejtësisë në vitin 1987 dhe po në këtë vit ka mbaruar kursin dyvjeçar për Diplomaci, me specializim "Problemet me Jugosllavinë e asaj kohe". Ai ka qenë drejtor i Hetimit në Prokurorinë e Përgjithshme deri në vitin 1996, ndërkohë që prej 1998 drejton studion ligjore "FANA". Në zgjedhjet e 3 korrikut 2005 ai kandidoi për deputet në Kuvend në zonën 22, ku humbi përballë kandidatit socialisti Sadri Abazi.

ULSI MANJA - anëtar i komisionit parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Deputeti Ulsi Manja vazhdon studimet për mbrojtjen e Gradës Doktor Shkencash në fushën e të Drejtës Penale me objekt studimi "Krimet mjedisore në Shqipëri". Është diplomuar për Jurisprudencë në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë. Që prej vitit 2006 mban titullin "Avokat". Nga viti 1966 - 2013 ka punuar në detyra të rëndësishme si: n/gjyqtar, prokuror, drejtues prokurorie dhe avokat në disa rrethe të Shqipërisë si në Dibër, Shkodër, Mirditë , Lezhë dhe si anëtar i Dhomës së Avokatisë, Tiranë. Në vitin 2003-2007 ka qënë Pedagog i Jashtëm i të Drejtës Penale dhe Proceduriale Penale në Universitetin "Luigj Gurakuqi" në Shkodër. Dhe nga viti 2007-2013 ka qënë Pedagog dhe Përgjegjës i Departamentit të së Drejtës Penale në dy Institucione Arsimore të Larta Jopublike në Tiranë.

Në periudhën 1999-2006 ka kryer disa specializime dhe trajnime brenda dhe jashtë Shqipërisë si në Poloni, Danimarkë, Itali dhe Gjermani në fushën e sundimit të ligjit, hetimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, në menaxhimin dhe kontrollin e sistemit të prokurorisë, në trajtimin e të dënuarve në sistemin e vuajtjes së dënimit etj. Nga viti 2003-2012 ka referuar dhe botuar disa punime mbi: fenomenin e gjakmarjes në Shqipërinë e Veriut, korrupsionin në sektorin publik dhe privat, imunitetin politik dhe gjyqësor, reformat në sistemin e drejtësisë si dhe një studim mbi "Përdorimin e drogërave të lehta" në Shqipëri nën kujdesin e Këshillit të Europës. Në zgjedhjet e 23 qershorit zgjidhet Deputet i Dibrës në Kuvendin e Shqipërisë. Bën pjesë në komisionin parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

RAMADAN TROCI, Prokurori "Hero" I Blogjeve Sociale

Imazhi mediatik i Ramadan Trocit nga Reçi ndriçoi në mbrëmjen e 5 shtatorit 2014, kur

doli me shpejtësi nga prokuroria e Tiranës për tu nisur drejt gjykatës duke kërkuar prangosjen e Ardian Fullanit, i cili konsiderohej si i paprekshëm. Firmosi edhe arrestimin e Inspektores së Përgjithshme të Bankës Elivar Golemi.

Si pjesë e Njesisë Antikorrupsion në Prokurorinë e Tiranës, drejtuar nga Deniona Katro, Troci u ngarkua me hetimin e vjedhjes së 713 milionë lekëve të reja në Bankën e Shqipërisë me datë 21 korrik 2014. Ai mori në pyetje autorin kryesor të vjedhjes Ardian Bitraj dhe firmois 19 urdhër arreste për skandalin. Arrestimi prej tij i numrit një të bankës, i cilësuar si i paprekshëm, përshkak të lidhjeve të tij me plotikën dhe gjyqësorin, u komentua dhe u vlerësua me superlativa në mediat dhe në rrjetet sociale.

Pak kohë më parë ishte i njëjti prokuror që firmosi urdhër-arrestin për ish drejtorin e INUK, Zyhdi Dajti, ndërsa ka në dorë çështje të rëndësishme si urdhëri i arresteve për 21 janarin, ku janë akuzuar ish drejtori i policisë së Tiranës, Hysni Burgaj dhe ish zëvendësi i tij, Agron Kuliçaj". Nuk munguan as thirrjet për ta mbrojtur nga frika e ndonjë hakmarrjeje politike. Troci ka hetuar edhe aksidentin e deputetit Sokol Olldashi. Ramadan Troci ka lindur në Reç të Dibrës. Fillimisht ka punuar si prokuror në Bulqizë dhe në rrethe të tjera. Nga muaji prill 2012-janar 2015 punon si prokuror në Njësinë Antikorrupsion të Prokurorisë e Tiranës. Aktualisht është kryeprokuror në Vlorë.

BAFTJAR RUSI, avokat

Baftjar Rusi është një njohës i shkëlqyer i Kushtetutës dhe i Kodit Penal e Civil shqiptar e ndërkombëtar. Ai ka mbrojtur në Gjykatë mjaft persona dhe çështje të rëndësishëm. Ai është edhe avokati i deputetit Pjerin Ndreu, i cili bashkë me kolegun e tij socialist Arben Ndoka gjykohet në lidhje me dhunën e ushtruar ndaj ligjvënësit demokrat Genti Strazimiri për shkak të detyrës.

Një tjetër dosje e nxehtë për Rusin është edhe dosja penale në ngarkim të bisnezmentit 44 vjeçar Arben Frroku, i cili arrestuar dhe i akuzuar si vrasës me 20 plumba kallashnikovi të kryekomisarit 41 vjeçar Dritan Lamaj. **Rusi ka mbrojtur edhe** Admir Tafilin, Fran Marashin pas arratisjes spektakolare nga burgu i sigurisë së lartë në Drenovë, bashkë me 7 të tjerë duke kërcënuar me armë gardianët.

RAMAZAN TOPUZI, Avokat

Ramazan Topuzi është një tjetër avokat i njohur nga treva dibrane. Ai është 47 veç dhe ka lindur në fshatin Lugje të komunës Zall-Dardhë. Nga rezultatet e larta në shkollë të mesme siguroi një bursë studimi në Akademinë e Rendit në Tiranë. Më pas u diplomua në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin Juridik të Tiranës. Në Policinë e Rendit ka patur disa detyra të rëndësishme; shef krimesh dhe shef rendi në qytetin e Peshkopisë dhe në disa qytete të tjera. Si avokat në Tiranë ka shqyrtuar shumë çështje të rëndësishme, duke trimfuar në shumë prej tyre.

Çështja që e vuri në qendër të mediave dhe të publikut shqiptar dhe ndërkombëtar ishte mbrojtja që pilotit italian, Giorgio Riformato, i cili u rrëzua pasditen e 10 majit 2014 në plazhin e Divjakës. Ai u arrestua nga policia dhe u akuzua si trafikant i lëndëve narkotike.

Pas përfundimit të masës së sigurisë, avokati i pilotit italian, Ramazan Topuzi u tha para gazetarëve të shumtë se "klienti i tij ka qenë vetëm turist në vendin tonë dhe nuk ka lidhje me trafikun e drogës".

PËRPARIM NOKA, avokat

47 vjeçari Përparim Noka është një tjetër avokat nga Dibra me një portret të spikatur dhe me një begraund të admirueshëm në çështjet penale dhe civile. Në vitin 1994 mbaron Universitetin e Drejtësisë në Tiranë. Më 2011 mbaron studimet për master të nivelit të dytë në degën "E drejta penale".

Në prill 1993 deri në gusht 1994 është oficer i Policisë Hetimore në Prokurorinë e Dibrës. Më 1994-1995 shef i Policisë Hetimore në komisariatin e policisë në Mat.Në periudhën 1995-2001 punon si oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Matit. Nga janari i vitit 2001 e deri më sot ka punuar dhe vazhdon të punojë si avokat. Është një ndër avokatët më të njohur në Tiranë. Dosjet penale dhe civile të mbrojtura prej tij janë të shumta. Si dosja më e nxehtë dhe më ndjeshme për publikun dhe politikën shqiptare ka qenë akuza ndaj klientit të tij, Alfred Ahmetcenaj. Ai u akuzua nga prokuroria se në rolin e zëvendës komandantit Gardës së Republikë ka urdhëruar vartësin e tij Agim Llupon të qëllonte mbi turmën që protestonte para Kryeministrisë në protestën e 21 janarit.

KËTU MUND TË ISHTE REKLAMA JUAJ PËR VETËM 1000 LEKË

Porosite tani: 069 20 68 603

sport

"Afrimi i portierit Aga rriti konkurrencën në ekip. Livani vendosi vetë për largimin, e lamë të lirë"

Korabi shënon dy fitoret e radhës: një në tavolinë dhe një në fushë

Nga **SASHENKA NDREKA**



Në kafenetë dibrane nuk bëhet më bisedë tjetër. Të gjithë flasin për Korabin, të gjithë shpresojnë për Korabin, të gjithë mezi presin ndeshjen e radhës. Titulli "Kampion Dimri" e hodhi tutje gjumin letargjik që mbështjell qytetin tonë në këtë stinë.

Dy muajt që ndanë fazat nga njëra-tjetra ishin të mjaftueshme për sportistët të bëhen gati për udhëtimin e gjatë që sapo ndërmorën. Sezoni i ri nisi me ndryshime në radhët e futbollistëve. Shtatë lojtarë të rinj veshën fanellat bardhë e kuq, të gjithë për një qëllim: titullin kampion.

Risi dhe ajo që ekzaltoi tifozërinë që në ndeshjen e parë, sigurisht dhe surpriza e sezonit, ishte ardhja e aktorit të humorit, Besart Kallaku, i njohur si Gjini i Portokallisë. Por të paqarta mbeten arsyet e largimit të portierit Livani nga radhët e ekipit. Rrjetet sociale turbulluan ujrat, por pak nga ato që u thanë aty ishin të vërteta, siç pohon edhe trajneri i ekipit, Laçi: "Mund të jetë përfolur shumë dhe interpretuar në mënyra të ndryshme largimi i ish-portierit Livani. Unë si drejtues i ekipit e them me përgjegjësi të plotë që nuk pati asnjë arsye madhore për këtë largim. Afrimi i portierit Aga dhe konkurrenca që ndjeu, bënë Livani të fillonte të vinte kushte. Por loja kushte nuk ka. Kështu që ai pa të arsyeshëm largimin dhe ne sigurisht që respektuam vendimin e tij."

Ndeshja e parë e kampionatit u luajt në Peshkopi, kundra Sukthit dhe përfundoi me rezultatin 2-2 me gola të Merdinit dhe Xhafës. Një nisje jo e mirë kjo, pasi rivali kryesor na u afrua vetëm me dy pikë diferencë. Por ajo që gëzoi jo vetëm 5 mijë tifozët që ishin të pranishëm në stadium, ishte vendimi i Komisionit të Disiplinës në mesjavë, i cili dha vendimin e fitores së Korabit në tavolinë, me rezultatin 3-0 për shkak të një gabimi teknik që iu gjet Sukthit. Bëhej fjalë për një lojtar të pafederuar, i cili luajti gjatë gjithë ndeshjes.

Por rikuperimi i rezultatit erdhi menjëherë pas barazimit në fitoren e radhës kundra Shënkollit, me rezultatin 0-2 me golat e Karajt dhe Melanit.

"Ndiheshim borxhlinj ndaj tifozërisë që nuk na ka tradhëtuar asnjë moment, madje në ndeshjet në transfertë ka patur raste kur ka qenë më e madhe në numër se tifozëria vendase. Gjej rastin t'i falënderoj nga zemra lojtarët, që janë treguar të gatshëm, pavarësisht çdo vështirësie, përfshirë kushtet klimaterike, pasi duhet theksuar që tashmë ka nisur stërvitja intensive me dy seanca stërvitore në ditë, si dhe kushtet ekomomike që dihet si janë", thotë traineri i Korabit, Erblin Laçi.

Trajneri gjen rastin të falenderojë edhe z. Naim Agolli, si dhe të gjithë dibranët që jetojnë në Brooklyn, për ndihmën e madh financiare dhe për gadishmërinë që treguan për të stimuluar financiarisht ekipin.

"Aktorët kryesorë që kanë bërë që ekipi të arrijë rezultatet e deritanishme me 14 fitore dhe një barazim, me 22 gola të shënuar dhe vetëm 3 të pësuar, janë dy kolegët e mi, ikona të futbollit dibran, Shpëtim Toska dhe Telman Përleka", thotë Laçi, i cili gjen rast të shprehë mirënjohjen edhe për drejtorin e ekipit Sokol Muho dhe presidentin Femi Mziu.

"Janë të gjithë këto elementë, që të mbledhura bashku si një masë kompakte, do ta çojnë Korabin drejt titullit kampion" tha trajneri Erblin Laçi për gazetën "Rruga e Arbërit".



Dibrani Duka, më i miri i Montrealit

Futbollisti nga Dibra e Madhe, Dilaver Dilly Duka, ka zhvilluara një nga takimet më të bukura të tij për Kupën e Kampionve për Amerikën Veriore - . Në këtë takim ai jo vetëm që shënoi dy herë ndaj ekipit meksikan, Pachuca, por u dallua, simbas vlerismeve dhe si një mesfushor potencial dhe mjeshtër.

Duka, shkruajn gazetat sportive, bëri lojë të mahnitëshme, duke e konkretizuar atë teksa realizoi dy gola për ekipin kanadez - Montreal, ekip ky që bën pjesë në garat për ligën e parë amerikane, të futbollit europian - Major Soccer League. FC Montreal, si mysafir megjithse dy herë shënuan të parët, nuk arritën fitore mbasi meksikanët e Pachukës, barazuan me rezultat 2 me 2, ndërsa dibrani Duka, ishte në nivelin më të lartë të mundshme, duke shënuar të dy golat, përkatësisht në minutën e 25-të pjesës së parë dhe të 53-të, të pjesës së dytë.

Golin e parë, ai e shënoi pas një veprimit të bukur personal, me një gjuajtje standart nga rreth 16 metra, duke e "shastisur" portierin vendas, ndërsa të dytin nga afërsia, kur e ngjiti në epërsi ekipin e tij në 2 me 0. Golat e shqiptarit, për ngjyrat e ekipit blu të FC Montreal - i japin shpres ekipit kanadez, që ai të shkojë drejt gjysmëfinales së së Kupës së Kampionve të të Amerikës së Veriut, mbasi takimi i kthimit luhet në Montreal - Kanada.

25-vjeçari, Duka, i lindur në Dibër të Madhe, ka luajtur me disa ekipe të MSL dhe ka pasur një sukses të dalluar. Ai është me pasaportë amerikane, në të kaluarën ka përfaqësuar kombëtaren U-20 dhe U-23 të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe skuadrën olimpike, duke shënuar dhe një super-gol në Egjypt, kohë kur ai ka qenë pretendet, serioz për të veshur edhe ngjyrat e ekipit kombëtar të SHBA.

Nju Jork: Korabi feston

Klubi i Futbollit Korabi, nga Nju Jorku, një nga më të vjetrit dhe mjaft të suksesshëm në aktivitetet sportive shqiptaro amerikane dhe nivel lokal – në zonë e Tri-Shtetshit, në ditën më romantike të vitit, Shën Valentinit, ka festuar duke e kombinuar atë me festën kushtuar Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës – 17 Shkurtin 2008. Futbollistët e Korabit, drejtuesit e saj, së bashku me anëtarët e familjeve të tyre, dhjetëra simpatizantë dhe mbështetës të këtij klubi futbollistik, dhe veprimtar të dalluar të komunitetit dibran, u argëtuan për disa orë, nën ritmin e bukur të këngëve dhe valleve popullore, dhe muzikës së lehtë për dashurinë. Të pranishëmit, në emër të kryesisë dhe në emër të kyetarit të ri – të KF – Korabi, z Zeqir Papraniku,i ka përshëndetur me një fjalë rasti, drejtuesi i kësaj mbrëmje zoti Përparim Papraniku.

Futbollisti i njohur i këtij klubi, Kujtim Kaziu, ndërsa urojë festën – ditën më romantike të vitit, Shën Valentinit, me këtë rast në emër të KF Korabi – dorëzojë, edhe atë që ai e quajti edhe supriza e rradhës, – Kupën e "artë", një dhurat simbolike, kjo që iu dha ish kryetarit të KF Korabi, zotëri Murat Mela , për të nderuar veteranin e organizatorin , ish kryetarin e suksesshëm prej 18 vitesh, tha Kaziu. Udhëheqësi i kësaj mbrëmje festive më pas ka faleminderuar edhe organizatorët e kësaj mbrëmje Agim Fishta, Fatin Papraniku, Nehat Kerkuti, Fisnik Daci dhe krye organizatorin Ekuran Marke.Pjesëmarrësit u argëtuan nga muzika e Grupit muzikor Alba me drejtues Edi Xhanin, – duke përfshirë sopranon Dëshira Ahmeti – Kerliu, dhe këngëtarin e njohur Arian Kerliu, Lundrim Paçuku dhe Mustafa (Faje) Cami.

Beqir Sina

Festohet 50 vjetori i krijimit të sport-klub "Bulqiza"



18 shkurti ka mbetur tradicionalisht ditë feste për Bulqizën dhe bulqizakët. Kjo pasi më 18 shkurt të vitit 1948 u bë shpërthimi i parë i minave që lajmëruan hapjen e minierës së Bulqizës. Ndaj kjo ka qenë edhe arsyeja që me këtë datë qyteza e minatore "pagëzoi" shumë evente të rëndësishme të saj, duke mos e lënë atë vetëm të lidhur me minierën

Kështu, me këtë datë u emërtua edhe ngritja e ekipit të futbollit para 50 vitesh, i cili u quajt "18 shkurti", për të vijuar me pluralizmin e pas '90-tës, ku 18 shkurti 1991është edhe ditëlindja e Degës së PD-së Bulqizë.

Më 18 shkurti i vitit 1955 u krijua KS Bulqiza. Dhe natyrisht që 18 shkurti i këtij viti, nuk mund të kalohej në heshtje pasi përkonte me jubileun e 50 vjetorit të krijimit të ekipit të futbollit. Me këtë rast, Bashkia Bulqizë dhe FK Bulqiza, kanë organizuar një ceremoni festive, të ideuar nga legjenda dibrane e sportit të mundjes, mjeshtri i këtij sporti, Xhelil Cibaku.

Ceremonia është zhvilluar në sallën e shfaqjeve të Qendrës Kulturore Bulqizë. Në këtë ceremoni morën pjesë ish futbollistë dhe trajnerë të ekipit të futbollit "18 shkurti", drejtues dhe futbollistë aktual të FK Bulqiza, kryetari i bashkisë Bulqizë Myfit Duriçi, deputeti i zonës Përparim Spahiu, si dhe qytetarë e sportdashës të moshave e gjinive të ndryshme, etj.

Me këtë rast, në hollin e sallës së shfaqjeve ishte hapur edhe një ekspozitë me fotografi dhe emra të sportistëve të Bulqizës ndër vite, e cila u vizitua nga të pranishmit duke ngjallur shume nostalgji, emocione dhe kujtime te bukura për ta.

Takimi ishte ndërtuar në formën e spektaklit nga moderatori dhe gazetari sportiv Defrim Methasani dhe ideatori i takimit Xhelil Cibaku.

Përshëndeti me këtë rast të pranishmit kryetari i Bashkisë Myfit Duriçi, i cili premtoi se do të jetë në mbështetje të ekipit të FKBulqizës, që futbolli bulqizak të ngrihet në lartësinë që meriton. Më pas në skenë për të përshëndetur u ftua bashkëshortja e ish trajnerit të parë të ekipit, themeluesit te sport-klub Bulqizës, të ndjerit Sabri Abdiu, ish mësuesja e nderuar e qytetit të Bulqizës, Aida Abdiu. Përshëndeti në këtë takim edhe Presidenti aktual i FK Bulqizës, Shkëlqim Llagaçi.

Më pas ceremonia ka vijuar me shpërndarjen e certifikatave të mirënjohjes për ish trajnerë dhe futbollistë ndër vite, që ngjallën mjaft emocione për të pranishmit, të shoqëruara me duartrokitje të zjarrta.

Në këtë event festiv jubilar të sportit të futbollit në Bulizë, u dekorua nga ana e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Bulqizë, me titullin e lartë "Nderi i Qytetit", krenaria e Bulqizës, kampioni i Europës në sportin e Boxit, Xhetan Keta.

Hysen Likdisha

Rruga e Arbërit nr. 106

Dy historitë e shkruara mbi krahinën e Çidhnës... janë një ndërmarrje e fuqishme... ato kanë plotësuar një boshllëk të madh historik, iu kanë dhëne në duar brezave të sotëm e të se ardhmes materiale e dokumente njohje të një rëndësie shume të madhe...

recensë

Historia e Çidhnës përmes dy studimeve

Nga **SELMAN MËZIU**

(vijon nga numri i kaluar)

Duke qëmtuar në histori shkrues të tjerë dhe arkeolog, kemi gjetur vlerësime e përshkrime gjeografike e historike të këtyre kalave në mënyra të ndryshme dhe ja:

"Të dhënat e fundit arkeologjike i përkasin fillimit të shekullit të XIV-XVm.kr.(mbas krishtit) periudhë kur ishin të formuar dhe ishin fuqizuar principatat feudale. Zona e Çidhnës së poshtme përfshihej në principatën e Kastriotëve, e njohur në historinë tonë mesjetare. Kështjella e Skënderbeut ose e Çidhnës, në lartësinë perëndimore të Çidhnës së Poshtme i përket pikërisht kësaj periudhe."- ka shkruar arkeologu A. Bunguri f.*(17)*

Dhe ja një mozaik tjetër vlerësimi e përshkrimi të kësaj kalaje nga H.Sadiku dhe Myslim Koka: *"Në vendin e quajtur "Shehu i thatë" i katundit Çidhën e poshtme të Dibrës, ndodhen rrënojat e një kalaje mesjetare, që populli i fshatrave përqark quan "Kalaja e Skënderbeut." Kjo kala ndodhet ndërmjet Qidhnës së Poshtme Gurë –Lures dhe Sinjës në një vend shumë të thyer dhe të veçuar, plotë shkëmbinjë të pjerrët dhe të zhveshur...." f. (199) (8)*

Duke gjykuar me kujdes dhe sipas profesioneve, vlerave të studimeve, kohështrirjes së kryerjes së tyre, vetëvetishëm lind pyetja: Kujt periudhe historike ndërtimi e përdorimi i përket kjo kështjellë?

5. KASTRIOTËT

Do të citojmë pjesë të ndryshme nga dy studimet:"Çidhna, dje sot nesër." të Islam Canit dhe "Historia e Çidhnës'' të Haki Përnezhës. Nëpërmjet pjesëve të shkëputura nga këto studime, do të nxjerrim përfundime ose do të pyesim se si është zhvilluar kjo apo ajo ngjarje etj.

a) Origjina

I pari shkrues na jep origjinën e Kastriotëve nga lagjia Biz, pra Çidhna e Poshtme dhe ja se si e ndërton hipotezën e tij: *"Sipas të dhënave që herët në krahinën tonë, që mund të përkojë me kohën e bizantëve, është njohur fisi i Dukallarëve si një nga fiset më të pasur me toka e zotërime, me poste në qeverisjen bizantine si ushtark e luftëtarë, drejtues të zotë. Ajo që mbështet dhe ekzistencën e tyre gati në fillimet e epokës së reishte se njiheshin si fisëi vjetër profesionistësh, zejtarësh e ndërtuesish. Vetë duka ishte administrator i qytetit.* ***Duka*** *në pozicione të tilla drejtimi, thuhej se qëndronte afër me fisin e Kastriotëve, ndoshta pse ishin fqinjë, apo kishin ndonjë lidhje kumarëlleku, por nuk përjashtojmë mundësinë që mund të kenë patur edhe lidhje gjaku. Ky fis si drejtues të zote, si zejtarë e ndërtues jo vetëm në krahinë por deri në jug të vendit siç duket bënë ndryshimin e mbiemrit vone në mesjete* ***KASRIOTË." (f. 120)***

Histori shkruesi Përnezha tregohet më modest, dhe arsyeton duke marrë si të vërtet:*''....për ne, është punimi dhe mendimi Prof. Kristo Frasheri, i cili argumenton se Kastriotët ishin nga AZ-Has-i i Dibres së poshtme. (Në zonën tonë, në lagjen Sule gjëndet toponimi Arët Has me një sipërfaqe 1 ha.) f. 18*

Duke gjykuar mbi mendimet e shkruara më sipër nga të dy historinët natyrshëm lindin pyetjet:

Kanë prejardhjen nga **Duket** e Bizës, apo ishin dy fise njëkohësisht?

Kastriotët ishin me të vërtet nga AZ-Has-i i Dibrës së poshtme, Kastrioti apo....?

Po fisi bujar i Mazrekaseve a kishte lidhje me Kastrotët apo studimet e shkruara, pothuajse pesë shekullore janë të gënjeshtërta??

Ti hedhim një vështrim Sinës si treva më e rëndësishme e veprimtarisë, familjare, politiko-shoqërore dhe fetare e familjes së Kastriotëve, duke përdorur pjesë të ndryshme të dy studiuesve: *"Gjon Kastrioti banonte në Sine-* shkruan I.Cani,*- por ai kishte dhe kështjellë (kullë) në Kastriot, vendbanim në kështjellën e Varoshit në Gurin e Bardhe dhe në Krujë, pra shihet qartë se banonte sipas situatave herë në Sinë të Çidhnës e here në Kastriot e gjetke." f.(123-124)*

Më tej i njëjti autor vazhdon: *"Nga kepi i Harlecit vjen pjesa e Sinës së poshtme.....Me pas në rrafsh sipër ku sot është muzeu i Skënderbeut, janë disa dynym tokëku janë vendosur disa fisesi Prifti, Tafa, Kaloshi, në ketë fushë ka qenë një kishë në trojet e Demir Sulë Priftit." f.(220)*

Kurse në materialin e tijë studimor kushtuar Kastriotëve H.Pernezha do të shprehet: *"Nëse është pranuar se Kryetrimi erdhi në Dibër të poshtme, atëherë ai ka qenë në trojet e veta ne Kastriot, në Çidhën. Edhe O.Shmid pohon se: "Kastrioti i sillte luftëtarët e tij në vend të sigurt në Çidhën, fshati i prejardhjes së familjes së tijë, veç pak kilometra nga Valikardhi në një vijë të drejte nga veriu. Katundi Sinë ndodhet mbi një rrafshinë të gjerë në 1529 m. lartësi, rreth 1000 metër mbi luginën e Drinit të Zi aty pranë, aty mund të vihej vetëm nga monopate të thikta." f.(23)*

Nga sa me sipër mund të rrjedhin keto pyetje:

1- Valikardha e Sina kanë një distancë **pak kilometra** njëri nga tjetri? Duke e matur në hartën fizike asht së paku 35 km në vijë ajrore.

2- Fshati Sinë ndodhet në një rrafshinë të gjere... apo disa dynymshe? Janë një apo dy Sinja sipas Shmidit?

3- Sa është lartësia mbi nivelin e detit 1529 m.? Fatkeqësisht autori në fjalë na çon Sinën e tij në vargmalin e Runjës" në Majen e Gjatë në 1524 m lartësi (11)

4- Aty mund të vihej vetëm nga monopate të thikta, në fakt asht e kundërta. Ku jane atio vallë?

5- Distanca nga lugina e Drinit të Zi 1000 metra, në fakt nga matjet në hartën topografike - fizike është mbi tre kilometra. Ku e mori Shmidi këtë matje?

6- A nuk duhej të reflektonte thellë mbi këtë pjesë të shkruar të Shmidit Studiuesi Përnezha përpara se t'a përdorte si ilustrime të ideve të tija që kërkonte të shprehte?

6. MARTESA E SKËNDERBEUT

Studiuesi në fjalë (H.Përnezha) kërkon të ndërtoi fakte e ide të ndryshme për këtë çështje e cila asht sa delikate aq edhe jo shumë e qartë në disa zhvillime të saja.

"Martesa e tijë (Skënderbeut S.M.) u pagëzua në kishën e Shën Triadhës, në Manastirin e Adrenicës....."- Shkruan autori i "Krahinës së Çidhnës"

Por ai nuk na jep burimet se ku i mori këto informacione, pra ato janë të dyshimta. Ne morëm përsipër të japim disa pjesë studimesh mbi këtë çështje. Dhe ja:

Se pari po shkëpusim një të dhënë të shkurtër nga "Udhëzuesi turistik Italian mbi Shqipërinë të hartuar nën drejtimin e Profesor Pirro Markoni e më pas nga Profesor Sestilo Montaneli ku shkruhet : *"Brënda asaj Kalaje (**KANINËS-** Vlorë. S.M.) më 1451, Skënderbeu bëri martesën me Marina (emri i Nenës S.M.) Donika, e bija e kështjelltarit Gjergj Aranitit." (12)*

Burimet historike shqiptare dhe studiuesit duhet të hedhin dritë mbi këtë çështje shumë të rëndësishme te jetës së heroit tonë kombëtar Skënderbeut. Po i anashkalojmë sadopak kësaj çështje.

"Legjendat dhe Gojëdhënat për martesën e Skënderbeut në Kaninë kanë mbetur të gjalla edhe sot në rajonin e Vlorës. Njëra prej tyre e ruajtur në Himarë e cila ishte zotrim i Gjergj Aranitit thotë se: "Ditën e Dasmës në Kaninë shkuan edhe kapedanët e himarës me peshqeshe për çiftin. Ata e shoqëruan nusen deri në Krujë"(Akademia e Shkencave. Epika Historike, I Tiranë1983 fq. 183). Ndërkohë që në Qishbardhe dhe Penkovë (Vlorë), ruhen katër toponime të tilla si: Qisha e Skënderbeut, Krapi i Skënderbeut, Vau i Skënderbeut, dhe Ara e Skënderbeut, dëshmi të shekullit të XV. Kujtesa popullore çuditërisht hesht vetëm për Ardenicën!?. Atje ku u kurorëzua vërtet heroi! (13)

Historishkruesi i jetës së Kastriotit Marin Barleti (viti 1508) nuk na jep me saktësi se ku u zhvillua dasma dhe ku u vendos kurora. Dhe të lexojmë vetëm një fraze *"Skënderbeu nuk e vonoi dasmën, por e mori menjëherë gruan në shtëpi dhe e ndau gëzimin e zakonshme popullin." (14)*

Ja se si shkruan Francezi Edvin Zhak cili banoi për tetë vjet në Korçë: *"Gjatë një intervali te lumtur midis fushatave të pandërprera ushtarke, më 26 prill 1451, në katredalen e Krujës, u bë martesa e Skënderbeut, tridhjetë e nëntë vjeçar me Marina Andronikën. Ajo ishte bija njëzetë e tre vjeçare e heroit Arianit Komnen Topia, princi më i fuqishëm në Shqipëri, pas Skënderbeut, dhe i pari që i dha besën, ushtarët dhe pasurinë e tij për lirinë e Shqipërisë." (15)*

Me sa duket historia e heroit tonë kombëtar ka akoma "etje " për fakte të reja, për argumente ende edhe më të shumta për të plotësuar mozaikun historik të jetës së tij të fshehur mjerisht në tallazet e turbullta të shekullit të pesëmbëdhjetë.

7. LUFTËRAT KUNDËR SUNDIMIT TURK DHE SERB, PJESËMARRJA E ÇIDHNAKËVE.

Mbi këto ngjarje në Dibrën e poshtme asht shkruajtur shumë pak, tani për tani i bashkohet kësaj edhe Dr. Islam Cani, i cili nuk i trajton këto periudha ndërsa studiuesi Haki Përnezha, ka punuar jo vetëm me një përgjegjësi të admirueshme historike, por edhe duke përdorur një material të bollshëm ilustrues e dokumentar.

Duke hedhur dritë njohje mbi kundërshtitë e Hakik Pashe Hoxhollit dhe të Ali Pashë Tepelenës, studiuesi shkruan edhe mbi betejën e Marovishtes së Strugës ku dhanë jetën 15 çidhnakë, ngjarje eviteve 1770. Ndër të tjera ai thekson: *"Ai (Ali Pashe Tepelena S.M.) ia arriti të "thithë" në radhët e ushtrisë së tijë shumë dibran, kryesisht çidhnakë, rreth 60 burra të udhëhequr nga Stafë Lusha e Brahim Kaloshi, të cilët u rreshtuan me Gardën e Ali Pashës." (f.52)*

Demir Lusha rritet dhe edukohet nga mosha 10 vjeçare deri ne 17 vjeç në oborrin e Ali Pashë Tepelenës. Me parat dhuratë prej tije ai ndërtoi Urën e Lushës mbi Drin. Në diskutimin me Vezirin e Shkodrës, ja se si u njohën: *"Zanin ta kisha dëgjuar por më mirë mos të kisha njohur. Demiri e ndjeu veten pak të ofenduar, pasi vërtet nuk ishte kaq i hijshëm, por kjo nuk do të thoshte që ai të bëhej objekt talljeje. Për këtë arsye ai ndërhyri i revoltuar: Në shan veshjen, shan terzinë, në shan dukën (pamjen), shan perëndinë; në shan marifetin(sjelljen), unë jam Demir Lusha."(f.58)*

Nuk mund të marrim përsipër të trajtojmë në këtë shkrim gjithë trimat e pushkës dhe mendjet e zgjuara të krahinës së Çidhnës të trajtuar nga studiuesi Përnezha, sepse nuk përbën objektin e tij, si dhe nuk e lejon zhanri publicistik që kemi zgjedhur, prandaj shumicën do ti kalojmë përciptas.

Kanuni i Has Përnezhës dhe trimëria e djelmënisë se Çidhnës e cila kurorëzohet me trimërinë e djaloshit të ri Dedë Priftit nga Sina e Poshtme, ndiqet me trimërinë e Sali Nokës më 1832. Nëpërmjet fakteve, si dhe dokumenteve të kohës në arshiva, bisedave me të moshuarit, vargjeve të këngëve popullore, përshkruhet beteja e Çidhnës e vitit1833 e udhëhequr nga Sali Noka,Vesel Lusha, Ali Tafa (Alia), e më tej trajtohet, trimëria dhe zgjuarsia e Tafë Tolës, me Haxhi Pashe Skatin (Zogollin S.M.) të Matit. Zgjuarsia dhe trimëria e pashoqe e Sali Demirit (Alia) dhe e Llan Kaloshit në Grykën e Radikës dhe në Fushë të Gjoricës kundër ushtrisë gjakatare të Hajredin Pashës janë faqe të ndritura në historinë çidhnake.

Zgjuarsia e Sulë Kacanit, trimeria e Hasan Shinit dhe Abaz Repës, urtësia dhe maturia e Dedë Skepit, janë trajtuar me kujdes me përshkrime e fakte konkrtete nga historiani Përnezha.

Trimëritë spartane dhe pjesëmarrja në betejat e panumërta, kundër pushtuesit më gjakatar e më vrasësit barbar, serbëve, është pjesa me e arritun e studuesit Haki Përnezha.

"Në mes të këtyre burrave (4000 vullnetarëve dibranS.M.) ishin edhe mbi 1000 Çidhnakë, të cilët të udhëhequr ngaSelman Alia,Llan Kaloshi, e Shaban Lusha u rrrjeshtuan në këtë ushtri (në ndihmë të Shkodrës, tetor 1912)." (f.105)

Me koloritë shprehjesh dhe fakte përshkruhet lufta e Bërdicës e 9Shkurtit 1913. *"Trimi Shaban Lusha, del nga istikami dhe pasi shkatërron gardhin serb të telit me gjëmba, si shqiponjë hidhet mbi pozicionet e armikut, duke u përleshur fyt për fyt me malazezët."(f.107)*

Dhe më tej histori shkruesi vazhdon*: "Nëmes të Muhurrakëve pjesëmarrës në ketë luftë, nga Shorokani ishte edhe një burrë në gjysme të moshës.....Ky ishte Ismail Dede Ballazhi.....Ai kishte mbetur shehit per tu kujtuar në shekuj thuhet në popull." (f.108)* Përshkruhet me shumë realizëm mbetja e tij në këmbë edhe pse plumbi e kishte goditur për vdekje, por gabohet kur shkruan nga Shorokani, në fakt ai ishte nga Shqathi. Djali i Dedë Ballazhit i cili projektoi dhe ndërtoi udhën këmbësore të Xhutezës dhe projektoi vijën e ujit dhe ndërtoi mullirin e parë në krahinën e Muhurrit pikërisht në përruan e Shqathit, dhe u quaj mulliri i Palamatit. Duhet të ishte afërsisht viti 1850.(16)

Luftimet e gjysmës së dytë të Gushtit të vitit 1920, janë ndodhitë nga më dramatiket. Trajtojmë atë Sallbastrës, të cilën, historiani Përnezha e përshkruan kështu: *"Gryka e mitralozit pushoi dhe fushasit, që ishin vetëm dhjetë metra më poshtë, hidhen mbi istikam dhe aty gjejnë trupin e Osmanit (Osman Tahir Paci S.M.), mbi grykën e mitralozit, i bërë shoshë nga plumbat e shumtë që kishte marrë në bark."(f.145)*

Një pjesë mjaft emocionuese asht ajo Kushtuar Selim Alisë, rënia e këtij trimi në Kaush të Sllovës së bashku me dhjetëra të tjerë të cilëve serbi i vrau dhe iu preu edhe kokat. Disa fshatar që banonin aty pranë shkuan pas betejës dhe ua futën kokat në bark duke i qepur ato. I varrosën, dhe pasi trupat serbe u larguan familiarët morën trupat e pjesëtarëve të tyre të vrarë këtu. Ndërsa kur kufoma pa qahej: *"Njëra nga bijat e Aliajve i afrohet kufomës dhe iu drejtohet grave: - Qajeni moj motra Selim Alinë, se vërtet kokën s'e ka por zemra këtu asht- dhe me dorë qëlloi mbi kraharorin e kufomës.....Dikush hoqi çarçafin që mbulonte kufomën një zë e britme çudie u dëgjua tek të gjitha gratë. Të gjithë shtangën kur panë kokën e Selim Alisë."(f.156)* Këto shembuj, episode, ngjarje reale janë dëshmia e gjallë e trimërisë, e krenarisë e dinjitetit të luftëtarëve Dibranë, të cilët në rrokullimat e shekujve kanë shkruar me gjak e heroizëm lirinë që gëzojmë sot dhe që penat e bijve të saj të shkolluem, fatmirësisht, kane filluar t'i shkruajnë në libra.

8. DISA MENDIME DHE PROPOZIME.

Të dy historishkruesit shprehen në faqen e fundit të punimeve të tyre historike: *"Duke mbyllur këtë punim, besoj se gjithë këto që u përmendën, kanë qenë në vëmendjen tonë për t'i sjellë e paraqitur ashtu siç janë. Shpresoi që t'ia kem arritur."* shkruan në mbyllje Përnezha (f.358)

Kurse Zoti Cani shprehet:*''Jeta ime, vëzhguese mbi Çidhnën si bir i saj, për të cilën kam punuar me shpirt, që këtë punë ta kthej në një studim, le të mbetet në dorë të tjerëve që ta gjykojnë."(f.270)*

Si në gjykimin e veprave të artit, muzikë, pikturë, skulpture, veprave letrare, ka vlerësime objektive e subjektive, deri në një farë shkalle kjo asht e vlefshme edhe për studimet historike, prandaj si më sipër po shkruajmë:

1- Stili i të shkruarit të Dr.Canit, asht lirik, me përshkrime peisazhesh e faktesh qe vijnë në "oreksin" e lexuesit, qetësisht, pa zhurmë, por mendjesi të hollë dhe që të mësojnë se si mund ta zgjedhësh këtë mënyrë të paraqituri të materialit studimor historik kur fillon të shkruash një të tillë.

2- E kundërta ndodh me studiuesin Përnezha, i cil asht me të vërtet i skalionit epik, i prerë, i kursyer në figura, por serioz, me fjalë e shprehje të burimeve historike e popullore, të cilat iu shkojnë më për shtat studimeve historike.

3- Në organizimin e materialit, studiuesi Cani, ka zgjedhur, paraqitjen gjeografike të krahinës së Çidhnës të gërshetuar me natyrën me gjithë kompleksin e saj, duke i mëshuar shpendit oena,si emërantik i Çidhnës e deri tek pëllumbi e shqiponja.

4- Ndërsa studiuesi Përnezha e ka neglizhuar gjeografinë si shkencë e si emërtim dhe si i thonë asht hedhun në thela. Pra në periudhat historike, duke i lamun pak vend periudhës se neolitit, antikitetit, romak, ilirik, dhe trajton me së miri atë turke, serbe, arsimimin, etnografinë e krahinës etj. Dhe këto përpiqet t'i sqarojë në kapitujt e fundit kur studion fiset me gjithë kompleksin organizativ të tyre.

5- Në redaktimin e materialit të shkruar, në pikëpamjen morfologjike, ndërtimit të fjalive, frazave, gabimeve ortografike asht treguar më i vëmendshëm, Dr, Fejzulla Gjabri, ndërsa lenë për të dëshiruar shkrimtari Namik Selmani tek studimi i Dr Canit.

6- Në përdorimin e burimeve bibliografike, studimeve, Dr. Cani duhet të ishte treguar më i saktë e në vend që të falënderoi autorët e studimeve ku ai asht mbështetur të kishte futur në materialin e tij, thëniet e tyre argumentet, faktet e tyre. Ndërsa studiuesi Përnezha asht me i sakte dhe i prerë, edhe pse nuk i kanë munguar përsëritja e argumenteve të tyre disa herë.

Ngjarjet e shumta, heronjtë e mentarët Çidhnak të paraqitur nga këto dy studime janë të shumtë ne ujëvarat e shekujve, dhe autorët e mësipërm kanë skalitur me shkronja veprën e tyre duke ua bërë të njohur, banorëve të këtyre trevave, brezave që do të vijnë, pse jo, historianëve, etnografëve, sociologëve, gjeografëve për t'i përdorur në studimet e tyre, por vështrimin duhet ta hedhim edhe në një drejtim tjetër: **Materializimin në vendngjarjet me anë të pllakatave, busteve, përmendoreve lapidarëve etj si kujtesë per brezat e tanishëm dhe të së ardhmes për këto ngjarje e heronj, si dhe në shenjë respekti e mirënjohje.**

Është në nderin e drejtuesve të komunave që të gjejnë investime për ndërtimin e disa veprave përkujtimore, p.sh.

1- Tek Kepi i Qitetit, të vihet një pllakatë mbi luftën legjendare të banorëve të Oenasë kundër Perseut të Maqedonas në vitin 169 p.k.

2- Në Arras një e tillë për Kuvendin e Qeverisë të Arrasit më 13 Gusht 1920

3- Në Lanë Lurë një pllakat duhet vendosur, ku të shkruhet mbi betejën e stuhishme të nëntorit 1921.

4- Shtatore kushtuar trimit Osman Tahir Pacit ne Sallabastër, dhe lapidar ne kodrën e Shkerkës

5- Pllakate kushtuar të rënëve me në krye Selim Aline në Tetor 1913 Ne luftën kundra Serbit në Kaush të Sllovës.

6- Në njërën nga Lendinat e Ferrës së Pashës të ngrihet një pëmendore ku të shkruhen datat e vitet e kuvendeve të mbledhura këtu që nga koha e Skënderbeut e deri në vitin 1944 siç shkruan historiani Përnezha (sipërfaqja asht nga 10 ha (f.23) në 15 ha (f. 24)

Dy historitë e shkruara njëkohësisht mbi krahinën e Çidhnës, si për nga shtrirja gjeografike edhe për nga hapësira kohora, janë një ndërmarrje e fuqishme, shumë e vështire, por megjithatë ato kanë plotësuar një boshllëk të madh historik, iu kanë dhëne në duar brezave të sotëm e të se ardhmes materiale e dokumente njohje të një rëndësie shume të madhe njohëse, edukuese, krenarie dhe materiale e dëshmi për të vazhduar kërkimet historike dhe etnografike edhe me tej për këtë krahinë.

Firence 12.01.2013

BURIMET E PËRDORURA

9. Hilmi Sadiku, Myslim Koka Kalaja e Skënderbeut (e Qidhnës) në Dibrës . Dibra 1969 Almanak n. 1
10. Ali Hoxha Defteri emror- i vilajetit të Dibrës i vitit 1467dhe disa mendime rreth vlerës së tijë historike. Në: Dibra dhe Dibranët. f. 58-73 Shkodër 1985
11. Harta fizike, Shtabi i përgjithshëm, K-34-77-D-c (Fushë Muhurr) përgatitur ne vitin 1982, Botuar më 1985.
12. Guida D'Italia della consociazione turistica italiana Albania f. 194 Roma 1940
13. Ilirjan Gjika "Martesa e Skenderbeut" f. 28 Rrënjët (Le Radici) Anno 10 N. 3. Luglio 2012
14. Marin Barleti Historia e Skënderbeut f.384 Tiranë 1983
15. Edwin Jacques. Shqiptarët. Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme. Tiranë 1998
16. Bajram H. Mani. Biseduar në Gusht 2012 (Arshiva S.Meziu)

portret

... në betejat e tyre janë shumë të mprehtë, janë fodullë në pushkë dhe veshje,
janë të matur, por edhe të hasdisur po t'i preksh në sedër.

Shefqet Xhika – çidhnaku i provave të diturisë

Nga **MEVLUD BUCI**

Sigurisht dituria është gjëja më e çmuar, pasuria më e rrallë në jetë. Çidhnakët e urtësisë, ky popull vital i shquar në shekuj e brezni për diturinë me të drejtë në vallet e odave quhen "mali i mendjes", gjë të cilën e thonë ngado në Dibër e më gjerë. Është vërtetë me fat sikur ka lindur me këmishë ai që ka lindur apo lind në trevën e Çidhnës, në këtë vend ku tek çdo njeri, tek çdo kullë a mjedis shoqëror duket sikur urtësia, dituria bleron si bari, pasohet nga brezi në brez, nga më i vjetri tek më të rinjtë nëpër vite e kohëra. Pa dashur të marr rolin e historianit, por bazuar në të vërtetat e dëshmitë e qëndresës theksojmë se treva e Çidhnës është vendi i Kastriotëve i lindjes së Gjergj Kastriotit (Skënderbeut) vendi i sheshbetejave dhe i martirizimit për lirinë kombëtare. Trimëria dhe mençuria janë dy "shina" të çidhnakëve. Ndërsa mendoj e gjurmoj për intelektualin e shquar, birin e Çidhnës Shefqet Dali Xhika ndërmend më vijnë plot të urtë popullorë si Taf Kola, Mane Kacani, Sefedin Doçi, Selim Leshi, Sulë Dika, Bajram Skura, Mudë Hasi, Sheh Ismaili e plot të tjerë. Të gdhendur në kujtesën e brezave janë edhe filozofi e shkrimtari Xhafer Martini, studiuesi e udhërrëfyesi i besimit hyjnor myftiu Ali Adem Hoxha, doktori e studiuesi virtuoz Islam Cani, studiuesi e historiani i përkushtuar Mustafa Tola, Gjeneralët Hysen Repa e Dilaver Laçi, shkencëtari e gjinekologu i shquar Rahim Xhika, deputetët e nderuar të parlamentit shqiptar, bijtë çidhnakë Shkëlqim Islam Cani e Rakip Bajram Suli, ish poeti i talentuar Maliq Bitri i shquari Enver Mehmet Kaloshi, shkrimtarët Miftar e Hamit Mena, Dali Tërshalla, poeti emigrant Ilir Spata, poetesha dhe ish luftëtarja për lirinë e Kosovës bija e Renxit Rajmonda Bujar Maleçka, ish deputeti dhe piktori i talentuar Uzri Ramadan Hoxha, gazetari i ndritur i sportit kombëtar Defrim Shuaip Methasani, mjeshtri i madh i letërsisë, i talentuari Agron Isuf Tufa, studiuesi Qeram Bexhet Cibaku, i paharruari Hasan Tasimi i kohës së re Prof. Dr. Nuri Abdiu, vëllezërit e nderuar e human Muhamet e Rushit Bitri, Shaban e Rruzhdi Bitri, Vesel, Munir, Abaz e Uzri Hoxha, avokati Muhamed Adem Hoxha, poeti lirik dhe publicisti i nderuar Mentor Hoxha e plot të tjerë... Njerëz të thjeshtë, bij të djersës, të diturisë e të bujarisë, breza të shquar me prova të vërteta diturie. Trimi matet në pritë, i drejti matet në pozitë kështu thonët çidhnakët. Dituria të dhuron mirësi dhe dritë përparimi e jete. Përmetari, prof. Flamur Dalipi që jep elektronikën në shkollën e mesme "Gjergji Canso" në Tiranë thotë: I kam miq për kokë çidhnakët, nëpërmjet Fatmir Xhikës, njoh çidhnakët e vërtetë. Desha me gjithë zemër të mësoja çiftelinë që t'u këndoja një këngë çidhnakëve dibranëve. Ndërkohë përmetari fisnik improvizon lëvizjet sikur i bie çiftelisë dhe nis e këndon me zjarr krenarie këngën hymn të trimërisë:

... Hajredin Pasha po vjen Radikës
Vallë ku janë o malet e Dibrës...
... Hajredin Pasha o ni hutaq
S'rrifet Dibra Pashë me garbaç
Hajredin Pasha ku t'ka mbet ati
M'u në Dibër m'ka mbet i ngrati
Hajredin Pasha or kraje shanajk
Nuk asht Dibra, Pashë, Selanajk
Hajredin Pasha ku e lae ushtrinë



Tanë në Dibër o m;i kanë gri
Jo ma pak o sa dymbëdhjetë mi...

Të pranishmit në mjedisin e një lulishteje në Tiranë të Re, shikonin dhe dëgjonin me dashamirësi përmetarin që këndonte dibrançe e për dibranët, profesorin nga treva e Frashërllinjve, i cili fliste me admirim e krenari legjitime për çidhnakët, për Xhikët e Mustafës, për dibranët. Prof. Flamur Dalipi, fill pas këngës shton me vendosmëri e guxim se gjuha angleze rrjedh nga gjuha e Dibrës, gjithë gjuhët indoevropiane kanë prejardhjen nga gjuha shqipe... Flamuri ka shkruar e recituar mjaft poezi e poema, bile në ato që ka recituar në mes të Londrës ka përshkruar edhe madhështinë e dibranëve diturinë e çidhnakëve... Për cilindo bir të Çidhnës mund të shkruhet, sepse flet urtësia, flasin provat e diturisë. Ndër ata që ka plot gjurmë e përvojë si intelektual i arsimit si mësimdhënës e drejtues shembullor është edhe biri i Mustafajt të Çidhnës, pedagogu i nderuar i letërsisë dhe estetikës së gjimnazit "Besnik Sykja" të Tiranës, Shefqet Dali Xhika.

***

Shefqet Xhika u lind, më 19 mars 1957 në fshatin Mustafaj të Çidhnës martire. Shkollimi në vendlindje në arsimin fillor, kurse atë 8-vjeçar e të mesëm i bëri në qytetin e Peshkopisë e më pas arsimin e lartë me rezultate shumë të mira në UT në fakultetin histori-filologji (gjuhë – letërsi shqipe) bënë që Shefqeti të përgatitet denjësisht për jetën. Kultura e odave, traditat e shquara të familjes e fisit Xhika, Zelli e pasioni për studime si dhe përkushtimi në profesionin e mësuesisë bënë që Shefqet Xhika të rrezatojë emër pune, prova diturie si mësimdhënës në Zall-Dardhë të Dibrës e më pas si mësues e drejtues i përkushtuar në disa shkolla të Tiranës. Provat e djersës e të fisnikërisë, provat përkrah e në ballë të shokëve, pasioni e dashuria për mësuesinë, rezultatet në mësimdhënie e edukim e në artin e drejtimit janë provat e rrezatimit të diturisë së çidhnakut Shefqet Xhika.

***

Fshati Mustafaj i Çidhnës ndodhet e saktësohet në dokumentet turke me emrin "Guri i Zi" që në vitin 1467. Kur përmend emrin Çidhën nënkupton mençuri dhe kur përmend emrin mençuri nënkupton Çidhën. Në këtë mjedis të genit të diturisë u rritën e burrëruan bijtë e fisit Xhika, brezat e trevës çidhnake, mjeshtra të vërtetë të fjalës së zgjuarsisë, njerëz fisnikë të sofrës së bujarisë e të mejdaneve të trimërisë. Është mjaft domethënëse ajo që shkruajnë Profesorët e studiuesit e nderuar Nasho Jorgaqi e Xhevat Lloshi për çidhnakët në veprën e tyre: "Antologjia e fjalës së mençur", "... në betejat e tyre janë shumë të mprehtë, janë fodullë në pushkë dhe veshje, janë të matur, por edhe të hasdisur po t'i preksh në sedër. Me një pritje të përzemërt (çidhnaku) të merr përmbrapa qoftë kur është rreziku më i madh kur le kokën... kur di me u largue ai e merr vesh në qime të hollë...".

***

Dali Halim Xhika, i ati i Shefqetit që nga tetori i vitit 1944 ka punuar e drejtuar Ndërmjarrjen e Rrugëve në Zonat Dibër e Mat. Para luftës si dhe pas saj Dali Xhika pati miq brenda e jashtë kufijve, demonstroi urtësi, bujari e intelekt të mprehtë çidhnaku, virtytet e të atit Halim Xhika, të farefisit e trevës së mençurisë së Çidhnës. Ndër miqtë e paharruar të Dali Xhikës ishin e mbeten Haxhi Bodini i Selishtës, Elez Gjoka i Vigut të Matit, Bajram e Hazis Buci të Lukanit të Katër-Grykëve (të Selishtës) Dali e Veli Totraku të Lukanit, Mane Kacani i Çidhnës e plot të tjerë. Së bashku me bijën e Premçit të Bardhaj, Reçit të besës, Xhevahire Xhikën, (Prençin), rritën dhe edukuan 9 fëmijë, secilin më të mirë e më të kulturuar se tjetrin: si Dijen (ndjesë pastë, nuk jeton më), Demirin, Shefqetin, Haxhiun, Beqirin, Bilbilin, Arbenin, Bardhokun dhe Valbonën. Nëntë fëmijë, nëntë yje të kulturës e të urtësisë, punëtorë e inteligjent, të thjeshtë e shpirtbujarë si vetë geni i kullës së Xhikës e farefisi i nderuar. Atje ku rrjedh pikon, - thonë çidhnakët. Me të vërtetë brezat e fisit Xhika, sikurse çdo kullë e fis dallohen për unitet e mençuri, për sofrën bujare e mprehtësinë e fjalës për traditat e vyera të konakut e kararet e trashëguara në mote e brezni. Tek secili mëson vlerat e virtytit. Ndër më gjurmëlënësit, të cilët shpërfaqin prova të fisnikërisë e të diturisë janë Xhetan Xhika, Ali Xhika, Prof. Dr. Rrahim Xhika, inxhinieri i talentuar i specializuar në Kinë për mekanikë Xhelal Xhika, mësuesi e drejtori i dalluar i arsimit në bazë Besim Xhika, avokati Fatmir Xhika, Ema Xhika e plot të tjerë. Gjurmë të rralla të dritës së besës e të diturisë tek kulla e Xhikës në Mustafaj të Çidhnës

Nxënës, kolegë, prindër të komunitetit drejtues të arsimit flasin me admirim për punën, taktin, shpirtin e pasionit të tij, reformator.
Faktet e përkushtimit e të mençurisë, faktet në lartësimin e dritës së arsimit dëshmojnë se Shefqet Xhika është çidhnaku i provave të diturisë.

rrezatojnë edhe miqtë si Elez e Xhelil Prençi të Bardhaj Reçit, aty ku është geni i nënë Xhevahire Xhikës (Prençit) bashkëshortes së Daliut.

***

Shefqet Dali Xhika, ky mësues e drejtues i provave të diturisë ka shëmbëllimin në sytë e mendjet e brezave e të kolegëve. Në vitin 1976 u caktua mësues në Zall-Dardhë në djepin e rrallë të këngëve e valleve në bahçen e ndritur të artistëve popullorë.

Për tre vite rresht u dallua si novator, metodist, veprimtar, por edhe si krijues, kokëfortë e antikonformist pasionant e reformator. Pas përfundimit të shërbimit ushtarak më 1979-1981 në Tiranë Shefqet Xhika, vazhdon studimet e larta për gjuhë-letërsi në Universitetin Shtetëror të Tiranës, të cilat i përfundon me rezultate të larta. Me sakrifica e përpjekje erdhi në Tiranë në vitin 1982 në lagjen 9 tek "21 dhjetori". Fillimisht Shefqeti caktohet mësues i gjuhë-letërsisë në Çerkezë-Morinë pastaj në Kamëz, Zall-Dajt, Qafë-Mollë, Krrabë, Mangull, Zall-Mner, Domje, Laknas, Lundër.

Si mësimdhënës e si drejtor shkolle (në drejtim të shkollave "Shyqyri Peza", "Gjon Buzuku", "Laknas", "Hasan Prishtina" e të tjerë u dallua si reformues e organizator, si intelektual me shpirt human e novator si drejtues i veprimit dhe i taktit, si mjeshtër i drejtimit në problemet mësimore-edukative në veprimtaritë brenda shkollës dhe ato komunitare. Kurdoherë i thjeshtë, i mprehtë, i dashur e zemërbardhë, Shefqet Xhika, flet me admirim për figura të ndritura të arsimit kryeqytetas, të cilët e kanë vlerësuar e ndihmuar siç janë ish-drejtorët e nderuar të Drejtorisë Arsimore, Luan Keta, Ana Misha, Ramazan Gjuzi, Lumturi Xhezo (Klosi) Majlinda Keta, kolegët e tij të paharruar Lutfi e Hysen Ndreu, Han Kukeli, Marita Nika, Viktor Ristani në Zall-Dardhë të Dibrës, profesorët e shkollës së mesme Reshat Kola e i paharruari Qani Përtafi, profesorët e arsimit të lartë Nasho Jorgaqi, Androkli Kostallari, Shaban Demiri, Floresha Dado, Jorgo Bulo, Ali Xhiku, poeti dhe akademiku Myzafer Xhaxhiu e plot të tjerë. Gjurmët e punës të Shefqet Xhikës flasin me gjuhën e fakteve në gati 40 vite në shërbim të arsimit e të kulturës, ata rrezatojnë tek puna me nxënësit e ndihmesa ndaj talenteve, ndaj traditave arsimore e kulturore, veçanërisht tek arti i drejtimit, tek kultura e leme, siç thonë çidhnakët.

Sikur i nxjerr nga thellësia e shpirtit emrat e nderuar të Haxhi Kazazit, Skënder Ballës, Fatos Pilkatit, Kujtim Kryeziut, Liman Dokos, Shyqyri Shkrelës, Osman Hysës etj. Me nderim të veçantë flet për drejtoreshën e përkushtuar të gjimnazit "Besnik Sykja", bijën e Skraparit Armanda Mestani, për secilin koleg të gjimnazit me të cilat dallohet në vijimësi duke e bërë shkollën qendër të rëndësishme komunitare. Janë mbi 500 emra, të gdhendur në udhët e provave të diturisë, të punës mësimdhënëse e drejtuese, të cilat Shefqet Xhika i ka skalitur në bllokun e kujtimeve. Nderimi për nxënësit e kolegët, lidhjet me komunitetin e problemet bashkëkohore e kanë bërë të respektuar, gjurmëlënës e reformator. Tashmë krahas punës si pedagog i letërsisë dhe estetikës në gjimnazin "Besnik Sykja" në kryeqytet) dallohet edhe si veprimtar, organizator, botues e studiues i palodhur i dukurive bashkëkohore. Zhvillimeve letrare e kulturore në fushën e letërsisë e më gjerë. Shefqeti është edhe prind e komunitet. Së bashku me bashkëshorten e nderuar Marjana Xhika (Shkreko), bijë e Vithkuqit dhe mbesë e Priftit të Voskopojës së Korçës rriten dhe edukuan dy djemtë: Rigertin (pedagog i italishtes) tek gjimnazi "Petro Nini Luarasi" dhe Elvisin që vazhdon arsimin e lartë për gjuhën italiane, të dy të ditur, të thjeshtë e të kulturuar, të cilët demonstrojnë urtësinë çidhnake dhe thjeshtësinë e kulturën korçare.

***

Shefqet Xhika është kualifikuar në shumë fusha e drejtime brenda e jashtë vendit. Në dy libra është pjesëmarrës në referenca, në fushën e shëndetit në shkolla 1996, në fushën e konsumatorit shqiptar 1999. Është korrektor e redaktor në librin "Çokajt dhe malësorët e Nënshkodrës", me autorë Mark Ucin. Janë të shumtë ata që flasin për përvojat si mësimdhënës e drejtues të Shefqet Xhikës. Nxënës, kolegë, prindër të komunitetit drejtues të arsimit në bazë e institucione në rreth (në kryeqytet) flasin me admirim për punën, taktin, shpirtin e pasionit të tij, reformator. Një ish-nxënësja ime shembullore Emelda Hamolli, tashmë nxënëse e vitit 3, na tha:

"Prof. Shefqetin e nderojmë dhe e duam si prindin tonë. E kemi të shtrenjtë e të respektuar. Na ndihmon, mëson e aktivizon vazhdimisht, bën që të blerojnë talentet, ta mësojmë e ta duam letërsinë, estetikën. E kemi vërtet si prind, si shok...".

Po kështu edhe Esmeralda Rufat Murati me origjinë nga Shlliu i Matit e plot e plot gjimnazistë të tjerë e lartësojnë, portretizojnë dhe fisnikërojnë pedagogun e nderuar Shefqet Xhika.

Vërtet kjo është "grada" më e madhe, më e çmuar kur meriton nderimin e brezave, siç ua ka arritur intelektuali, mësuesi e drejtuesi i përvojave, pedagogu reformator Shefqet Xhika.

Për 4 dhjetëvjeçarë shëmbëllen në shtigjet e mësuesisë, si mjeshtër i mësimdhënies dhe i taktit në drejtim, si organizator e veprimtar. Faktet e përkushtimit e të mençurisë, faktet në lartësimin e dritës së arsimit dëshmojnë se Shefqet Xhika është çidhnaku i provave të diturisë. Urime Shefqet Xhika i Dibrës, intelektuali dhe pedagogu i fisnikërisë arsimore.

Rruga e Arbërit nr. 106

Kontibuti i Agim Bardullës do të mbetet një gur themeli
i periudhës së konsolidimit të arsimit të lartë matematik shqiptar.

portret

Agim Bardulla la pas një **visar** të tërë **kujtimesh**

Nga **ALEKO MINGA**

Kur ndahet një njeri nga jeta, familjarëve dhe të afërmve, kolegëve me të cilët ka punua një jetë të tërë, miqve e shokëve të ngushtë sikur u shkëputet një copëz nga shpirti i tyre. Për Agimin tonë të shtrenjtë me të cilin ata kanë ndarë çaste të paharruara përjetimesh të veçanta, prej të cilit kanë mbresa të pashlyeshme, ruajnë një kujtesë një mori batutash të goditura, të cilin e kanë çmuar jo vetëm për zgjuarsinë e rrallë, por edhe për dashurinë e miqësinë e çiltër që u ka ofruar.

Agim Bardulla ishte dhe mbeti një pjesëz e çmuar e mozaikut të kolektivit të matematikës dhe për hir të personalitetit origjinal, solli në këtë mozaik vlera të veçanta.

Në shtatorin e largët të 1956-ës, në orën e parë të karrierës time pedagogjike, më priste një befasi. Ndonëse shumë i emocionuar, siç kuptohet, nuk më shpëtoi sysh një djalë trupimët me sy të zgjuar, që e linte shpejt lapsin pas pak çastesh sa kisha diktuar ushtrimet. "E bana" dëgjova të pëshpëriste, kur i bëra me shenjë të vazhdonte të punonte. Ky ishte Agim Bardulla.

Kështu, 59 vjet të shkuara e njoha këtë student me aftësi qe m'u dukën vërtet jo të zakonshme. Vendos ta vëzhgoja më afër.

Që në orën e dytë, me nxitjen time por me një modesti që më bëri përshtypje, ai u bë një ndihmës, i cili më jepte dorë ta zhvilloja seminarin e ushtrimeve me një ritëm, që nuk e arrija dot me grupet e tjera. Tanimë isha i bindur në zotësinë e tij të rrallë. U kënaqa kur opinion im përkoi plotësisht me atë të kolegëve të tjerë që jepnin mësim në atë grup. Të entuziazmuar njoftojmë shefin e katedrës, Prof. Pepi Pilika për këtë student të veçantë të dyvjeçarit. Dhe ai, që i vlerësonte talentet, na besoi dhe me autoritetin që kish i përshpejtoi procedurat që Agimi të kalonte në Institutin katërvjeçar. Agimi i përligjte plotësisht shpresat tona, shkëlqeu gjatë gjithë periudhës së shkollimit dhe, pas shkollimit, u bë pjesë e kolektivit të katedrës së Matematikës.

Agimi kishte një talent organik, spontan dhe të vetvetishëm dhe jo një talent "të kultivuar"me punë dhe përpjekje sistematike. Mendja e tij ishte e mprehtë dhe punonte pa asnjë sforco me ritëm të shpejtë. Arsyetimi i tij ishte intesiv, depërtues, me forcë sintetizuese. Këto ishin karakteristika thelbësore që i shfaqi në tërë veprimtarinë e vet.

Si pedagog, krijoi stilin e tij të veçantë, të nyjëtuar mbi idetë dhe jo mbi llogaritjet rutinë. Evidentonte sidomos idetë e bukura dhe ato i



Agim Bardulla kishte një talent organik, spontan dhe të vetvetishëm dhe jo një talent "të kultivuar"me punë dhe përpjekje sistematike. Mendja e tij ishte e mprehtë dhe punonte pa asnjë sforco me ritëm të shpejtë. Arsyetimi i tij ishte intesiv, depërtues, me forcë sintetizuese.

Kush ishte Agim Bardulla?

Prof.Dr. Agim Bardulla u lind më 10 Shkurt të vitit 1940 në qytetin e Peshkopisë.

Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në qytetin e lindjes . Kultura dhe talenti i tij spikatin që në fëmijëri, teksa e mbaron gjimnazin që në moshën 16 vjeçare.

Në vitin 1956 fillon studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës në degën e Matematikë-Fizikë, ku edhe aspironte që fëmijë. Studenti i vogël i Universitetit, i dashuruar pas shkencës, shkëlqeu në studimet e tij të thelluara në Matematikë, aq sa vetëm 20 vjeç , menjëherë pas diplomimit, u emërua pedagog i Matematikës në Shkencat e Natyrës, ku edhe shërbeu deri në vitin 2008, kur edhe del në pension.

Në vitin 1978, Agim Bardullës i akordohet titulli 'Kandidat i Shkencave' duke mbrojtur disertacionin me temë: "Disa pohime me karakter kombinatorik lidhur me një çift copëtimesh". Zbatimi dhe përgjithsimet e këtij studimi tejet shkencor dhe të thelluar, ishin një qasje e re në shkencat matematikore, që i kalonte edhe kufijtë e Shqipërisë së vogël dhe të izoluar.

Në vitin 1985 merr titullin 'Doktor i Shkencave' dhe në vitin 1993 titullin e larte 'Profesor'. Gjatë kësaj periudhe kryen specializime në fushën e matematikës së aplikuar dhe merr pjesë në Konferenca të Rëndësishme Shkencore jashtë vendit si në Greqi , Itali , Francë, etj.

Prof.Dr. Agim Bardulla është autor i rreth 20 librave teorikë dhe aplikativë. Është bashkëautor në shumë tekste universitare, si dhe në volumet e rëndësishme të tilla si: "Gjeometria Diferenciale Lokale, vijat dhe siperfaqet", "Gjeometria e Lartë", "Gjeometria Analitike dhe Algjebra e Lartë 1,2", "Një informacion kuazilokal për grafët dhe zbatime të teoremave kombinatorike", "Zbatime të Matematikës Elementare", "Kombinatorike", "Topologji e Pergjithshme", "Ushtrime te Matematikës Elementare 1,2", "Ushtrime të Gjeometrisë Analitike 1,2,3", "Ushtrime të Gjeometrisë së Lartë 1,2" etj.

Krahas shkencës, piktura ishte një pasion dhe dashuri tjetër e Profesor Agim Bardullës, që i qëndroi dhe i qëndron besnik gjatë gjithë kohës edhe tani në pleqëri. Me modestinë që e karakterizon në natyrën e tij Profesorin, ai e "fshehu" me vite pasionin e tij të dytë dhe, vetëm me rastin e 60-vjetorit të lindjes së tij, me insistimin edhe të njerëzve të tij të afërt, Profesori hapi ekspozitën e punimeve të tij më të dashura në pikturë.

Dhe nuk ishin pak, por rreth 100 pejsazhe, portrete e autoportrete, duke suprizuar kështu publikun me anën tjetër të këtij matematicieni, atë të piktorit, artistit, që e kishte shoqëruar përgjatë viteve, që nga rinia e tij e hershme.



"Nga dritarja"...

komentonte me fjalë me përshtatje vetjake. Ishte një stil paraqitjeje nga i cili përfitonin studentët e aftë. Shumë nga ata që kanë lënë gjurmë në profesionin e tyre e kanë shprehur në çdo rast admirimin dhe mirënjohjen e tyre ndaj Prof. Bardulles që u stërviti një mekanizëm kaq të rëndësishëm të punës intelektuale si dallimin e thelbësores dhe përqendrimin e vëmendjes te më e rëndësishmja.

Tekstet që hartoi dallohen vërtet për origjinalitetin, trajtimin e sidomos për shtjellimin e saktë dhe sintetik. Agimin nuk mund të dilte "nga vetja" as në punën e tij kërkimore. Ndër shumë mbrojtje disertacionesh ku kam asistuar, mbresë më ka lënë ekspozimi i punimit prej tij, që na bindi se nuk kishim të bënim me një zhvillim linear të mëtejshëm të një zone të lëvruar, por me ide që sillnin një vlerë te re me perspektivë në mendimin gjeometrik.

Gjeometria ishte mirëfilli fusha ku ai mund të shfaqte, siç e shfaqi, potencialin e vet krijues.

Agimi nuk ishte vetëm matematikan i spikatur por edhe një "artist i lindur". Pa kryer ndonjë përgatitje të posaçme, thjesht nga një shtysë e brendshme estetike ai nxori duarsh jo pak vepra në pikturë, që do t'i kishin zili edhe profesionistët. Në to bie në sy saktësia e vizatimit, përpjesëtimet e drejta e të veçantave brenda të tërës, harmonia e ngjyrave, veçimi i ndonjë detaji interesant, të cilin e punonte me merak e kujdes të posaçëm. Mjeshtër i vërtet u tregu në miniaturat, në koherencë me stilin e tij të përgjithshëm. Ato janë të pikturuara me aq ndjenjë, në tërë spektrin e ndjenjave njerëzore, sa çdo ditë e përjeton kundrimin e tyre sipas gjendjes emocionale në të cilin ndodhet në atë moment, që hyn në rezonancë me atë pjesë të spektrit të ndjenjave që Agimi ka ditur të derdhë në miniaturën e vet: nostalgji, përmallim, trishtim, gëzim, etj.

Jeta rrjedh dhe çastet e saj rrokullisen e humbasin pa identitet në rrymën e pandalur të kohës. Falë Agimit në jetën e secilit nga ata që patën fatin ta njohin ka një mori çastesh që Agimi i ka bërë të pashlyeshme me humorin e tij brilant, të hollë e spikatur, të derdhur në batuta lapidare. Agimi dinte ta kapte detajin dhe ta bënte atë burim mesazhi të qëlluar por edhe hareje optimiste.

Agimi, në të gjitha kujtimet tona, sa të jemi gjallë, do të jesh i pranishëm përherë, sepse këto çaste që përmenda do t'i risjellim se ato mbeten të freskëta në kujtesën e gjithsecilit.

Fati mizor nuk të kurseu, por të dha dy goditje dërrmuese. Humbja e bashkëshortes së denjë, që të rrethoi me përkujdesje e dashuri, që të krijoi kushte ta shprehje talentin tënd, që ngriti për ty një strehë të ngrohtë familjare, ndodhi bash atëherë kur kishe më shumë nevojë për të. Nuk ishte mjaft kjo por ndodhi edhe gjëma e humbjes së djalit që ishte mishërim i fisnikërisë, siç e kishte dhe emrin, për të cilin përjetuam edhe ne që e patëm student dhimbjen më të ndjerë.

Në këto kohë të rënda ti pate përkujdesjen e jashtëzakonshme të vajzës, Edlirës, dhe të djalit, Urianit, që të shihnin në dritën e syrit me një dhembshuri dhe përkushtim, që bënin çmos të të plotësonin çdo dëshirë dhe nuk t'u ndanë deri në çastin e fundit. Paçin bekimin tënd këto fëmijë shembullorë dhe mirënjohjen e urimin e ne të gjithëve dhe jeta u shkoftë mbarë siç e meritojnë plotësisht.

Kontibuti i Agim Bardullës do të mbetet një gur themeli i periudhës së konsolidimit të arsimit të lartë matematik shqiptar. Kolegët shprehin gjithë mirënjohjen, sepse Agimi sillte përherë gëzim dhe optimizëm.

T'u bëftë dritë shpirti yt i pastër dhe i dëlirë në rrugën drejt jetës së amshueme....


Gjithkush lë pas një kujtim të ndritur. Ti na le një visar të tërë kujtimesh!

Ngushëllim

Redaksia i shpreh ngushëllimet bashkëpunëtorit dhe mikut të gazetës, shkrimtarit e poetit Agron Tufa, për ndarjen nga jeta të babait të tij, Isuf Tufa.

Isufi do të mbetet në kujtesën e të gjithë atyre që e kanë njohur për zgjuarsinë, sedrën, guximin dhe burrërinë e treguar në burgjet e diktaturës komuniste, të cilin ai pati fatin e keq që ta provojë.

I qoftë dheu i lehtë!



homazhe

Ajri Begu u dëshmua se ishte një intelektual i mirëfilltë
edhe pse interesat kombëtare ishin shumë më të gjera nga aspekti profesional...

Zbriti nga skena shkrimtari, ekonomisti, atdhetari **Ajri Begu**

Nga Prof. Dr. **MAHMUD HYSA**



Ajri Begu(1951-2015)

Ajri Begu dallonte në raport me të tjerët si individualitet psikologjik i veçantë me një nivel shumë të lartë të koeficientit psikik. Mbi të gjitha atë e shquante karakteri dhe inteligjenca, si dipozita më themelore, po edhe kujtesa, racionaliteti, intuita, përceptimi...

Prishtina dhe Dibra janë qytetet më të pikëlluara, më të deprimuara, më të dëshpëruara pse nga gjiri i tyre i ngrohtë u nda bashkëqytetari i tyre që i deshte sinqerisht dhe e deshin me devotshmëri, Ajri Begu. Ajriu im i dashur e kemi ditur se në jetë ishte mjaft optimist, i durueshëm, i vetëdijshëm për të gjitha turbulencat e jetës të cilat i përballove vështirësi pas vështirësie, problem pas problemi, me veçoritë që e karakterizonin karakterin tënd si urtësia, mençuria, inteligjenca, racionaliteti, gjakftohtësia. Dhe gjithmonë ke patur sukses, dilte ajo që kishe parashikuar, ajo që ishte më e drejtë, ajo që ishte më objektive. I përballove vetëm ato që ishin në raport me të tjerët, por fatkeqësisht nuk i përballove ato që i kishe me vetveten, me sëmundjen më të rëndë, më tinzake dhe më të paevitueshme duke na pikëlluar pa masë të gjithëve: familjen, kolegët, miqtë, dashamirët, shokët. Na pikëllove pa masë pse kosa e vdekjes të rrëmbeu shumë herët, pikërisht në kulmin e ëmbëlsisë së jetës, të potencës për krijimtari letrare, të pjekurisë maksimale për rezultate shkencore, të kontributit të lakmueshëm që e arrite vetëm ti në shkencat financiare-bankiare, të ndriçimit që reflektonte personaliteti yt , prej njeriu të ditur, të matur, të ndershëm, të dinjitetshëm; na pikëllove pikërisht në kohën kur potenciali yt njerëzor, letrar e shkencor nuk mundi të vërshojë aq sa duhej dhe ashtu si duhej në rrethin intelektual, në shkencat ekonomike, në artin letrar si në dramë, prozë e poezi, në rrethin qytetar pse kishte njeriu çka të dëgjojë prej gojës tënde, çka të mësojë dhe çka të përvetësojë nga fjalët tua, nga mendimet tua, nga përvoja yte jetësore jo shumë e gjatë , pse u largove shumë herët e na le me gojë të hapur, me mendje të zbrazur, me ndjenja të fashitura, megjithëse nga fuqia yte mendore, nga logjika e shëndoshë e mendimeve dhe e rezonimeve, nga urtësia dhe nga përvoja me shumë vlerë, për një njeri aq të ri, që e kishe fituar në raportet me njerëz mjaft autoritarë nga të cilët fitove respekt dhe dashuri të pamasë, nuk i përngjave njeriut të kërrusur nga mosha, të lodhur nga turbulencat e jetës dhe të thyer nga fizikumi, po të njeriut vital, të pashëm, të qëndrueshëm, të paepur, të papërkulur, edhe pse u ndave nga jeta në moshën 64 vjeçare, u ndave pa lamtumirën e fundit, ashtu në mënyrë të urtë e të padiktueshme siç ishe edhe në jetën e përditshme.

Sot ne ndjehemi shumë të sakatuar pse duhet të ndahemi detyrimisht nga prindi e shoku, nga shkrimtari e humanisti, nga ekonomisti e specialisti. Po të humbasësh një prind dhe një shok aq të zemrës, aq besnik, aq të kujdesshëm; aq të sinqertë, aq të dashur dhe aq të përkushtuar është më shumë se të humbasësh një çifik të tërë; të humbasësh një krijues dhe një humanist, një dramaturg, një tregimtar, një poet dhe një fisnik që jeton me hallin e të tjerëve, është humbje më e madhe se të humbasësh informatat për shpirtin e popullit tënd që pasqyrohet në veprat letrare dhe të humbasësh sytë e atyre që kërkojnë prej teje shpëtim; të humbasësh një ekonomist kreativ, vizionar dhe prestigjioz me arritje kulmore është humbje më e madhe se të humbasësh një thesar të vlefshëm për të ardhmen e një populli të tërë. Dhe ai prindi e shoku, krijuesi e humanisti, ekonomisti e specialisti që tash e tutje nuk do të jetë prezent vetëm fizikisht në mesin tonë, po shpirtërisht gjithsesi, ishte Ajri Begu, ai që e la të zbrazur dhe të pazëvendësueshëm vendin e prindit e të shokut, të krijuesit e të humanistit, të shkencëtarit e të specialistit që vështirë se mund të dalë kush që ta zëvendësojë; të njeriut më të përdëllyer, më të përgjëruar dhe më të përmalluar për vendlindjen e tij, për Dibrën e Madhe; të intelektualit, shkencëtarit dhe patriotit të dorës së parë; të shokut dinjitoz, të kolegut të përkushtuar të mikut të kujdesshëm. Ai vdiq me mendjen, me zemrën dhe me shpirtin tek vendlindja e tij, Dibra, tek qytetarët e saj, dibranët, tek rrugët e rrugicat e Dibrës, ku kishte kaluar fëmijërinë e adoleshencën. I deshte, i adhuronte dhe i përkujtonte me ëndjen më të madhe virtytet e qytetarit të Dibrës, shpirtin luftarak të tyre, të kaluarën heroike dhe simbolike të vendlindjes së tij. Dhe nuk mbeti vetëm konformist, deklarues dhe iluzionist, por tërë atë që dinte për shpirtin e vendasve, e dinte shumë, që mësonte, e vazhdimisht ishte kërkues, që hulumtonte, e vazhdimisht pyeste dhe lexonte, e shprehu në veprat e tij si: Tri net, tregime (1975), Gungat, tregime (1976), Uraniku, tregime (1978), Dyert, dramë (1983), Krasta, poezi (1983) dhe Gjarpëri i shtëpisë, dramë (1985). Në veprat e Ajri Begut dalin personazhe që dëshmojnë një të tanishme të dhembshme,me plot trauma, dalin personazhe me gunga që vështirë i tejkalojnë, dalin personazhe që të përkujtojnë të kaluarën më të lashtë të vendlindjes, Uranikun e dikurshëm, të dalin traditat mitologjike dhe legjendare që të japin përshtypjen e një populli shumë të lashtë, të kohës së totemit që ka arritur ta ketë gjarpërin si mbrojtës të shtëpisë, fenomen i rrallë ndër popuj tjerë ku në mënyrë shumë mjeshtrore artistike i eksploron dhe i gërsheton traditat më të lashta e të bukura kombëtare rreth normave familjare, fisnore e kombëtare me të tanishmen tradicionale e fisnike që mund ta njohë dhe e njohu vetëm njeriu me inteligjencë të veçantë, siç ishte Ajri Begu duke krijuar, brenda kornizave të një drame mitike, një të vërtetë artistike të veçantë dhe të rrallë në letërsinë tonë.

Ajri Begu, po të mbetej edhe vetëm me veprën letrare që krijoi brenda dhjetë viteve (1975-85), do të konsiderohej si një intelektual që e realizoi idealin jetësor, t'i lejë trashëgimisë kulturore një kapital të vlefshëm dhe të pavdekshëm: veprat letrare me të cilat ka hyrë në analet e letërsisë kombëtare. Megjithatë, Ajri Begu u dëshmua se ishte një intelektual i mirëfilltë edhe pse interesat kombëtare ishin shumë më të gjera nga aspekti profesional, si ekspert i shkencave ekonomike që atij nuk i kanë munguar duke krijuar një vepër edhe më grandioze dhe më prestigjioze, të njohur dhe të mirënjohur nga opinioni shkencor. Që më 15 nëntor 1999 ai ishte njëri ndër themeluesit e Autoritetit Bankar i Pagesave të Kosovës që më 2006 u shndërrua në Autoritetin Qëndror Bankar të Kosovës dhe me themelimin e Bankës Qëndrore të Kosovës u zgjodh me plot të drejtë dhe kompetencë guvernator i kësaj banke, historikisht guvernatori i parë i këtij institucioni mjaft prestigjioz i qarqeve më të larta të ekonomisë së Kosovës që njëkohësisht mund të konsiderohet edhe si krenari për qytetin e tij të lindjes që një bir i saj u ngjit në piedestalin mjaft të lartë të ekonomisë së një vendi ku jetoi dhe veproi. Meritën eksluzive për ndërtimin dhe udhëheqjen e këtij institucioni, të sistemit bankar në përgjithësi dhe të udhëhqjes së BQK si guvernator, e theksuan edhe autoritetet politike të kohës në telegramet e tyre ngushëllimi që i dërguan familjes së tij, siç ishin kryeministri Isa Mustafa dhe z-kryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, Hashim Thaçi. Isa Mustafa e cikësoi si "doajeni i sektorit financiar të Kosovës" dhe e vlerësoi "kontributin shumë të çmuar në ekonominë e Kosovës, veçanërisht në themelimin dhe ndërtimin e sistemit bankar të Kosovës dhe të BQK", ndërsa Hashim Thaçi se "do të mbahet mend për kontributin e tij në forcimin e institucioneve kudo që punoi". Po Ajri Begu u tregua vigjilent dhe aktivist edhe në lëvizjet politike të kohës pse u radhit me intelektualët më të shquar dhe më të avancuar të kohës siç ishin Ibrahim Rugova, Ajri Begu, Basri Çapriqi, Ramiz Kelemndi e tjerë që e themeluan Këshillin Nismëtar për themelimin e Lidhje Demokratike të Kosovës dhe pranuan të jenë anëtarë të këtij Këshillimi Nismëtar.

Ajri Begu kishte dispozita psikologjike të veçanta që dallonte nga gjenerata e tij dhe nga shumë të tjera që ai i shprehu në raport me të tjerët si individualitet psikologjik i veçantë me një nivel shumë të lartë të koeficientit psikik. Mbi të gjitha atë e shquante karakteri dhe inteligjenca, si dipozita më themelore, po edhe kujtesa, racionaliteti, intuita, përceptimi. Karakteri I tij dallonte nga të tjerët se ishte i formuar, principiel, i paluhatshëm, kategorik i vendosur mbi baza të logjikës, arsyes, racionalitetit, objektivitetit. Po veçmas shquhej ninteligjenca e tij dhe ajo që nga shkolla e mesme, që nga fakulteti ekonomik që e kreu për tre vjet, që nga Zagrebi ku kreu studimet e magjistraturës në ekonomi dhe gjatë tërë jetës ku shprehu aftësitë dhe prirjet për krijimtari letrare, për ekonomi dhe ligjet e saj në praktikë, për komunikime me të tjerët, për zgjidhjen e problemeve politike, familjare, shoqërore, individuale.

Ajri Begu krijoi dhe ndërtoi një familje intelektuale me një edukatë dhe me principe më moderne të raporteve në mes tyre. Bashkëshorteja, Flora Brovina, me dispozita familjare të shkëlqyera, me formim intelektual të lartë dhe me veprimtari të gjerë humanitare shumë të suksesshme me fëmijët kosovarë të atakuar nga pushteti i huaj serb, ishte edhe e burgosur politik, pati mirëkuptim të plotë nga bashkëshorti i saj për veprimtaritë që zhvillonte në dobi të çështjes kombëtare; dy djemtë e tij, Uraniku dhe Ylli, kanë ndjekur gjurmët e të atit në ekonomi dhe do të vazhdojnë ta mbajnë kultin e familjes që e formoi babai i tyre.

Ajri Begu krijoi një prestigj shumë të fuqishëm në mesin ku jetoi, respektonte secilin dhe ishte edhe më i respektuar nga njerëz të njohur e të panjohur, gjë që u dëshmua me pjesëmarrjen e një numri shumë të madh në Akademinë mortore që u mbajt në sallën e Teatri Kombëtar të Kosovës ku u mbajtën edhe fjalë rasti nga shokë e bashkëpunëtorë si Bedri Hamza, guvernator i tashëm i BQK, Eqerem Basha, koleg dhe shok, Mahmud Hysa, ish profesor i shkollës së mesme, Akif Mulliqi, krijues letrar dhe studiues, dhe sidomos në kortezhin e gjatë dhe të pafund të njerëzve që morën pjesë në përcjelljen e Ajriut për në shtëpinë e fundit, të një biri të Iliridës që u varros me plot dinjitet dhe respekt në trollin e nënës Dardani. Një finale e dhembshme për largimin shumë të prakohshëm dhe krenare për arritjet dhe respektin që gëzonte në mjedisin ku jetoi dhe veproi gjatë tërë jetës, me kokën të kthyer nga vendlindja.

Prishtinë, shkurt 2015

Ndahet nga jeta mësuesi dhe artisti **Miftar Alia**

Miftar Alia, si artist i valles dyshe të burrave të Dibrës, do të mbetet shumë gjatë në kujtesën e bashkëkohësve të tij, ashtu siç përmendeshin nëpër mexheliset e brezave të mëparshëm, emrat e artistëve, korifenj të Çidhnës...

Para pak ditësh, në fillim të muajit shkurt 2015, mësuam lajmin e hidhur të ndarjes nga jeta, të shokut tonë të fëmijërisë, kolegut tonë dhe mikut tonë, të ndjerit Miftar Xhaferr Alia.

Miftari lindi në Fushë-Alie. Arsimin fillor e kreu në Fushë-Alie, arsimin shtatë-vjeçar e kreu në shkollën e Kastriotit dhe arsimin e mesëm pedagogjik e kreu si nxënës i jashtëm në shkollën Pedagogjike të Peshkopisë në fillim të viteve '60. Për Miftarin, si pinjoll i fisit të Aliej, njërit ndër fiset më të persekutuar për rreth një gjysëm shekulli nga shteti i diktaturës së proletariatit, që udhëhiqej nga parimi i ligjit të luftës së klasave, as që mund të pretendohej për të ndjekur studimet me bursë shteti të asaj kohe. Në atë periudhë, fëmijët e ish-klasave të përmbysura nuk kishin të drejtë të ndiqnin arsimin e mesëm profesional as edhe si nxënës të jashtëm. Por qe një fat i mirë për Dibrën që në atë periudhë (1960-1965) në krye të Partisë-shtet, me detyrën e Sekretarit të Parë të Komitetit të Partisë për qarkun e Dibrës, pat shërbyer atdhetari dhe intelektuali me vizion liberal dhe demokrat dibrani Jashar Menzelxhiu, i cili, duke shfrytëzuar nevojën për kuadro arsimorë për në zonat e thella malore, me inisiativën e vet, e zbuti ligjin e luftës së klasave dhe ua hapi dyert e shkollës pedagogjike të Peshkopisë duke u dhënë të drejtën që të vazhdonin studimet e mesme pedagogjike si nxënës të jashtëm ose me korrespondecë edhe fëmijëve të fiseve të ashtuquajtura "reaksionare" të Kaloshëve, Aliajve, Karahasanëve, Demajve etj, por duke i paralajmëruar: "Sot partia ka nevojë për mësues, prandaj do t'jua japim të drejtën e studimit në Pedagogjike, por, të keni parasysh se nesër, kur të vijë koha që të plotësohen nevojat e kuadrit, mos u habitni, se për shkaqe që ju i dini, Partia, edhe mund t'ju heqë nga puna. Prandaj, ju këshilloj që të jeni të kujdesshëm!"

Nisur nga ky këndvështrim duhet parë dhe vlerësuar edhe puna dhe jeta e Miftar Alisë. Prandaj, ndokush mund të bëjë pyetjen: "Si është e mundur që Miftar Alia, si pinjoll i fisit më të masakruar nga pushteti i ish-diktaturës së proletariatit, t'i shpëtonte, më e pakta pushimit nga puna, dhe të arrinte të dilte në pension si mësues?!"

Në këtë aspekt, theksojmë këtu, se ne e kemi njohur Miftar Alinë, si mësues shembullor. Kudo që ka punuar si mësues në shkollat fillore të zonës së Çidhnës dhe më gjerë, ai ka lënë kujtimet më të mira me nxënësit, me kolegët, ashtu edhe me prindërit e ish-nxënësve të tij. ne kam pasur fatin që shumë prej ish-nxënësve të tij në ciklin e fillores, t'i kemi pasur nxënës në ciklin e 8-vjeçares dhe në të mesmen, të cilët, për hir të së vërtetës, kanë qenë të gjithë nga nxënësit më të mirë të klasës. Ndaj nuk ka lindur kot fjala e urtë se "Pasqyra e mësuesit janë rezultatet e nxënësve". Si ish-koleg e miq, ruajmë kujtimet më të mira: ai ishte i urtë, punëtor, nuk i binte në qafë askujt, mbi të gjitha ishte parimor, besnik dhe trim. Edhe pse e dinte se, si pinjoll i fisit Aliaj, ishte objekt i luftës së klasave, Miftari nuk është përkulur kurrë ndaj padrejtësive të kohës.

Por fusha në të cilën Miftar Alia ka bërë emër dhe ka lënë gjurmë, më shumë se kudo tjetër, jo vetëm për zonën e Çidhnës, por edhe në shkallë rrethi, për gjithë Dibrën e më gjerë, në shkallë kombëtare, është arti. Miftar Alia ka qenë një artist i vërtetë dhe i klasit më të lartë, në fushën e koreografisë si valltar popullor në kërcimin (ekzekutimin) e valles klasike dyshe të burrave të Dibrës. Në këtë fushë Miftar Alia ka krijuar personalitetin e vet të padiskutueshëm dhe të pakrahasueshëm me asnjë nga bashkëkohësit e vet në gjithë Dibrën. Ai ka qenë numri një në të gjithë Dibrën si valltar i dyshes së burrave të Dibrës. Pikërisht pse ishte i tillë, edhe pse ishte pinjoll Aliesh, Miftari ka përfaqësuar Rrethin e Dibrës në të gjitha festivalet folklorike të organizuara në shkallë kombëtare, siç kanë hyrë në histori, me emrin festivaliet e Gjirokastrës. Miftarin e aktivizonin në festivale, sepse me cilësinë e lartë të ekzekutimit, të valleve dibrane, ai i bënte nder ansamblit të Dibrës, duke i rritur numrin e pikëve në vlerësim dhe klasifikimin e grupit.

Miftar Alia, si artist i valles dyshe të burrave të Dibrës, do të mbetet shumë gjatë në kujtesën e bashkëkohësve të tij, ashtu siç përmendeshin nëpër mexheliset e brezave të mëparshëm, emrat e artistëve, korifenj të Çidhnës, si Tahajr Rushajti (Spata) e Rustan Nezha nga Blliçja, Abas Tërshana nga Fushëaliej, e Abas Noka nga Grykë-Noka, si mjeshtra të valles dyshe të burrave, Eles Kuta nga Blliçja dhe Rustem Kadriu nga Sina, si mjeshtër të rënies së fyellit, si dhe të Sali Bitrit nga Laçesa dhe të Suf Harçekut nga Çidhna për ekzekutimin e melodive me çifteli, secili në kohën e vet.

Së fundi, emri i Miftar Alisë, ka hyrë edhe në fonin e Bibliotekës Kombëtare, si autor i librit "Kreshnikët e Maleve", i cili ka vlera të padiskutueshme historike dhe etno-kulturore dhe që meriton një studim të veçantë.

Ali Hoxha, Xhaferr Martini,
Hysen Repa, Shaqir Skarra.

Rruga e Arbërit nr. 106

Pajtohu në gazetë - 1 vit vetëm 600 lekë



Pajtohu në gazetën RRUGA E ARBËRIT

Merr versionin PDF ose kopjen print duke filluar me 50 lekë/muaj

Pajtimet mund ti bëni pranë redaksisë duke komunikuar në numrat e mëposhtëm,
me transfertë bankare pranë Raiffeisen Bank - Tiranë,
ose me **PayPal** përmes emailit **<rrugaearberit@gmail.com>**

Një pajtim vjetor kushton: **Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD**.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Gazeta ofron faqet e saj për REKLAMA apo NJOFTIME të ndryshme për biznese dhe individë.
ÇMIME TË ARSYESHME për faqet me ngjyra dhe bardh e zi.

Për informacion:
E-mail: rrugaearberit@gmail.com
Tel: +355 69 20 68 603

Ftesë për bashkëpunim

Gazeta "Rruga e Arbërit" në bashkëpunim me Botimet M&B ka në projekte për disa veprimtari dhe botime në fushën e kulturës, me vlera historike, kulturore dhe kombëtare për Dibrën dhe gjithë Shqipërinë.

Ftojmë individë, shoqata apo institucione vendore të bëhen bashkërealizuese të këtyre projekteve.

Për më shumë informacion
mund të shkruani në email
mbbotime@gmail.com,
rrugaearberit@gmail.com
ose mund të telefononi në numrin
069 20 68 603.
Faleminderit!

Librat e botuar nga Botimet M&B mund
ti gjeni në Tiranë pranë librarisë së
Shtëpisë Botuese M&B,
në rrjetin e librarive "Adrion",
si dhe në disa librari kryesore në Tiranë.
Në Peshkopi: Libraria "Fleta XXI", pranë Muzeut.
Në Durrës: Libraria "Dyrrah". Tel. 0694053353
Për porosi: tel. (04) 22 33 283 / 069 20 68 603
068 65 08 441 / 067 30 73 265
E-mail: <mbbotime@gmail.com>